



MARIO BELLIZZI

Pasqyra dhe hija

MARIO BELLIZZI

Nëntitulli *poezi kurbeti*: tokë e huaj, e mërgimit, e shtegtimit, e shpërnguljes ka gjasë me yjësinë e simboleve të fjalës ku bënë pjesë edhe *kurbati* si endacak, arixhi *kurban*, kafsha e flijuar për fitime materiale e shpirtërore të reja, të ndodhë një rindërtim pa afat i heterotopisë, të pasqyrës e të hijes. Është në kromozomet e shoqërive njerëzore *hybris*-a që pjell shkretëtira për të sjellë kurbanin në fli. Prej kohe dhe në historinë, vegimtarë, shenjtër, profetë, heronj dhe heroina të paepur ndaj *status-it quo* e poetët kanë qenë *kurbanët* therur në vetmi të plotë: tani është hera e të *Huajit!* Vendi i shenjtë i *asylum-it* (ασυλον) po vjen rrënuar. Poetët, me glosolalinën e amshueshme të tyre, duhet të bëjnë *poiesis* dhe të tregojnë sa shohin ata sy të fshehtë, kthyer ndaj *të brendshmit shtet të huaj* të njeriut, rreth të cilit flet Jung, për të hyrë në ëndrrat, por me sy të tjerë gati të dëshmojnë kundër krimeve që shtypin shenjtësinë e jetës.

Mario Bellizzi



Pasqyra dhe hija

LITTERA



LITTERA

Pasqyra dhe hija
MARIO BELLIZZI

Kryeredaktore:
Donika Dabishevci

Ballina & Dizajni:
Fahredin Spahija

Fotografia e autorit:
Giuseppe Genise

Copyright © autori

LITTERA
Prishtinë
2022

Pasqyra dhe hija

Poezi kurbeti nga Ballkani në Mesdhe

MARIO BELLIZZI

 **LITTERA**

2022

Umbra - spectrum - speculum
 Hije - lugat - pasqyrë

Ky është një varg fushash heterotopike të cilat në projektim tregojnë një prani gjërash dhe lëndësh të vendosura në prag të paraqitjes: *re-trahere* etimologjikisht ‘vë në vendin e duhur’ që mendja kap në të njëjtën mënyrë dhe që kanë të njëjtin kuptim. Pasqyra në të cilën e shohim veten aty ku nuk jemi, d.m.th. te një vend jo-real i cili hapet virtualisht prapa sipërfaqes është, në të njëjtën kohë, një vend patjetër i vërtetë, lidhur me gjithë hapësirën që e rrethon. Michel Foucault (*Fjalët dhe gjërat. Një arkeologji e shkencave njerëzore*) zbuloi konceptin e heterotopisë dhe përshkruajti pasojat e saj: “Heterotopitë shqetësojnë, patjetër pse dëmtojnë fshehurazi gjuhën e përditshme, pse ndalojnë të thuhet këtë dhe atë, pse thyejnë dhe ngatërrojnë të thënat të përgjithshme, pse prishin para kohe ‘sintaksën’ dhe jo vetëm atë që ndërton fjalitë, por tjetrën më të fshehtë që ‘lidh’... fjalë

dhe gjëra. (...) heterotopitë (si ato që hasim herë-herë te Borges) shterpojnë bisedën, ngatërrojnë fjalët ndër to, vënë në dyshim nga rrënjët çdo rregull në gramatikë, mbështjellin mitet dhe shterpojnë lirizmin e fjalive”. Poetët me gjasë, në një luftë të pabarabartë, nga ajo atmosferë shqetësuese mundohen të gjejnë mbetje lirike për të thurur përsëri të pranishmen dhe të ardhmen me të zbriturit e “një gjuhe që gëlltitet dhe përtipet ajo vetë, që vjell edhe një mbetje natyrore – të tijën- që s’mund as ta përvetësojë as ta barazojë me të përgjithshmen fuqi të konceptit” dhe në përputhje “me sa ndëlgohet/kuptohet në atë, (...), lëhet me një fërfëllimë të flatrave tokën natyrore dhe sjell me veten trupin e tij natyror” (J. Derrida, *Glas*). Poezia, me një pëlhurë bisedore, rrënjore dhe subversive në ëndërrimin e saj, por në kufijtë e endofazisë, e mbushur me vegime për shkak të vërshimit të vazhdueshëm të ngjarjeve e së tashmes në të kaluarën, dhe anasjelltas, tregon në gjuhën e saj, dhe përmes saj, zhvendosje dhe prita shpëtimtare e një të përjetshëm *gjetiu*. Poezitë janë *jashtë vendit*, dhe joaktuale, sipas Nietzsche, d.m.th veprojnë kundër kohës, brenda kohës dhe për ardhmen, janë radhitur me fjalë të vdekura a grisura, të huazuara prej tokës/detit lindor të një etnie shqiptare: *arbëreshët*, e cila u vendos në Italinë jugore në shek. XV. *Shqipëria*: e

kalura - shek. XV – mishëruar me një të tanishme gjeografike e antropologjike tjetër në Itali. *Arbëria*: zonë arritjesh për të ikur, zonë kalimi vazhdimisht e ekstrapoluar (për mua ka qenë Italia e mbase diçka tjetër gjeografikisht në momentet historike më të ndryshme) dhe e futur, sidoqoftë, për të gjithë, nga e ardhmja e nga malli në kujtimin e një Toke të Premtuar; e *Bukura More*, në fakt, është toka ime e premtuar, sot, tashmë vetëm një *locus* magnetik të shpirtit e jo më krahina pjellore, në jug-perëndim të Peloponezit, e braktisur nga të parët tanë në ikje gjatë viteve 1520-1530! Ajo është po një erëz, një qëndisje e bukur te truri im, një kujtim i pandërprerë, jo më lidhur me tokën, por me “atopinë”; fundimisht, **Kosova**: territor shqetësues në *puzzle*-n e Balkanëve, i shënuar me kufi, ku historia kapërcen gjeografinë. Një *topos* plot me gjuhë por me të cilat popujt tani nuk kuptohen më; një *topos* besimesh lutjet e të cilave hyjnitë s’i gjegjen më. Topoi që shkatërron sintaksën dhe pjell Arbëri të tjera në Gjermani, në Zvicër, në Angli, në Francë, në Suedi, në Amerikë, një farë *heterotopie*. Nuk dimë më as cili të ketë qenë vendi i nisjes së tyre as ai i arritjes, Shqipëria e tyre e Arbëria e tyre, aq më pak cila është “e Bukura More” e të mërguarve shqiptarë, kosovarë që jetojnë në Gjermani, Zvicër, në Suedi, etj., cila është krahina e tyre e Shpirtit.

Gojëdhëna nguluese e kësaj gjuhe, këtu ndërtuar me grafeme, jeton në caqet e moskuptimit këtej Adriatikut dhe e panjohur, në variantet e saj, nga ana e bregut ballkanik, dhe ndryshe. Fjalët në përkthimet e gjuhëve duken në ankth, që luten të bëhen të paktën *shënime në fund të faqës*. Poezitë kanë thithur limfën nga toka-gjuhë të ndryshme: ëndërrore si ‘*e Bukura More*’ e Peloponezit, toka-deti lindor të ikjes me anije pesëqindvjeçare; sidomos nga të tjera që po zhduken ose që janë duke rritur dhe duke u shtuar por të ekstrapoluar gjetiu; në fund, nga toka përkohësisht të varura ndërmjet shkretëtirës e Mesdheut dhe zgjatur drejt fshatrave të *hinterlandit* jugor, arkaik, grekomadh, bizantin, ... edhe me *gjitoni* shqipfolëse, të lindura nga trazira e popujve të kthyer të paqëndrueshëm nga grabitjet e Perëndimit, nga kushtet klimatike, luftërat, mungesat. Në një vend të tillë, magmatik, pa gjuhë të sigurt, *këtu e tani*, shkruajta një lloj ditari udhëtimi, në të egrën paraqitje të trupave anapraptas në historinë. Nëntitullit *poezi kurbeti*: tokë e huaj, e mërgimit, e shtegtitimit, e shpërnguljes ka gjasë me yjësinë e simboleve të fjalës ku bënë pjesë edhe *kurbati* si endacak, arixhi *kurbani*, kafsha e flijuar për fitime materiale e shpirtërore të reja, të ndodhë një rindërtim pa afat i heterotopisë, të pasqyrës e të hijes. Është në kromozomet e shoqërive njerëzore *hybris*-a që pjell shkretëtira

për të sjellë kurbanin në fli. Prej kohe dhe në historinë, vegimtarë, shenjtër, profetë, heronj dhe heroina të paepur ndaj *status-it quo* e poetët kanë qenë *kurbanët* therur në vetmi të plotë: tani është hera e të *Huajit!* Vendi i shenjtë i *asylum-it* (asulon) po vjen rrënuar. Poetët, me glosolalinën e amshueshme të tyre, duhet të bëjnë *poiesis* dhe të tregojnë sa shohin ata sy të fshehtë, kthyer ndaj *të brendshmit shtet të huaj* të njeriut, rreth të cilit flet Jung, për të hyrë në ëndrrat, por me sy të tjerë gati të dëshmojnë kundër krimeve që shtypin shenjtësinë e jetës.

Një falënderim i veçantë i shkon Dr. Griselda Doka dhe Prof. Emil Lafe për pastrimin dhe harmonizimin e materialit gjuhësor të vendosur gjithmonë mes dy botëve të mia.

Mario Bellizzi

Trebisacce, Gusht 2022

ME SHUAJ PREJ ERE

... anything that has happened since is never lost for history.

... çdo gjë që ka ndodhur kurrë nuk është e humbur për historinë.

Walter Benjamin

Rexhep Ismajli

Mario Bellizzi (Bellici), u lind në Shën Vasil të Kalabrisë (Itali), i diplomuar për matematikë në Universitetin e Kozencës, nisi të bëhej i njohur në letrat arbërisht në vitet '80 të sh. XX, së pari me *Antologia poetica*, Shën Vasil 1982; pastaj me *Kristla (Gramigna)*, poezi, Shën Vasil, 1983, ribotuar te *Fjala*, Prishtinë, 1984; me monografinë *San Basilio Craterete. Comunità albanofona del XV secolo dell'area del Pollino*, Castrovillari 1995; *Who are we now?*, poezi, Dukagjini, Pejë 1997; *Vallja e zaravet - La danza delle fate*, përralla e legjenda të komuniteteve arbëreshe të

Parkot këmbetar të Pollinit, Castrovillari 2000; *Last exit to Bukura Morea/ Ultima uscita per la Bella Morea*. Geo-poesie arbëreshe di migrazioni multiple. Dalla storia all'eterotopia, Castrovillari 2003; *L'anemone rosso e gli uccelli di De Rada*, studim etnolinguistik, Castrovillari 2006; *Con Dioniso verso Costantinopoli*, Castrovillari, 2006; *Good bye Shin Vasil*, Castrovillari, 2008; *La Chiesa dei Profughi*, Castrovillari, 2014; *Gli agrimensori del Re*, Castrovillari 2018; *Lo specchio e l'ombra*, 2018; *La crisalide e la forma degli silenzi* (Nimfa dhe pjazma e heshtjevet), 2021; *Il futuro sta altrove*, Castrovillari, 2022 (E ardhmja qëndron diku tjetër) duke zhvilluar kështu paralelisht dy fillet e interesimeve të tij pasionale: të poezisë dhe të studimeve.

Zogjtë që do të kenë humbur këngën dhe popujt me shoje prej ajri

Fillin e studimeve e kishte nisur me monografinë për Shën Vasilin, për t'u mbledhur në një fokus më këndgjërë të interesimeve, që është ai i studimeve etnolinguistike për arbëreshët në krahasim me Ballkanin, domethënë për botën shqiptare-arbërore, çka ngërthen vetiu aspekte historike, aspekte gjeografike, aspekte të mërgimit, prandaj të krahasimit me botën që rrethon komunitetet arbëreshe, me botën ballkanike, me historitë në njërën dhe në anën tjetër, etj. Libri i tij *L'anemone*

rosso e gli uccelli di De Rada sjell vështrime pasionale nga hulumtimet etnolinguistike të autorit në këto relacione për *Vdekjen, Lindjen, Trupin si tregues të emocioneve, Qarkun e ngjashmërive ballkanike, Zërat njerëzorë, të grave, të shpirtit e gjuhës së veçantë, Bekimet-mallkimet-sharjet, Mjedisin, Kufijtë tokësorë e perimetrin e shpirtit, Hënën-kohën, diellin-vrojtimin, ujin-kujtesën dhe harresën, Kafshët totemike, Dendromorfizmin, bimët e lulet, Perceptimet e ngjyrave, Sëmundjet dhe akromatizmin terapeutik*, për të përfunduar me *Shqiptarët në vështrimin antropologjik të udhëpërshkruesve*. Solla gjithë përmbajtjen e tij për të theksuar aspektet e ndryshme të hulumtimit në një fushë jo shpesh dhe jo shumë të elaboruar në botën albanologjike, aq më pak për arbëreshët. Në lëmshin e madh të botës së sotme me shkrirjet dhe universalizimin, Bellici parapëlqen të shohë nga afër dhe nga brenda “bashkësive mjaft të vogla dhe tradicionale, në të cilat të ketë mbetur e gjallë lidhja midis kulturës, gjuhës dhe mendimit, të saktësuar dhe të konsoliduar në rrjedhën e një historie kulturore”, siç parapëlqen ai të thotë me fjalët e etnolinguistit italian G. R. Cardona. Hulumtimi në simbolet dhe simbolikën, në gjërat që, sipas Bellici-truhen në njatë “freezer të lashtë të gjeo-historisë” përtej mërgimeve, si segmente të rëndësishme popullatash “antropologjikisht dhe etnikisht të tjera, komunitete kryesisht të folësve kultura e të cilëve është rikuperuar, kryesisht

përmes pasqyrës së gjuhës së shkruar”, në rastin konkret të zonës albanofone, i delte atij jo i mjaftueshëm dhe i mangët. Të pakta kanë qenë studimet antropologjike dhe etnologjike për lidhjet dhe ndikimet e ndërsjella midis gjuhës, kulturës e mendimit, ndër të tjera, edhe për shkak të gjuhës italiane të kontaktit, e cila “nuk e ka bërë urën njohëse për të ‘hyrë’ në këtë të menduar dhe në këtë kulturë”. Studimet episodike që ishin bërë, sipas tij, nuk japin mundësi të nxirren prej andej njohje universale e linguistike, por sikur japin certifikimin e vdekjes (së prezumuar?) të alteritetit antropologjik të arbëreshëve. Studimet e thelluara linguistike të Çabejtë, me depërtimet e shumta etnolinguistike, natyrisht, në frymën e shkollës *Fjalët dhe sendet*, i kishin dhënë atij dhe një frymëzim në këtë pikë, “pas më shumë se 30 vjetësh, asnjë studim nuk i ka rimarrë hulumtimet në fushën antropologjike dhe etnolinguistike midis arbëreshëve dhe shqiptarëve me kriteret shkencore”. Karakteri specifik gjeopolitik dhe aspekti periferik kulturor i botës ballkanike, bashkë me fatin folklorik, që, sipas tij, shteti italian i kishte destinuar diasporës së tij albanofone, vetëm sa e kishin vështirësuar çështjen. Prej këndeje mund të nxirret konstatimi i hidhur për stagnimin e hulumtimeve dhe për nevojën e theksuar për të pasur një qasje metodologjike krahasuese, sinkronike e diakronike, “mbi kulturat e popullatave autoktone dhe të diasporës që falsin

‘të njëjtën’ gjuhë, por kanë zhvilluar ndjeshmëri të ndryshme”. Bellici, pas kësaj, sprovën e tij e sheh si frut të një pune ‘anakronike’ individuale, për të rimarrë fillin e diskursit për t’i përkapur të dy realitetet dhe për të bërë urën midis tyre. Ballkani, me “popujt fluidë dhe mërgues, të aftë për të ruajtur dhe prodhuar në ecje forma të ireduktibilitetit”, “me fatet e reja në shoqëritë e desakralizuara që po ndeshin” atij i duket posaçërisht me interes. Këtu ai i rikthehet figurës së De Radës për ngjashmërinë tonë me “zogjtë që do ta kenë humbur këngën”, ku ‘burimet e ligjërimeve tona kanë shterrur’, ‘objektet janë bërë inerte, të ftohta, pa shpirt, simbolet të mbyllura, poiesis e inçepuar, zërat e shpirtit pa rrëfim’. “Duhet ta ri/ëndërrojme mitin, të bëjmë të vazhdojë poiesis, ta rikomponojmë trupin e shkrirë të Adonisit, trupërat tanë, simbolet”. Kjo ndërmarrje hulumtuese në mitet, ritet, simbolet, në lidhjet midis gjuhës e botës, në kërkimin e tyre tek arbëreshët dhe tek shqiptarët, në krahasimin dhe ofrimin e tyre në një vend, për Mario Bellici-n është dhe një mënyrë për ta rindërtuar tërë gjeohistorinë e një bote, për ta parë atë ashtu si duket përmes simboleve të saj, po në të njëjtën kohë edhe për të parë diçka më shumë për vetë simbolet, për lidhjet e tyre me objektet, etj. Bellici poet sikur nuk le pa çarë dhe në këtë fushë. Por për ne këtu nuk mund të vazhdohet më tej, sepse përpara kemi një përmbledhje relativisht të plotë të krijimtarisë së tij poetike, e cila kërkon vëmendjen e saj.

Kush jemi ne tash?

Në letrën që më dërgonte më 1997 Mario Bellici, bashkë me 12 vjersha arbërisht, kishte vënë këtë shënim: “Kam edhe më poezi po tani s’kam koh. Duall dielli e dal jasht te bej kater hapa e te verej malet pse gjith keta gjera bine ndihem Perendi ...”. Ai atëherë ndjehej Perëndi tek vërente malet dhe bënte katër hapa derisa po delte dielli përtej Moresë së tij të Bukur, në Shën Vasil. Sapo të kthehej nga horizonti i maleve, nga ajo që Zef Skiro di Maxho nga Sicilia do ta quante ‘elemente të natyrës’ - erë, zjarr, tokë, ngjyrë, sapo të kthehej “bujk i një fushia/ ku bihen shega”, te parajsa që e bën “banor të një gjuhia/ e shkrifinj/ sikurse t’ish plot me sfrodhulla” (kundërshti), bëhej dyshues me të madhe: *Who are we now?*, poezi të viteve ’80, të njohura për ne vetëm në vitet e vona ’90 të shekullit XX. Me “Kush jemi ne tash?” dhe poezitë e tjera Mario Bellici-t, për Zef Skiro di Maxhon, “kërkon identitetin e veçantë kulturor, ndërgjegjen e ‘arbërit’, që këtu lidhet me atë politike dhe shoqërore”. *Era, zjarri, toka, ngjyra, deti* janë gjithnjë atje në poezinë e Mario Bellici-t bashkë me mrekullimin me lindjen e diellit, me horizontin dhe malet, me qiellin letër dhe detin bojë, siç do të thoshte ai, bashkë me njetë ndjesi jugu mesdhetar, po *ne kush jemi tash?*, pyeste Arbëreshi. Po, Arbëreshi, që “bën pjesë në një seri pakicash: gjithë bota kalabreze, madje gjithë

jugu i Italisë, është i ngjashëm: zinxhir pakicash ku gjen edhe tjetërsimin, e sidomos mbijetesën e vështirë...”. Atëherë kisha përmendur shqetësimin e Bellici-t për fatin e grupit etnik pakicë në një situatë ishullore “në periferinë kapitaliste”, ku ndërlidheshin, të qenit provincë, viset narkotizuese, marginalizimi, mungesa e komunikimeve të brendshme, mungesa e kujtesës, e gjëra të ngjashme, që, në idetë e tij përbënin “çështjen e jugut”, në tërësinë e së cilës hynte edhe ndjenja e ‘efektit të etnocidit’. Në tekstet jopoetike të atëhershme, si parathënie e shtesa të tjera, ai nuk linte pa përmendur qëndresën ndaj “integritit dhe homologjimit” me pasojat e shprishjeve shoqërore, sepse, siç mund të shihej dhe te mendimtarë italianë apo të tjerë, “ata që nuk kanë rrënjë dhe janë kozmopolitë” i shtrohen “vdekjes së pasionit dhe njerëzores”, Mario sikur kërkonte të ngjizte një “fshat që gjëllin në kujtesë”, të cilit do t’i kthehej vazhdimisht imagjinata dhe zemra, për ta “riplasmuar në zë universal” përmes veprave të dijes apo të poezisë. Dhe për të thënë diçka edhe për një ndjenjë të tij për të qenë luftarak, ai atëherë, në parathënie italiane kishte indikuar një fill që të çonte tek një “vepër e viteve ’60 të poetit amerikan, vat i brezit beat, Ferlinghetti”. Por “kush janë tani etnikisht dhe antropologjikisht arbëreshët?” ishte pyetje së cilës as atëherë dhe as tash nuk i jipet një përgjigje e lehtë dhe njëkuptimëshe. Por ai

vetëm pyeste, ashtu sa për të shprehur atë aspekt të të pyeturit që, sipas R. Barthes-it, derisa ka një subjekt të cilit i drejtohet, përmban agresion. Po kujt i drejtohet kjo pyetje e Bellici-t? Atij vetë, arbëreshëve, neve të tjerëve, italianëve, lexuesve të çfarëdoshëm, rruzullimit, Zotit, të gjithëve përnjëherë apo askujt, kjo mbetet pezull. A thua? Po plagët që u kanë shkaktuar arbëreshëve, si dhe pakicave të tjera etnike, fenomene si papunësia, emigrimi, konsumi, integrimet e detyrueshme në shoqëri më të gjera, e fenomene që përpiqeshin të shpjegonin dijetarët edhe italianë e kalabrezë me ndjesitë që prodhojnë e vrojtimet poetike sikur rrinë galuc në poezitë e Bellici-t të vëllimit *Who are we now?*, sepse, siç e thoshte vetë në atë parathënie “di më shumë i marri në shtëpinë e vet, se i urti në shtëpi të huaj”. Më në fund, aspektin kështu të papërcaktuar të pyetjes sikur e gjejmë edhe pak të formësuar në fjalët e tij jopoetike derisa sugjeronte se po fliste nga aspekti i vështrimit “të trupave gjeografikë të ekstrapoluar dhe të zhvendosur në një territor gjithnjë e më shumë të privuar nga katër këndet themelore: nuk ka më kënde themelore! Para kataklizmave të tilla shoqërore, edhe poeti, posaçërisht ai arbëresh, është gjithnjë e më shumë lakuriq!”. Duke përfolur apo rimarrë diçka nga pasthënia për librin “Who are we now?” që botuam te Dukagjini më 1997, në atë gjendje që kishim ne atëherë gjithsesi me ndjenjën e trandjes së

këndeve tona themelore, po dua të vazhdoj më tej në fillin e të pyeturit për poezinë e Mario Bellici-t dhe të pyeturit që bën ajo, për autorin, për një subjekt, për ne, duke dashur të marr vesh diçka më shumë. Në librin e bukur të poezive me titull “*Last exit to Bukura Morea*” përfundon me një vjershë gati homonime: “La Bella Morea o Elogio dell’atopia”. “E Bukura More ose Lëvdatë i pavendimit” më duket se mund të ndiqet njai fill, apo edhe diçka si ‘kënd themelor’, e që mund të jetë pikërisht *atopia*, apo *E Bukura More* me tërë kujtesën, historinë, mitet, shpresën... Përkthimin e bukur shqip, përfshirë ndonjë ngjyrim të këndshëm arbërisht, sikur e errëson fjala *pavendim* e përdorur për të përkthyer fjalën *atopi*, që lidhet me *topos* – vend, *topia*, që shoqërimisht të çon te *utopia*, etj. dhe jo te *vendimi*, pra nuk ka një përkthim të përshtatshëm shqip-arbërisht dhe do përdorur pikërisht ashtu siç përdoret dhe italisht apo në çfarëdo gjuhe tjetër, pra “Lëvdatë atopisë”. Dhe ç’është kjo lëvdatë për atopinë? Në kopertinën e librit italisht ishte bërë shpjegimi: *Nga Historia te heterotopia*, tjetër-topia, ndërsa brenda i kushtohet poetit arbëresh Zef Serembe, “poet me këpucë prej ere” (mbase *shuaj* më parë se *këpucë*). Dhe mua më duket se kur i rashë në fund librit gjeta fillin, atë atopinë, të *Bukurën More*, të përthyer në heterotopinë e Mario Bellici-t, që, siç mund të pritej nga një poezi me referim te frymëzimi serembian, nuk të rrëmben

me kërkimet në shprehjen, as me sentimentin e rrëfyer, po më parë me njetë shtrirje borgesiane në kohëra e hapësira, në vende e histori, në mite e të vërteta, në besime e ndjesi, dhe në kalimin nga njëra tek tjetra ashtu natyrshëm. Kujtim, lëng jete, ëndërr, cak i paarritshëm, i humbur në ndërdijen, pjesë e pavetëdijes, diçka si Itaka, topos atopik:

*Pesë shekuj, po këndoj një kthim të pamundshëm
në të Bukurën More*

Dhe ky këngëtim vendoset në brigjet e Jonit, në Mesjetë, afër zjarrit të kasolleve, po të kasolleve që kujton të jenë ndërtuar nga Peshkopë e Princa, në udhë të padukshme, afër dallëndysheve afrikane, në muzg të kohëve, të çon te bujarët që

Mbollën

djallëzoren vazhdimësi të së tanishmes

dhe në bebëzën e vesës së bijve

vendosën

trashëgiminë e ditëve dhe ethet e ringjalljes.

atje, në brigjet e Kalabrisë dhe të Bazilikatës, ku gratë krenare vështronin në tërheqjen e saj mrekullore *Morenë*, e bashkë me to dhe ne bijtë plot mahnitje

shikuam mëmat të stolisura me yje

dhe fushat e shegave

që e folmja-vizatuese e tyre

na qëndiste në purpurën e kujtesës.

Zefi (di Modika) thotë se do ta ketë parë të *Bukurën More*, e cila mund të jetë ‘lidhja e besës me kohën/malli endacak për bashkërenditje’, por *E Bukura More* e Marios është

Ndoshta

*vetëm një trandje e përkohshme
që çel hapa në të tanishmen
e asgjëjtjetër.*

Sipas zakonit që ka marrë në këtë vëllim, Bellici e shihte të nevojshme të jepte dhe disa indikacione fare konkrete për këtë italisht, ndër të tjera se Morea është një rajon i pëlleshëm në jugperëndim të Peleponezit, ‘i lënë nga stërgjyshërit e mi në vitet 1520-1530’. Pas Jeronim De Radës, vargjet e bukura të këngës-poezi “Oj e Bukura More”, me gjithë atë “trishtim të thellë”, e që “prindërit tanë të mërguar e këndonin për çdo Pashkë të drejtuar nga Deti Jon”, i kishte rigjetur Luigi Petrassi. Dhe Mario vijon me referenca: ndërtimin *verbopane – foljebukë*, thotë, e mora nga Majakovski, ndërsa *wronja – shôfar*, briri-fyell për të shpallur ngjarje me rëndësi, i kishte ardhur nga ebreitët, kurse Zefi ishte vetë Zef Schirò di Modica, përkthyesi i poezisë, për të na zhytur kështu në labirintet e gjera rruzullore. Por kjo poezi vinte në fund, pas Parathënies dhe Hyrjes, italisht, shqip e anglisht,

pas ciklit *Shqipëri/ Albania*, ciklit *Arbëria*, pastaj ciklit *Kosova* dhe në fund fare *E Bukura More/ La Bella Morea*. Aty përmbledhej një pamje-ndjesi për atë atopos, për njetë tokë të premtuar “që çel hapa në të tanishmen” dhe s’është asgjë më shumë, apo asgjë dhe gjithëçka? Siç thotë Mario, pika e nisjes është *gjitionia*, është vatra, që s’është Itaka, sepse Itaka sjell me vete të tjera tundime, sjell shoqërimin e idesë odiseane megjithë përballjen me veten, me “rrugën për mrekulli që të dha” (Kavafi), duke marrë rrugën e shndërrimeve, pra gjitionia, një topos-mitër për Bellici-n, s’është më, prapa saj kemi vetëm hapësirën boshe, “një paraqitje hyjnish të lashtë pa vendbanim”. Trishtim? “Pas shpërnguljes së të ikurve shqiptarë të shek. XV në brigjet e Italisë, një farë **imprinting gjenetik** trishtimi dhe shastisjesh gjeografike po ndjek prej pesë shekujve historinë e kësaj thyezë të lindjes. **E Bukura More** ka qenë (dhe është) një luftë vigane luajtur në fushën e integritit e të alteritetit, një shpresë në rikthimin e atij dheu”. Tjetër pas tjetrit, me trishtimin për shprishjen e gjitonisë, me trishtimin gjenetikusht të mbrerë, me shastisjet gjeografike, po *kush jemi ne tash?* Mario Bellici nuk i mban larg engjëjt e referimeve të veta – de Rada, Serembe, Trakl, Rilke. Dhe është ky i fundit që i frymëzon njësinë mistike të lidhur me mjerimin e gjuhës që ka formalizuar pikërisht caqet e veta, duke bërë që e dukshmja të bëhet e padukshme dhe e kundërta, por ia bën të

mundshme ikjen nga Shila e lokalizmit komunitar, që atij s'i duket zgjedhje assesi, ashtu si nga Karibdi "i prishjes abstrakte në hapësirën pa vende të globalizmit duke gjetur një lloj *dhi-dre* – hapësirë e dyanshme, hapësirë konceptuale në të cilën mund të mbahen lidhje kolektive 'të gjata' për të kapur dije e kultura botërore dhe për t'i zbatuar në vend për formimin e identiteteve jo të paqësuar". Po këtu i del atij Shqipëria, e kaluara, shek. XV, por tani e mishëruar me të tashme tjetër gjeografike e antropologjike në Itali; Arbëria, "zonë arritjesh për të ikur, zonë kalimi vazhdimisht e ekstrapoluar", që malli dhe e ardhmja e fusin vazhdimisht në kujtimin e Tokës së Premtuar, të Bukurës More, "tashmë vetëm një *locus* magnetik i shpirtit e jo më krahina pjellore në jugperëndim të Peleponezit, e braktisur nga të parët tanë në ikje gjatë viteve 1520-1530! Ajo është po një erëz, një qëndisje e bukur te truri im, një kujtim i pandërprerë, jo më lidhur me tokën, por me atopinë". Në këtë ankth kërkimesh topikë, apo më parë fragmentesh të një topike në njetë rrugë mrekullitare të frymëzuar nga Engjujt e Rilkes, Mario Bellici papritur dhe jo më në kujtime ndesh përfundimisht Kosovën, "territor shqetësues në *puzzle*-n e Balkanëve, i shënuar me kufi, ku historia kapërcen gjeografinë". Dhe ku të ndalojmë, tutje vijoje "topoi që shkatërrojnë sintaksën dhe pjellin Arbëri të tjera në Gjermani, në Zvicër, në Maqedoni, në Amerikë, një farë (h) eterotopie". Shqetësimi i Mario Bellici-t është

si të mblidhen ato copëra më se pesëshekujsh, “ikja e trupave, e zemrave, e truve të arbëreshëve, kosovarëve, shqiptarëve, maqedonasve, arvanitëve në një shekull të pastajmë, me pak fjalë në shek. XX”. “Filigrani i kësaj pune borgesiane s’do të ishte sigurisht pa *red shift*, pa hutim, pa ri/krijim të krahinës së re historike e gjeografike ku jetojmë e bëjmë ëndrra ,... të kufijve të rinj, por më shumë të krahinave tona psikike mendore”. Ngushëllimi për Marion vjen nga fakti se ndër ‘popujt me këpucë prej ere’, pra nga të shpërngulurit e tjerë, krahina e tij është tmerrësisht afër Greqisë, e cila i ruan arketipat në formë hyjnish, ndërsa ne mund ta stilizojmë Kaosin hyjnor. Në këtë makth topie-atopie-heterotopie-utopie, librin *Last exit to Bukura Morea* Mario Bellici e fillon me vjershat për Shqipërinë/ Albania, të shkruara italisht, arbërisht e shqip apo ndonjëherë arbërishto-shqip, diku vetëm arbërisht. Fillon me *Ide vetmie e markadesha*, ku, ashtu siç paska bërë vetmia që xixëllonjën ta quajmë me kaq shumë emra, po ashtu dhe po ajo vetmi paska bërë të paskemi shumë emra për shqiptar, emra që, për të parën si për të dytën, “askush i kujton”. Do punë të gjejmë gjuhësisht zëvendësimin për emrin *xixëllonjë*, antropologjikisht për *shqiptar*. Po nesër, do të ketë vetëm një emër për *arbëreshë*, *xixëllonja* dhe *vetmi*? Apo do të jetë vetmia e para? Këtë hyrje me distancim trishtues e ndjek pamja e *Qiparisave të Mnemosynës*, e zhytur në ndërtekstin e Arsitofanit

dhe të gurëve të varrezave, që nuk ngurren të na i shpjegojë Bellici i dijsëm në shënimet italisht, ku në mëngjes katundi zhytet në detin Jon dhe sjell me vete gërmimet arkeologjike dhe “natën me krahët e zi”, që “ka pjell, për herën e parë, një vezë plot erë”. Në Mnemosyne (vend i kujtesës?),

*Nga parathira ruaj i çmendur¹
këtë ëndërr pa krye me diellin ndër sy*

Dhe më tej hapësira të paskaj me popuj të vënë në linja të pafund të ikjes, duke “sfiduar manjetizmin e Historisë dhe të Qëllimit të saj”, “çekuilibrim hyjnor”, pastaj me ndërgegje të çrregulluar largohem nga vendi me vetëm një grusht gërdhuze shekujsh të patrajtë, më tej vargje pamjesh për mohime lëvizjesh, “burgje ajërore”, dhe fët një *Lutje me porosi*, shpërthim shpjegues i trishtimit në lirikat e mëparme me një lirik në zë, *poetin me kostum të bukur e kravatë blu*, që ka ditur të këndonte “për socializmin, për partizanët e planet pesëvjeçarë”, për të nesërmen, por që tani, ata që kundërshtojnë në sheshe nuk ngurren t’i quajë “huliganë, leprozë e lepuj”, vetëm sepse

*Shumë nga ata ikin
nga deti e nga malet, drejt tokës së Kanaan-it
që pastaj ata thonë se është
Amerika, Italia, Gjermania.*

¹Nga dritarja vështroj i çmendur.

Kjo polemikë poetike nga Hora më 4 janar 1991 e sjell sërish fare konkrete qenien ‘në kërkimin e tmerrshëm të drejtësisë’, ekzistencën e rrezikuar nga vetja, arsyen e ikjes, të ikjes pas shekujsh, të ikjes tek të ikurit. Të këtilla motive e motivime dalin përpara te poezitë *Një letër për një shqiptar i mërguar*, edhe më shumë te *Të kuqtë e Onufrit* me pamjet e rikthyera të sh. XV

*ata të tri galerave të Andrea Dorias...
E para me pëlhura e mëndafshe
e dyta me bukë, verë e vaj
e treta me burra e gra ...*

nga vendi

*... ku do Kadareja se Akeronti rridhte
e shqiponjat bënin foletë e tyre*

që ndodhet në Lindje e Perëndim, me dëshmitarët me fytyrën tënde hëne, si prej katërqind para Krishtit,

*Anije të papritura
e para me hashish e kallashnikov²
e dyta me rrufjanë e lavire
e treta me fëmijë e të uritur kërrabaça...*

²Vijëzimet në mes sikur sugjerojnë çka mund të mos duam të themi apo dëgjojmë.

*Të prurën natën në portet e Brindisit, të Otrantit ...
në mendje*

njëj me polake, braziliane, zezake

... më fal trupin tënd, sahatin tënd

për një grusht dollarësh ...

për të marrë përgjigje që kalon ndjenjat,
përftyrimet, përgjigjet metahistorike, cikle epike,
sepse “mbase ti je nga Berati”, ndaj

*e vetmja është një farë tragjike,
motër shqiptare, që mund të jap.³*

Në vijimin e domosdoshëm si *Red shift* për ‘tokën
e etërve të mi’, të atyre që na mësuam ikjen matan
detit, po edhe njëerën spirancë të Shpirtit - vlerën e
besës e të miteve, duke sugjeruar si një namë për
ikje, për të ndryshuar pas shekujve në

...Tokë pa bij

të gjithë të mërguar

tokë me etër pleq

etër jashtë Historisë jashtë Kohës...

kjo ‘ikje e Tokës’ vjen e ta përplas në fytyrë tërë
zjarrin e të kuqes së ikonave të Onufrit, sepse

³“E vetmja gjë që mund të jap, motër shqiptare, është një farë tragjike”.

*nuk ka më Ferra nga të cilët të shpëtosh
Parajsa për të kapur.*

Në vrullin e të gjallës nga lidhja e hulumtuar
arbëreshe-shqiptare, arbëreshe-ballkanike, të
përjetuar kështu rëndë e thellë, pas parabolave
deradiane, Bellici vjen me shpjegime lirike, me
pikasje pamjesh të ngurtësuar:

*Burgje ajërore
këtu o atje
të fshehura.
Brenda shqyren
trima
si flamuj gjaku të piksur.*

Dhe në të tilla përkapje lirike, përtej dialogut me
të gjallën dhe të gjallët, më duket sikur shpërthen
liriku Bellici. I tillë ai është në tërë lirikat nga
ciklet arbëreshe, nga njato pamje si në qiell të
fiksuara, të pastra e të ngjeshura, transparente në
ngjyrësinë e tyre tejkohore. Në njatë thjeshtësinë
e tyre deradiane dhe në transparencën e imazhit,
më shpesh në mesazhet, më dukej se kisha gjetur
diçka të ngjashme, të asociueshme me poezinë e
autorëve oksitonë të sh. XX. Bellici në reflektet,
Bellici poet, Bellici jo-dialogues, i qetë e jo-i-
revoltuar, zhytet më thellë, shkon më tej, përtej
topoive konkretë, në atopinë e tij, apo më parë në
akroni, bëhet i kthjellët. Dhe në këto kthjellime

më shpesh gjuha e vendit të tij, arbërishtja me tërë begatinë e leksikut të saj të veçantë, aty-këtu e spërkatur me fjalë të shqipes së sotme. Poezia e Bellici-t, më duket, nuk mund të kullohet kështu në lirikat e shkurtëra pa njato kërcime në të në gjellën e ndyrë të kohës me topitë e saj të veçanta - Arbëri, Shqipëri, Kosovë.

Dhe poezinë, që ai diku do ta quajë dhe poezi-reportazh, për Kosovën dhe për realjet e saj Bellici do ta fillonte me një mbindërtim të gjerë tek *Barbarët* e Kavafit për ligjvënësit që presin të vijnë barbarët, me poezinë *Nëse dallëndyshet vijojnë ta ndërtojnë follenë në Kosovë ...*, ku këta barbarë, vijnë po me ligjet e tyre, por ndryshe nga të Kavafit,

*ata i kanë ligjet e veta
të hekurta e të flakshme
ligje thundrash të xhipave të zinj*

*Ndërsa helikopterët me zhurmat e tyre
nuk lejojnë të lexohen poezi*

*gazrat lotsjellës përlotojnë sytë e dallëndysheve
kuadrigat e barbarëve shpërndajnë
të ikurit, prej gjaku,*

...

*Asnjë balonë e asnjë akullore
helikopterët nga sheshi largojën
flutura, dallëndyshe, gra dhe pleq,*

fëmijë të ngatërruar me përralla të mërzitshme

...

*Kapitan Arkani do ta ndalojë edhe pirjen e duhani
për shkak të tumorit në mushkëri
që Beogradi ose OKB-ja paturpësisht
do t'i fajësonin gazrat lotsjellës,*

për të vijuar rrëfimin përtej ironisë

*barbarët pastaj mbërrijnë në Drenicë
para kohës së paraparë
për shkak të klepsidrës së prishur*

dhe megjithë hijedritat e historisë, megjithë heshtjet e
Herodotit e të Tukididit, ka diçka që bën që

*pas shumë shekujsh dallëndyshet
vijnë t'i bëjnë foletë në Prishtinë
domethënë se pranvera s'qe shuar, as mbytur*

Siç dinë dhe thonë poetët më mirë se historianët. Kjo poezi që shkruar më 5 mars 1998 italisht, mbase, sepse në atë gjuhë poeti Bellici donte ta gjente lexuesin që mund ta përkiste. Këtu botohet shqip me përkthim të A. N. Berishës. Po e marsit 1998 është dhe poezia *Me fytyrë kthyer kah Meka*, për sulmin e barbarëve në katundet e Drenicës, për qëndresën e Jasharëve, të shënuar me numër dhe me emra, për masakrën makabre, kur

*policia barbare
i varrosi në një varr të përbashkët
të martën në mbrëmje, në shpejtësi, pa rënë terri,*

Por që të afërmit i zhvarrosën një nga një për t'i vendosur në arkivole, duke shënuar dhe pamje të denja për ekspresionistin Benn:

*gjëja që vërejtin fotografët
nga çarçafët e bardhë
ishte një grumbull mishi i paformë
në një arkivol me ngjyrë të kuqe
ishte një fletëz mbi të cilën shkruante 'djegur'
brenda një fëmijë i shkrumuar pa ditur se kush ishte.*

Ky 'reportazh poetik' i Mario Bellici-t, ndryshe nga ai kur nuk mund të ofronte më shumë se njëfarë tragjike, vjen e përshkohet me *Betim në gur*, mu si te Kanuni: *Ky Dhe është Dheu im*, për ta shpallur solemnisht, pse jo me patetikë që vjen prej thellësive kohore të Kanunit, prej akronosit, identifikimin e poetit:

*I sillemi tri herë
tri herë kufirit të dheut-varr
Kosova ime e stërvuajtur
në supet e mia të lodhura prej poeti
një gur dhe një plis.*

‘Reportazhin’ e tij poetik Mario Bellici e vijon në vitin 2000 duke shkelur dhe prekur Dheun e Kosovës në njetë gjendje kaosi që do ta quajë Babiloni, provincë e Prishtinës.

“Kosova mund themë se është pranë Eterotopia-s”, shënonte në fund Mario Bellici, i cili në këtë vëllim vijon me ciklin *Maqedonia*, vendi ku, pas tij, “historia është trans dhe nevon shumë kujdes”, vend ku “gjunjët e statujave guri/ janë me xhumba e gjak”, pra

Kimne besë kështu zë fill Liria!

Libri vijon me ciklin *E Bukura More*, të cilit i paraprin shënimi nga *La vie immédiate* e P. Eluard:

Kënaqësia për të udhëtuar

Drejt gjallesave të harruara

Nëpër rrugë të paharrueshme.

Atopia e Bellici-t nuk kuptohet mirë po s’u përkap jo si të thënë të nënkuptuar, po më parë si praktikë në tërë këtë vorbull, po them prapë, borgesian, të ndërthurjes së të tashmes me të shkuarën, të gjeografisë me historinë, të mitit me realitetin, të tekstit me ndërtekstin, të toposit me atopinë, të mëtesës dhe zhuritjes për ta rigjetur fillin përmes shkrirjes gjuhë/ mendim/ ndjenjë/ pamje të asaj topie të kudokërkuar, të rigjetur gjithandëj në popuj me shoje prej ere, pra rruzullorë, e kjo domethënë me gjuhë që shpreh më së miri mendimin/ ndjenjën,

paçka se e folme, dialekt, gjuhë standarde, italisht, citat anglisht, fjalë të huazuara, apo të gjitha përnjëherë. E megjithatë, Mario Bellici lirikat e tij më të ndiera i shkruan më së shpeshti arbërisht, gjithsesi me mjaft ngjyrimë nga shqipja, por pa ia hequr atë që ai do ta quante ‘zdral’, pa e lëmuar, por shkruan të tjera në shqipen standarde me xixa arbëreshe, apo edhe italisht, me përkthime në gjuhën standarde, më shpesh nga të tjerët. Është ndonjëra syresh më e përshtatshme? Jo, Bellici në atopinë e tij thjesht ka nevojë për të gjitha. Për mendimin tim, në letrat shqipe/ arbërore Mario Bellici, më shumë se si studiues dhe përtej të qenit i revoltuar i përjetshëm, përtej nevojës për të mos e fshehur këtë, më shumë se veprimtar, është sot një nga të shquarit e poezisë arbëreshe.

YSHTJA DHE NDIJIMI

Dilmë përpara Naim Frashëri
 Sot unë jetoj dhe shikoj vegimet e tua
 botën tënde ajrore të shndërrimeve.
 Vdekja midis nesh, si zjarr në kallama,
 s'nderohet më, motra jonë Vdekja!
 S'i vë kufi jetës së turpshme që mendove?
 Mbi këtë tokë mishërohet ajo jetë apokaliptike
 që Ti ëndërrove në Bagëti e bujqësi.

*Gjësendi s' humbetë kurrë, e gjë s' vdes me të vërtetë,
 Mase ndryshohenë pakë, po janë në këtë jetë,
 As shtohet, as pakësohet, as prishetë gjithësija,
 Vdesën e ngjallenë prapë si gjith' edhe njerëzija,
 Këtu janë gjithë ç'janë, e gjithë ç'gjë munt të jetë,
 Ëngjëllitë, perënditë dhe ajy Zot'i vërtetë!
 Se një trup e një shpirt është gjithësija, që s'ka anë,
 Të gjallë edhe të vdekur, gjithë brënda në të janë.*

Unë bashkëjetoj me njerëz
 (kurrë të lindur)
 që s'kanë më fuqi të mos të vdesin.
 Në një ankth më shkelin syrin
 më dhurojnë *koka kola* dhe raki

te *fast food*-i i fundit
 i kësaj gjithësie monotone.
 Ringjallen vazhdimisht pa pushim
 brenda rrethit të lodhur i π .
 Pra hiqi maskën asaj vajze
 e mjera është e kalbur
 dhe qelbet si manushaqe' pa erë
 qeshin brenda një valleje mortore.
 Maskat e motit arkaik
 të skalitura dje nga Pleqëria dhe Vdekja në fytyrë
 këtu sot
 i sjellin njëzetëvjeçaret lozonjare.
 Maska dhe shtirje, Vdekja fshehet në jetë.
 Ndhëm moj Naim të çaj atë rreth!

Dua të jetoj vetëm një herë
 me frymën e ftohët, yjore
 që rruzullimi më dergon në fytyrë.
 Dua të jetoj
 tue ecur drejt një zhvillimi jashtëqendror.
 Naim, i përvuajturi maratonist!
 Me vrapjen tënde vigane në kohë
 na prure lajme të vagëlluara, ... mbinjerëzore.
 Dhromi¹ im
 më prori shkatërrimin e kuptimit

¹Udhëtimi

më ka rravguar për dreq në shkretëtirë
në *boutique*-n e joshjes ekzotike të zhdukjes.
Prisjet magjia
në takoj të kaluarën.
Mjaft me shndërrimet!
Jetërsimi im lind
nga çrrënjësja dhe nga jo-kthimi, Naim!

TEK HAPET TRËNDAFILI

Sot Leka me kalin
 nevon të shkojë në një zyrë
 e pastaj te një tjetër zyrë
 ende do të kthehet prapë
 sepse njeriu-burokratikus-ushtarak i Ambasadës
 tha se
 dokumenti nuk ka vulën e Perandorit.
 Po kali do kashtë, modhull¹ dhe elb,
 barin e gjelbur që mbin
 andej ndër fushat, mbi kodrat.
 Kali po edhe Leka
 kanë një ide fikse.
 I thonë rojës që me përkrenare karte
 rri i ngurtë përpara diellit:
Tek hapet trëndafili, atje ma ka ënda të jem!
 E tha Naimi
 Ai më ka çelur kokën ... si zjarr në kallame.
 Perandori atëherë
 mallkon gjithë trëndafilet në Senat
 Senatorët, kalin dhe barin
 bimët, bukurizat e majit.
 Leka do ...
 Dhelpëria e Fuqisë

do të gjëj një rrugë shpëtimi
madje një korridor për Lekën
dhe për kalin besnik Byqefallin.
Po po ... do të shkojnë në shteg
një korridor të numëruar.
Nga njëra anë dhe nga ana tjetër
shtatore mermeri me cigare në buzë
dhe këmba në kryq.
Në thellësinë e zemrës
do t'i hapin një supermarket
të mjerit Lekë.
Brinjët e tij do të jenë rafte
këto ka menduar Fuqia për Lekën.
Sot më shumë se dje
është një ide revolucionare
të ndodhesh
atje ku lulëzon trëndafili.
Me gjithë se sot është Vjeshtë
dhe në Tetovë çdo gjë është e zymtë
gratë plot mirësi
rrinë pa folur në Pazar
duke qëndisur flutura argjendi.
Ejani zotërinj, zonja dhe bujarë
Shkojmë
atje ku lulëzon trëndafili!

¹grashinë

HIJE

Në Nëntor Maqedonia
është e tërë një shkëlqim
por pa dritë dhe afsh.
Në Ballkan
jeto het në dyshimin më të tejmë
ndër thyezat.
Këtu asgjë është e tërë
siç thonte Pessoa rreth Portugalit të vet.
Njëherë të mëdhenj
Ilirët dhe Leka
në librat historie paraqiten
sot me madhëri të kotë.
Gjeografia
është ëndërr e një sendi të bjerr.

A E SHEH SI PUNON GJITHËSIA?

Dielli, hëna, yj, dhe, qiell, kërcejnë në një valle
 bujku me cigare në buzë
 shet specat
 ngjyrë ylberi në pazarin e Tetovës.
 Një qerre pa yjësi e helqur nga kuaj mermeri
 shkon në një rrugë të kalldrëmtë.
 Myezini drejton ushtri lotësh shiu
 që zbresin tue vizuar sytë e fëmijëve.
 Vajzat ndër arat e ngjyrave
 përdorin të kuq qershie për të lyer ikonat
 dhe të kuq shege për gjakun e t'vdekurve.
 Kopshtet fëmijësh
 këndojnë me zë plepash
 fëshfëritës midis manushaqeve.
 A e sheh si punon gjithësija?
 Si dërsijnë shtjerrat
 brenda fanellave të trasha.
 avlëmendi prej druri është i kalbët
 dhe merimanga ari
 argalisin ëndrra dhe prralla.
 Por ankthet
 janë duke humbur rrugët nga shtëpitë
 zanoret nga abetarja, verën nga rakia.

Mijëra fytyra punëtorësh pushojnë
ca herë populli është shtjerrë manar
e kështu punëmbarrë, populli im

*njëri mih, jatëri lëron, njëri mbjell, jatëri prashit,
kush tharr, kush kor, kush mbledh duaj, kush shin
kush sharton, kush krasit, një bën pluar' e sëpatën*

....

Naim, është një unazë e mbyllur kjo punë!
Zemra ime valëvit flamurin e kryengritjes
mbi grumbuj gërmadhash
mbi anijet me të arratisurit
mbi dëborën e shtypur nga emigrantët zbathur
që s'lën gjurma
një flamur i shqyer
që mijë duar qëndisin me maja pyjesh
A e sheh si punon Gjithësija, Naim?

*Perendia e ligjesisë rri mbi kodrat e Hollywood-it
me leshra të florinjta e të ergjënttë krahorë
ball'e gush'e faq'e llërë dhe këmb'e duar dëborë.*

Sot është një kurvë
që lan flokët me lotët e të varfërve
dhe ka shqetësim
kur vizaton kufijtë me të kuq buzësh.

Nga shtigje yjsh të losur si gëlqere e bardhë
Profetë, bujq, fshatarë,
të shkretë, tufa trëndafilash,
një miliard bektashinj
përmbysin Arsyen e historisë
Naim
a e sheh si punon Gjithësija ime?

BUZË STATUJASH

Do të përpyjek buzë statujash
që buzëqeshin
ndërsa valltaret do të kërcëjnë
me muzika ballkanike
dhe shiu
do të jetë ritmi i frymës së bektashinjve.
Ankthi dhe kryengritja
për kufijtë gjeografikë
do të jenë regëtimat e ngulëta
mbi lodrat e Lekës.

KËTU HISTORIA ËSHTË TRANS

Në Tetovë, në mes një lulishte të gjelbër
mbi një kërcell mermeri
është kumbisur
me trajtë tregimi kryet e Naimit.
Këtu përballohet
ushtria për një shtatore të çmendur
që s'mendon më gjatë
të shndërrohet në pëllumb
dhe të fluturojë në Kumanovë.
Kapen pas një kezë malesh
një grumbull fshatra-ndërgjegje
fshatra kuarci dhe gjaku
vëzhgojnë tinëzarë luginën
për të diktuar Kod në dorë zakonet e vjetra.
Në cipën e periferisë
në Kohët e Kohëve
duar të mjerueshme shtrinë
ndër varrezat pllaka me Rrota dhe Diej
emra të vdekurish në luftat kundër fesë
për lirinë ose dashurinë.
Sot sytë e tyre të zymtë shikojnë
puthjet e dashnorëve të gjalla
këtë Rezistencë të jashtëzakonshme

minaret, lumin dhe lulishtet me trëndafila
akuarelet përrallore
që bujku paraqiti gjatë urave të holla.
Argjendarë-ëndërrues
krah për krah me kalldrëmet
ndër dyqane të vogla nxjerrin lajle ari
unaza me pika të planetëve në gjishtë të Gjithësisë.
Këtu historia
është trans dhe kërkon shumë vëmendje.
Thell syve të një lustraxhiu
pashë që ndrinte krenaria e Lekës.

SHTIGJE KOMETASH

Lë hije prapa
në këtë gjeografi të mallkuar të shpirtit
shtigje kometash
që ari i ikonave kurrë
do të fshehë.
Në kodër
i ndëjtur ndaj atyre peizazheve
Koha dhe rrjedhat e kryengritjes
bërtasin trupin tim.

GURI E LËVIZJA

Këmbë xathur mbi ferrat
një gunë e kuqe
një tërkuzë e zezë
çë pengon duart
sytë çë përgjojnë mbatan
më atej se mendimi.
Rrin statujat
me gjunjët plot xhumba¹ e gjak
ose një zdramë² te Sheshi rrotullor
atje me krahët e trimave
hedhin elb në ajër dhe rrugicave pilikaçë³.
Kimni besë
kështu zë fill Liria!

¹hematoma; ²plagë; ³lakuriq

VALLJA E RRETHANAVE

Një buxun¹ jet llamë¹
 i shtënë mbi një mozaik
 me staçaz² guri për truall
 pa trajtë
 Hapa një xhavidhe mbrënda³ hënës e detit
 një anie, një tank, një mijë raketa

fëmijë që me lot ikonash
 thërrisnin⁴ nga shpellat e Shpirtit të Kohës
 vallë të parakohës.
 Kosova një fushë pa bar

pa pema, botë e djegur
 këmbë që rrjedhin si milingona
 venë këtu e ktje të reshtura
 nga Perendi çeliku
 që fluturojnë në qiell pa dallëndyshe
 që pështuan vërtet n'atë herë
 ushtarë të egërsuar me gishta fitimtarë
 përpara fotografëve
 Ç'kanë fituar?

¹zip, kovë, kazan me lëtyrë, çorbë; ²astër, dysheme;

³midhje brenda; ⁴ulërinin

HIEROGLIF PËR ANTROPOLOGË

Nga shkrepimat drite të kompjuterit
 vete tue kërkuar me zemrën në gojë
 lajme mbi pushkatimet, spastrimet, shtegtimet,
 kundërshtimin e Ademit në mal, në Prishtinë,
 fije ndjenjash,
 lutje shumëgjuhëshe, kode të reja poetike.
 Mbatanë Rexhepi
 më pyeti për këtë shesh jugor
 për ne arbëreshët
 pakicë etnike mbeturinore dhe dinake
 hieroglif për antropologë
 “Në katund qëndroi vetëm ndonjë plak,
 arkitektura të lehta, të zbehta të shtëpive,
 lojërat e kroit me ujë tashmë harraq”.
 Ç’dua të të thom?
 Këtu historia ose para-Historia
 tue kulluar ka rrëfiksuar
 brez pas brezi droçka egërsie
 fotografi të zverdhura ... kujtime
 sot kemi palëvizshmëri, zbrazëti të plotë, vapë,
 rrugë të zbrazëta.
 Gjithçka është ekuilibër ngjyrash
 të kuqtë i errët të bashkisë

verdhësia okër e kishës
pylli me gjelbërinë e tij të mbyllët
bërryla të rëndë shekujsh të gjitonive lindore
dredhi i kundërshtimit
tragjik dhe si unazë
të birit të plakur bashkë me nënën
ose të arratisur dhe të bjerrë
përgjithmonë në gjeografinë.
Palëvizshmëri, zbrazëti e plotë, vapë, heshtje.
Jugu im
është një përçafim rrotullor dielli, i pafund.

LUTJE ME POROSI

I dashur Zot

të shkruan një bir që frekuenton
klasën e njëmijte të fillores për të treguar
gënjeshtrat dhe harresat e poetëve në librat
e shkollës sime ëndërrore.

Në klasën time

është një i shkretë që veç mallkon
e pështyn mbi librat e tyre.

Ai thotë që

këta poetë kanë bërë mëkat dy herë
sepse rrinë me duart poshtë, nga shumë vjet,
përpara këmbësorëve e fëmijëve.

Ata flasin dhe shkruajnë me metaforë
në fund të fundit, flasin për të Nesërmen.

Tani, janë mjaft të nxehur me të rinjtë

sepse shumë nga ata ikin
nga deti e nga malet drejt tokës së Kanaan-it
që pastaj ata thonë

se është Amerika, Italia, Gjermania.

Në mes nesh djemve

ai budalla i pakënaqur thotë që
zotërinjtë flasin gjithnjë për të Nesërmen.

I dashur Zot

çlirona nga mendimi i së Nesërmes.
 Ne të rinjtë duam të jetojmë
 si budallai i klasës sonë i dashuruar i lepujve.
 I dashur Zot
 bëj që të shikojmë në atlas
 të Bukurën More e kufijtë e Kanaan-it
 e që Deti Jon të shqyhet
 si u ka shqyer në filmin Deti i Kuq.
 Të rrëfej që emigrantët shqipëtarë
 janë të pastër por jo të drejtë.
 Në shtëpitë e tyre
 ishin të pakënaqur e të shfrytëzuar
 e nuk kishin shpresa.
 I dashuri Zot
 ideja e Fuqisë nuk do të ishte
 në qoftë se nuk kish qenë idea e së Nesërmes;
 jo vetëm kaq, por pa të nesërmen,
 ndërgjegjja nuk do të kishte shfajësim.
 Të lutem,
 ndizi mallrat e jepi pastërtinë e Kantikut
 poezisë së poetëve tanë,
 bëjë të jetojmë
 si zogjtë e qiellit e si zambakët e fushave
 e në kërkimin e tmerrshëm të drejtësisë.

E frymëzuar nga një poezi e P. P. Pasolinit 'Lutje me porosi'. Një nga poetët shqiptarë që sulmoi me dhunë të veçantë mijëra të rinjtë që ikën me anije nga Shqipëria drejt Italisë ishte Dritëro Agolli. Në gazetën "Zëri i popullit" i përcaktoi si 'lepuj dhe lebrozë', hooligan. Ish fillimi i viteve nëntëdhjetë...

NJË LETËR PËR NJË SHQIPTAR TË MËRGUIAR

Me sa fuqi i rrëmbehe këtyre gjërave të përditshme
pa vlerë, vëlla shqiptar.

Unë lirik e i qetë të flisja për lumin Lethe
të njoftoja me filologji të pasigurta
përralla mbi kodrat.

U zgjuam nga ëndërra në Nëntor të vitit 1990
gjatë bregut të detit Jonë
përballë Atdheu.

I kënaqur më the se në Durrës
zbukurojnë shtëpitë me shishe teneqeje e qelqi
që valat shtyjnë deri atje.

Nëse mendojmë, i dashuri,
tonat janë dy dukje të verbuara e simetrike
ti dëshëron mallra të magjishëm
e unë të humbin edhe ata të padukshëm.

Natën, të dy të mërguar,
më andej se Kanaan-Bukura More
në gjeografinë e humbjes
kemi kërkuar me telefon siguri.

Etërve u thamë
se jemi mirë

por nuk u tham si jemi ndryshuar tani!

Nga sytë e tu
pashë ankthin e mbërthyer
që kanë popujt që shfaqen në kohë të reja.
Përsëri, përpara syvet,
m'u ndodhëtin anijet e shekullit XV
anijet e Ndre Dorias
që nga Shqipëria lundronin drejt Italisë!
Ti, nuk ishte sipër atyre, të kërkova kot!
Ja, ende te ky udhëtim i vjetër,
brenda një stuhi magnetike popujsh!

TË KUQTË E ONUFRIT

Nga një vend i hershëm i botës vjen dhe ti
 po nga ai i të parëve të mi
 ata të XV shekull
 ata të tri galerave të Andrea Dorias
 (si në kohën e të ikurit-fshehtë Enea)
 e para me pëlhura e mëndafshe
 e dyta me bukë, verë e vaj
 e treta me burra e gra.
 Një vend ku do Kadareja se Akeronti të rridhte
 e shqiponjat bënin folet e tyre.
 Lindje e Perëndim
 dëshmitarë i ke në fytyrën tënde hëne
 prej katërqindi p.k.
 Anije të papritura
 e para me hashish e kalashnikov
 e dyta me rrufjanë e lavire
 e treta me fëmijë e të uritur korrabaça¹
 në të lashtën e munduar
 e sot, prej kapitalizmit të vonshëm
 të atij me *paillettes* e quiz
 të prunë natën në portet e Brindisit, të Otrantit ...
 e pas mbi makina të çara
 në arkeologjinë e nëntëshme e përdhunuese

plot mjerim verbues të Domicjanës.
Pa cohë, pa kezë, me kanune të tjera
fatthënës televizivë në mendje
njëj me polake, braziliane, zezake
për një karneval-valle të çuditshëm
modash e bojërash
më fton me theks ballkanik ...
e më fal trupin tënd, sahatin tënd
për një grusht dollarësh.
Hove ndjenjash
magma përfytyrimesh
të panjohura, metahistorike,
cikle epike
infektive të zemrës
mungesë dredhish, barababel, papeshueshmëri.
E vetmja është
një farë tragjike, motër shqiptare,
që mund të jap.
Në maj te hijesirat tona
do të lulëzojnë
ikonat e kuqe të Onufrit
e do të ndihet i lahutave vringëllimi
me litaret e fuqishëm
të detit Jon e të ëmbël.

¹fantazma

RED SHIF'T

Tokë e etërve të mi
më mësove Artin e Ikjes
ikje të syve matanë detit
dhe të rrënjëve nga rrethi i maleve

Tokë e të parëve të mi të arratisur
më mësove vlerën e Besës dhe të miteve
njëra spirancë e Shpirtit
të tjerat zgjedha të trupave

Pas shekujve u ndryshove
je vetëm Tokë pa bij
të gjithë të mërguar
tokë me etër pleq
etër jashtë Historisë jashtë Kohës

Ikje e Tokës, tani,
më djeg fytyrën
me zjarrin-ikona të Onufrit
nuk ka më Ferra nga të cilët të shpëtosh
Parajsën për të kapur.

RAPSODIA N° 28, USHTRIM STILI MËSUES J. DE RADA

Ish një trim mbatan deti
 me një pasiqyr ndë dorë
 muar e ngrëjti pasiqyrthin
 rrezat e diellit bënë t'përpikjn një kopile
 viri-viri bën sit e vajzës.
 Ndodhi jëma dritësores:
 - Trim, çë llambarise t'ime bil
 mos ng'e di xoje nani:
 Një kopil çë dritëson një vash e do mir e e do për nuse.
 - Taksi palen e u e marr.-
 Palen më i taksi jëma:
 - Bir i jap u s'ime bil
 për cilonë driten rreth e qiellit për brezë
 spingullat t'i vë ndë gji illin marr qiellsit
 diell menaties për kezë
 për cohë detin
 e llumbardha dhja si borë.-
 E me ndrekj e m'e pastroi
 prana trimit ja e dërgoi
 ja e dërgoi me një ani.
 Trim i vate e e muar për dorie
 e m'e kjelli ndë shpi e gjithsei bëne më xu.

E m' u vu e m' e porsinej:
- Shihem shpin e bukura ka treqind dritësore
ajiri i hapen e i mbyll si do ti, vashes, frin,
mbrëndë atje kumbis llumbardhat.
Ndër duar tënde u gjith i vë
mos u helmo e mos sharto'
e shi' të ruash ka shkrepin dielli.
Nga të shtun ti m' i tagjis
një për një e m' i potis
nga të diell m' i namro
po të mos biersh ndë një
se aq më biren sa të llipsen.
Vasha e gjegji me tërbim
nat e dit ngë zu pushim,
vej e vij dritësorasit.
Kur erdh e diella
e shkreta fshehur vërejti detin
vërejti detin e shartoj
pra zu fill t' i nëmroi
e më e mira i mangoi.
Ajo u vu më llastimisej:
Çë t' i thëm u zotit t' im
kur të vinj sondënith?
Erdh po mbrëmia e zoti sai
nëng u duk e nëng u mbiodh.
Vasha qajti e shartoi
as la ndë helm m' e pritur

era mos i prir shertimet.
Zogjët tagjisi e potisi
një për një të shtun mbrëma.
Mori e diella kur u di
malli po djepes e saj
zëmres bine e i nxuar një vaj
pra llumbardhat nëmroi
e pa se jatëra mangoi.
Java pas javie
gjithë fjeturuan e van
pas të zonjës e sai për mon.
Ajo nd'ato shpi të veta
ndëdh me helm e me mëri
prit për mon zotin e sai
dit pas dit atie u los
pala u bë një grumbull hi
e m'u shua si një qiri.

NËSE DALLËNDYSHET VIJOJNË TA NDËRTOJNË FOLENË

Anëtarët e Fisnikërisë
senatorë të mbarë viseve
më s' duan të nxjerrin ligje
presin mbërritjen e barbarëve

(pse të nxirrën ligje nëse barbarët vijnë?)

Ata i kanë ligjet e veta
të hekurta e të flakshme
ligje thundrash të xhipave të zinj
sipas zakoneve të dherave të largëta të tyre

(pra pse të nxirrën ligje nëse barbarët vijnë?)

Fisnikët me Kanunin e Dukagjinit
Besa, fiset, rrëfimet e Kreshnikëve
plisat mbi flokë të bardhë duan një kafe
po kafenetë janë të mbyllura

Poezitë puhi të lehta
helikopterët shurdhues
s'lejojnë të recitohen

ligji i barbarëve s'lexon poezi

Gazrat lotsjellës
 përlotojnë sytë e dallëndysheve
 kuadrigat e barbarëve shpërndajnë
 të ikurit, pre gjaku,
 rrugët e qytetit, të gjitha, janë të mbyllura

Pa ndalur vargu i fëmijëve,
 në rresht për dy, me nëna dhe gjyshër,
 klithin për kafetë e mbyllura
 ditëve do të ketë pranverë dhe akullore
 (ligji i tyre është tejet i rreptë ndaj fëmijëve)

Arsye do të ketë për çrregullim
 Senati mendon se famëziu Arkan
 do të zbatojë ligje të reja
 më 21 mars ditën e pranverës

(ligjin e shfuqizojnë të gjitha ditëlindjet)

Asnjë balonë e asnjë akullore
 helikopterët nga sheshi largojnë
 flutura, dallëndyshe, gra dhe pleq,
 fëmijë të ngatërruar me përralla të merzitshme
 (sheshet duhet vetëm të kalohen)

Vetëm ujë ... aspak raki
 Herodoti shkruan se
 ‚Barbarët vënë drejtpërdrejt në ujësjiellës
 fluor kundër kariesit e vaksinë kundër flamës‘.

Kapitan Arkani do ta ndalojë edhe pirjen e duhanit
 për shkak të tumorit në mushkëri
 që Beogradi ose OKB-ja paturpësisht
 do t’i fajsonin gazrat lotsjiellës

Ndërsa i presin barbarët
 senatorët janë në mejtime
 1) çka duhet të bënin sikur të mos bënin ligje?
 2) çka do të hanin fëmijët
 nëse s’do të hanin akulllore?
 3) dallëndyshet do të fluturonin symbyllur?

Duhet shpresuar se ndoshta barbarët s’mbërrijnë!
 ose të të shpresohet se
 a) fëmijës së Arkanit ia kënda akulloret;
 b) fëmijëve të drejtuesve të helikopterëve
 u pëlqejnë balonët dhe dallëndyshet;
 c) përrallat u rrinë në hatër fëmijëve
 të shoferëve të xhipave.

Do të ishte shpresa e fundit
 pikërisht e fundit

që kapedan Arkanit
dhe hordhive të barbarëve të tij
t'u pëlqejnë poezitë

Mjerisht burimet e lashta historike të Tuçidite
thonë se “artet, poezia, letërsia, filozofia për barbarët
janë shprehje e zhburnimit, e rrënimit dhe shenjë
e zakoneve të përmjerra”
E po që se historianët gabojnë?

Barbarët pastaj mbërrijnë në Drenicë para kohës
së paraparë për shkak të klesidrës së prishur

në orën 9.20 të armatosur me autoblanda
në orën 10.15 një helikopter i tyre fluturon mbi Prishtinë
në orën 10.18 radhët e grave, të fëmijëve,
të burrave parakalojnë në qendër
në orën 10.25 gjendja merr tatpjetën
në orën 10.30 ndërhyjnë barbarët me artileri të rëndë
në orën 10.38 i mbyllin rrugët që derdhen në qendër
në orën 10.40 hedhin pa mëshirë edhe gasin lotsjellës
në orën 10.55 manifestuesit u shpërndanë,
kuadrigat-xhipa shkallmuan masën e çarmatosur
në orën 11.10 protesta që mbyllur. Barbarët largohen.
Kronistët thonë se
së paku 100 të vdekur
me dhjetra të arrestuar e të rrahur
fluturat dhe dallëndyshet nuk ishin më në qiell

Senatorët, sipas burimeve historike,
duke ditur se barbarët do t'ishin kthyer
përsëri para kohës së paraparë
për nderim të barasnatës së pranverës
pa dyshim patën një ide

Mirëpo në arkive
s'ka gjurmë
Herodoto dhe Tuçidite
nuk flasin
një copëz e shpëtuar nga zjarri
rrëfen për çunakët
që shpëtuan atë botë
ndër ta dhe fëmijët e famëziut Arkan

Pas shumë shekujsh
dallëndyshet
vijojnë t'i bëjnë foletë në Prishtinë
domethënë se pranvera
s'qe shuar,
as mbytur
dhe ... poetët dinë
më shumë se historianët.

Trebisaçe, më 5 mars 1998
(Përktheu nga italishtja: Anton Nikë Berisha)

ME FYTYRË KTHYER KAH MEKA

Qindra të vrarë:

14 gra, 12 fëmijë, nga tre deri në dhjetë vjeç,
7 pleq mbi të shtatëdhjetat
dhe tre trupa të djegur në katundin e Prekazit.
Vllazëria Jashari mund të thuhet se u shua.

Ata kërkuan Ademin

nuk e gjetën ...

vranë Zarifen, Kushtrimin, Aliun, Faikun,
Beqirin, Sherifin, Hajzerin, Halitin
Halilin, Qazimin, Blerimin,
Bujarin, Abdullahun, Elhamen.

Pas sulmit të barbarëve

në katundet e Drenicës

të gjithë donin të iknin

kahdo qoftë dhe kudo qoftë

(në raste të tilla gjeografia është një luks).

Trupat e grave dhe të vashëzave

të bërë shoshë nga plumbat

trupa të thëngjilluar

në Skënderaj vënë në radhë.

Ishin nga Prekazi i Poshtëm,

nga Llausha e nga Dubova.

Këtyre trupave, mistere të përfimit,
pamje skulpturore të Mikelanxhelos,
era e vdekjes frynte
çarçafin që mblidhte një nënë
si një vel drejt panjohurin
një fëmijë i vluar me një setër
i nënshtrohej ligjeve të shpërbërjes së materies
simbol i shumësisë dhe lirimit.

Sido që të jetë,
i bartën me kamion
nga morgu i Prishtinës në Skënderaj
policia barbare
i varrosi në një varr të përbashkët
të martën në mbrëmje, në shpejtësi,
pa rrënë terri.

Pastaj në Livadhin e Pajitimit
të afërmit i zhvarrosin të gjithë
i hapin disa arkivole
mbi to ishin ngjitur disa fletëza
me emrin e të vdekurit
të fshirë nga shiu.

Gjëja që vërejtin fotografët
nga çerçafët e bardhë
ishte një grumbull mishi i paformë

në një arkivol me ngjyrë të kuqe
ishte një fletëz,
mbi të cilën shkruante “djegur”
brenda një fëmijë i shkrumuar
pa ditur se kush ishte.

Në fund i lëshuan përsëri në varr.
„Janë djemtë tanë, janë motrat tona,
jemi me ta në dhe e në qiell”.

Të gjithë me fytyrë drejtuar kah Meka,
si e kërkon tradita islamike
e përsëri burrat e disa gra
të pranishëm në përcjelljen mortore
largohen para së të bjerë terri.

(Përktheu nga italishtja, Anton N. Berisha)

DITA E BALLKANIT

Një kujtim kushtuar poetit Ali Podrimja

... Kur erdhi dita e Ballkanit
 Imzot i velur nga se u dha
 ujin, Dritën dhe sërish Dritën
 e pastaj Malet, Bukën dhe Verën
 dhe qumësht dallëndysheje
 s'qe ende i kënaqur
 u mendua mirë të endë një petk
 me një mijë ngjyra
 aty – këtu, sumbulla ari e argjendi.
 ... Po më të bukurat, më të shkëlqyerat
 i vuri në gjoksin e Prekazit
 ku jetojnë njerëzit që s'i frikohen vdekjes
 mbi bjeshkët e larta ku shqiponjat rrinë.
 ... Imzot
 ende s'qe i kënaqur me krijesën e tij!
 Deshi të lagte atë petk
 në muzikën e lahutës e të çiftelisë.
 Pastaj i lodhur nga ai mundim krijues
 vajti të pushojë pak.
 I Tmerrshmi përfitoi nga çasti
 shqeu në njëmijë copa atë veshje përrallore.

Ushtritë e engjujve fluturuan
t'i japin Perëndisë kumtin e zi!

*Madhëri, Madhëri
Vështro ...!*

Qajnë Kerubinët të helmuar.
Nga ai çast Hyjnia, në kohë të kohëve,
urdhëroi të qepin me tela gjemborë.
ata copa të shqyera
(janë kufijtë në gjeografi).
Edhe Ai vetë
nuk dinte ç' duhej bërë ende.
T'i stiste sërish po sikur ishin nga fillimi?
U dëgjuan një mijë të folme
një mijë tinguj dionisiakë ... lodrash, daullesh ...
e një mijë valle e njerëz që i luteshin Zotit
... lutje midis grumbujve të shtëpive të djegura
lopët që kullosnin
anës rrugëve me varreza
me kryqe të vdekurish.
Sytë e En Theos-it panë atë errësirë!
Vetëm në Prekaz
shkëlqente drita e atyre diamanteve
dhe në Rrotën e Kohës
jeta hidhte valle me Vdekjen.
Në honet e syve të kopileve

çdonjери ish i rrëmbyer.

Imzot

atëherë foli

me zë jehonash e pëshpëritje fladi.

Ç'u bë u bë

e Mira dhe e Liga rrinë bashkë.

Secila në Babiloninë dhe Kaosin

bënte vullnetin e vet.

Prizren, 20.8.2000

MOLAT NË QIELL

Dica njerëz më thanë që yjet
 janë drita të vogla të vendosura në qiell
 sa të na tregojnë rrugën gjatë natës
 kur ajo është më e zezë se dhimbja.
 Fëmijët e mi, nuk është kështu!
 Yjet janë vrima të bëra nga molat
 që hanë qiellin
 ditë pas dite
 dhe përtej natës
 përmes tyre shfaqet Pisa¹
 ku një zjarr pa hajvan
 djeg shpresat, trëndafilat
 të qeshurat, gjellat, fjalët,
 dashurimet, ëndrrat
 ... Dhe çfarë doni të tregoni
 për rrudhat në ballë?
 A janë shtigje piçkulaç² që Koha
 bën të ecim ngadalë?
 Jo! Harrojeni!
 Ato brazda janë rrugët e Pisës
 ku Vdekja vallëzon

¹ferri; ²i përdredhur

74

dhe ju para pasqyrës
i vëzhgoni çdo ditë
pa kuptuar asgjë

DIMRI I MËRGIMIT

Poeti vë çofa¹ të kuqe te dera e natës
 mbushin me puzëm² fjalësh
 vargjet e tij
 sa të rrinë shtuara në kohë.
 Po largësia është largësi
 një thikë e ehjur³ që shpon
 zëmrën e ëndërrave
 e e bën cikërrima⁴.
 Dimri i mërgimit
 bënë të thahet dega e trëndafilin
 dhe s'gjënden lule të tjera
 ndër trevat e trëmbësisë.
 Në lëmë kreshta pa grurë
 Zogjtë s'kanë që të bëjnë
 Fjutojnë të reksur⁵ mbi retë.

¹çuflla; ²niseshte; ³mprehur; ⁴copëza, grima; ⁵trembur

TRANCE

Mikut Osman Gashi

Fuqi e Dervisheve në trans!
Kanë mundësinë
të bëjnë të fluturojnë tanket
në një rozarozinë të Prizrenit!
Predhat në gjoksin e Kosovarëve
nuk bëjnë absolutisht huq
nëse Kosova e mban frymën.

Kosovë, 26.8.2000

PAQË NË BALLKAN

Edhe myezinët me zërin e vrazhdë
nga majat e minareve
thërrasin
- Mjaft, mjaft, mjaft! -
në të gjitha gjuhët e botës.
Paqe në Ballkan!
Urdhërojnë të përgatiten
tryezat e dasmës
me trëndafila, sparta¹, bakllava.
Dhe këta pleq
me mustakë të bardhë
e plisat në kokë
do të kërcëjnë bashkë me vashëzat
rreth Çmendurisë së kufijve të shteteve.

Prizren, 20. 8. 2000

¹gjineshtër

FUSHË KOSOVË

Grumbuj mbeturinash të djegura
 në Fushë Kosovë
 një radhë biblike kamionash
 të mbushur me specatë të verdhë
 makina, autobusë plot njerëz
 që kthehen në shtëpi
 Së largu mbi kodrën e ëmbël
 Dielli do të arrijë Hënën.
 Shpejt do të perëndojë Dielli
 nga ai Apokalips tymi, pluhuri,
 vapë e jashtëzakonshme.
 S'ka më fuqi të jetë i soditur!
 Nata
 do ta kapërcejë ditën!
 I kuqi i Onufri-t
 lyen sytë-ikona të Evës.

Fushë Kosovë, 26. 8. 2000

FYELLI DHE DASMA

Tue kujtuar mikun Robert Elsie

Jemi shumë pak në Prishtinë
me vegime të përbindshme
Dhe ndoshta mjaft të lehtë.
Në dasmën së Lindjes me Perëndimin
si thonë pleqtë
- S'bëhet dasma me një fyell! -
Lule të historisë të çelura
por me rrënjë pa tokë
(si deshën Hyjnitë)
dhe të erësuar me të ardhmen.
Sy, me ankthe,
midis minareve dhe ikonave
Sy me irida të violionistëve arixhinjë
(ata të Chagall-it)
Jemi pak në Prishtinë, vetëm sy e lule.

FËMIJËT E PEJËS

Fëmijët e Pejës
dalin nga të gjitha anët
nëpër rrugica me filigranë
këndeve të praruara
nëpër pazaret
prapa ëmbëlsirave
prapa specave të gjelbër dhe domateve
një shkrepëtimë ngjyrash!
Gjithçka
këtu është Ngjyrë!
Materia është Ngjyrë

Vërmicë, 20. 8. 2000

GJAKOVA

Kupola kishash
jo në qiell
as mes resh
as në dritën e Lindjes
po përdhe
rrethuar me tela gjemborë
të ruajtura si relikte
nateditë ditënatë
me pushkë në duar
nga larg dëgjohen myezinët
dhe zëri kryengritës i Rap-it
hapin
rrugën midis autobлиндave të KFOR-it

Gjakovë, 20. 8. 2000

SHADËRVAN

Mikut Rozafat Berki

Shadërvan
një rreth Lindjeje
një krua në mes
një xhami
një flamur i kuq
një rreth i mbytur në tingujt
cigare, shkrepse, muzika rap, myezinë
e pastaj
dritë
dritë verbuese
drejtpërdrejt
nga të gjithë Yjet e botës.

En Theos, Ishallah, Zoti Ynë, Perëndi, Madhni!

Prizren, 18.8. 2000

TRE TRËNDAFILA

Bleva tre trëndafila të kuq
 e i ngallosa brenda gotës së zakonshme.
 I pari trëndafil
 i është kushtuar myezinit
 të mjerë, që në agim na pëshpëriti në veshë
 nga maja e Gjithësisë
 lutje për shpirtrat tanë të qëlluar.
 Të dytin trëndafil
 e mbajta për sytë e mi të trishtuar
 dhe të etur për të kuqen-ikonë.
 Trëndafili i tretë
 ish(te) një uratë për ty(j)
 trup prej mjalti dhe papirusi
 trup i ngjeshur me brumë ishujsh
 kravela¹ me trajtë petali.

¹bukë shtëpie

SKOTISA¹ NATËN

Natën e bëra thela thela
 me topren² e përrallëvat
 gjaku i saj është dritë
 (si dinë edhe dallëndyshet!)
 po nani
 nani çë ngë kam më ku të fshihem
 ku do të prëhem?
 (Do të) doja
 të kumbisësha mbi një shtrat
 me nënkrija³ kashte e dy ëngjëj për anë
 me errësirën çë pikset si gjizë ...
 Po nani çë skotisa Natën
 s'është më e mundur!
 Shih ç'dëm bëra!
 Nxëra sytë⁴
 me duart e mia
 e qëndrova si burìu⁵!

¹therta; ²sëpatën; ³jastëk, nënkresë; ⁴u verbova; ⁵urithi

TË MBULÛARAT

Për së llargu duket
 se ata janë të huaj
 flasin me veten
 korrabaça¹ të zhveshur
 pa stolitë, e pa ngjyrat e tyre.
 Lëvizin
 sikundër t'ishën te një amfiteatër
 sy të pështjellë²
 në një dritë të vjetër.
 Venë tu(r)e gjetur
 thomse të *Mbuluarat*
ato, çilave, të gjégjeme,
ffâlen bështërme³ të pâr
gjëat pasënjën, jets pâr
zâle e pâr ambnî me mō'n. (Jeronim De Rada)

¹lugata; ²mështjellë; ³krijuese;

SIRISËNDI

Disa vetë
thonë se është
një kryqevote¹ qetësimi
ca të tjerë
një thirrje e shtypur²
përndryshe jehona e Bukurisë.
Dridhet praku
udhët puthëtin besë³
se atje do të lindet një gjitoni e re.
I huaji
siell pas në trastë copa shkretëtire
dhe një sirisënd⁴.

¹udhëkryq; ²mbytur; ³u betuan; ⁴ulli i vjetër prej fletave të ndritura

DRAGOI DHE KUÇEDRA

Orët e Liga
 natën venë tu(r)e gjetur djem
 sa t'i shitojnë me dhëmbët të ehjura¹
 misht të sirmë².
 Por nënat dhelpërisht
 ka mot e jetë në djep vënë një kopan
 dhe sapo dihet³
 me sy të zgardhulluar
 numërojnë gjithë ato vëra.
 Është e nevojshme të emërohet djali,
 thonë gratë,
 sepse '*exheli*' ende s'është t'e ruajë
 ashtu e emëruan *Plak*
 por është vetëm një emër i rremë
 për të gënjyer Orat e zeza.
 Natën e tretë
 vijnë Tretat e Natës
 për t'i caktuar fatin foshnjës.
 ... Ndë këto vende
 çdo gjë është e ngatërryer⁴
 të lindesh, të jetosh, të vdesësh,

¹mprehtë; ²i mëndafshhtë; ³gdhiet; ⁴e ndërlikuar

ende të përdoret emri ...

Megjithatë

pranë do të gjendet ngaherë

një Vitore ose një Dragua i armatosur me shigjeta

që lufton dhe fiton kundër Kuçedrës!

ÇAMBA¹ ËNGJËJVE

Erdhi Djalli
 shkarzyejti² ikonat
 me kopre dhensh
 kakërdhitë i shprishi
 ndër katër jirat³ e dheut.
 Më truall, te buhoi⁴,
 shihen çamba diç ç'lanë ëngjëjt.
 Do të presim verën
 të dimë më shumë nga një plakë
 ç'po ndërton kalive⁵ afër dejtit.

¹gjurma; ²ndoti; ³pikat, anët; ⁴pluhur; ⁵kasolle me kashtë

GJUHA RIZOMË¹

Gjuhët bëjnë shaka si dhia
 prandaj delarë dhe Akademi me ata dalin trush
 djersitën t'i mbyllin brenda oborrit të Fjalorëve
 Ndërsa unë dashuroj fjalët të arratisura të *dogançes*
 që kalojnë kufijtë si të fshehtat
 “*Camosu, o cimadh se ta thurën tortëzest!*”²
 Me ata unë ëndërroj simetri dhe va
 hone dhe përqaftime të fshehta midis popujve.
 Gjuhët ndër udhëkryqet e Historisë
 zëmërgjer ndërrojnë fjalë
 pa egërsi i ngallmojnë
 në gjeografinë e heshtjes së natës.
 Ndonjëherë bëjnë atentate në një guerilje
 që lëshon trupa e fjalë ndër lëmenjtë afër kufijve.
 Mekaq
 shfletojmë listën e kreditorëve të shqipes.
 Egjiptianët i dhanë *martrinë*³
 erdhën pas filozofët grekë me *pirivolin* e *trondofilan*
dafinën e *vasilikoin*
kallogjerin që i vuri *kurorë*⁴ nusës e dhëndërit
 si kanë zakonë bizantinët.
 Litinjtë menduan për kohën
 ashtu dhuruan ca emra muajve

me *gështenjën* dhe *bukën*.
 Më tutje, Turqit më se lufta dhe ikje
 me mirësi na zgjatën *manushaqen*
 nuses i dhanë *cohën* e *sënduqin*, *bilbilin* e *honin*.
 Arabët na dhanë *kanakën*, *tafanarin* e *tavutin*⁵
 Spanjollët, të nëmurit, na ndëjtin një *taçë*⁶
 për këpucë të çara
 Gjermanët fjalën *takarjel*⁷.
 Sllavët dhuruan *kyçin* e *prakun*
kapicën e *karkalecin* edhe *grushtin*, *kulaçin*
 me *kravelen*⁸.

Nga Azia e Vogël na lëshuan në dasmë
shegën, *rrushin* e *verën*
 Francezët na kanë prurë *nulë*⁹
 dhe një ëmbëlsirë: *sanxhurrë*¹⁰ me arra, sheqer
 e *stafidhe*¹¹.
 Gjuha Shqipe me zëmërgjerësi
 nga paja e saj më të mirat shpërndau
 Grekëve i dhuroi një *kaciq*¹², një *kopile*
vëllazërinë, *gjizën* e *lulen*
 Sllavëve i dha *katundin* e *vatrën*
 Turqëve(t), po jo vetëm atyre,
 Shqipja i zgjati *besën* e *ujkun*
 Italianëve(t) një vegël bujqësore: shatin si brir *cjapi*
 Por Shqipja hyri në borxh rëndësisht

me popullin Armen
 që i ka dhënë hua abetaren e vet
 dhe Shenjat e Rrethit të Kafshëve.
 Te kjo vjeshtë, më përket mua, poet,
 të heq nga trupi gjithë dherat
 e t'i dhuroj një vegim i zëjes¹³
 mbi të cilin Armenia të ecë si në një Tokë të Re
 plot me çadra endacake
 një mbretëri gurësh
 që thërrasin mbi malin Ararat, të kaltër
 trëndafila të fryrë me gjak venoz.

¹Koncepti i rizomës (Gilles Deleuze dhe Félix Guattari) përcakton një strukturë në evolucion të vazhdueshëm, në të gjitha drejtimet horizontale dhe pa nivele. Kjo strukturë është kundër hierarkisë piramidale. ²Fshehu, çun se të kapin xhandarët! ³Fjala *dëshmor* (*dëshmitar*) në arbërisht priret *martiri-u* që rrjedh nga fjala greke *martyr* e kjo nga gjuha egjiptiane *mtrw*. ⁴huazime greke: *kopsht*, *trëndofila*, *dafinë*, *borzilok*, *murg*, *marton* ⁵gushoren; prapanicën, arkivolin; ⁶dhuruan një gozhdë, pineskë. ⁷dru; ⁸çyrek; ⁹likëngë e majme; ¹⁰ëmbëlsire nga *sangier* (*sang* = gjak); ¹¹kokrra rrushi të thatë; ¹²kec; ¹³shembëlltyrë e shpirtit.

URAT

Kemi shkuar larg
pa arritur
atje ku gjella fsheh(in) jetën
Urat mbi agimet e Mesdhetit
janë të këputura
me kaq
unë ec pezull pranë dy ëngjëjve
mosbesues
që vërejën ¹ ture buzëqeshur
me gojë koralli.
Askush do të shijë udhët
që poetët përshkruajnë, kot.

¹shikojnë

GJEOLOGJA E BRENDSHME

Në gjelogjinë e brendshme
nuk shikoj më katundin tim
hithra u mbiu kudo
e ka përmbysur.
Fëmijëria
derdhet nga ëndërrat.
Të vdekurit
lot që piksen
bëhen det guri.

MOI I MAJIT

Sa i bukur ish moi i Majit!
Buronte nga honi i shpirtit të motit
zëri dhe muzika atë natë
poshtë maleve(t) me emëra arabë.
Gjergji
- fllad me pentagram diellor -
Pjetri
- jerm muzikor i stilizuar -
të dy Zotra të Dionizit
më sillnin dora-dora
ndër shkretëtirat e mallit
ku janë të rralla
trëndafilat pa të djegur.

LETHE

Pokëdhin¹ çë statuja
 me pak hare
 mat(in) agimin
 dy hëna e katër yj
 trim trihimisu²
 ec drejt jugut
 atje vajzat qindisi(j)n
 pëlhura me shega të kuqe
 e diellin si rrogjë³
 derdh(in) ujë argjëndi
 kush e pi harron udhën e shtëpisë
 i dalin përpara
 korraça e qiparisa⁴ të bardhë.
 Ec mbatan trim
 jugu është një tufë xigarelash⁵
 një kryqevotë zërash.

¹pastaj, prandaj; ²shkundu, ndezu; ³qyp; ⁴fantazma dhe selvi; ⁵fjongo me ngjyra, kordele.

UDHË

Pa fjalë
mbrëmja rrëzbis¹
jirat² e udhëve
hijet e shtëpive.
Muret
e mbyllur(a) me gëlqere
ruajnë shekujt
lojërat e vajzave(t)
arkitekturën, pleqtë.

¹fërkon, puth, nget; ²ijët, këndet

LIRIA NUK BLIHET NË TREG

Një mbrëmë vure këmbë në Prishtinë
 kalova nga Tirana me një autobus
 Thirra një taksi. - Zotëri, ku do që të të çoj? –
 Dhe unë, pa hezitim:
 -Të lutem, më çoni në rrugën e Lirisë -.
 Taksisti i shpejtë u kthye
 nëpër banka, ambasada, konsullata, pallate diplomatike,
 studio televizive... dhe në fund arriti nën një shtatore
 më e lartë se tre metra.
 Ishte një statujë bronzi.
 Këtu taksisti ngadalësoi dhe më tha:
 - Kuku Zot, ja, këtu fillon rruga e Lirisë. –
 ... Sigurisht, që ka pasur një keqkuptim.
 Ju e dini, unë flas arbërisht!
 Si mund të jetë kjo rruga drejt Lirisë?
 Unë prisja që ai të më çonte në mal, në baltë
 në dëborë, në një rrugë të vogël
 midis fushave të kullotura
 në kasolle të vjetra
 ndoshta përgjatë varrezave të harruara, pa emer, ...
 Tani jam i verbuar nga të gjitha këto drita, mah!
 A do të jetë faji i rakisë ose vegimeve ballkanike
 që të bartin në Hollywood?

Dua të jem i qartë, unë prisja
 që nga dera e njëj shtëpie të thjeshtë
 dikush të më priste me “bukë, kripë e zemër”
 si kanë zakon Malësorët
 me një shtrëngim duarsh me kallo.
 ... Por çfarë është Liria për burrat sot?
 Dhe si nuhasin trëndafilat?
 Aromën e bukës?
 Si e ruajnë qiellin dhe Gjithësinë?
 Më ndihmoni të kuptoj, zonja dhe zotërinj!
 Unë e di që këtu jetuan burra

që kanë humbur jetën për Lirinë
 pa kërkuar asgjë në këmbim.
 Popo!

A nuk është turp të kërkosha
 katër kilometra katrorë të tokës tuaj
 në këmbim të ndihmës për Lirinë?
 Fiks poetët nuk kuptojnë asgjë nga politika
 strategjite ushtarake, diplomatike, ekonomike,
 financiare, bankare dhe pastaj poetët përsërisin
 të njëjtat vjersha në mënyrë obsesive
 të panevojshme, si fëmijët.
 Në gjitoninë ku linda unë
 mamaja ime merrte hua brumin për të bërë bukë
 pa dhënë asgjë në këmbim por vetëm tjetër brumë.
 Nuk di asgjë nga marketingu, e rrëfej!
 Unë nuk jam strateg.
 Ju takon juve të menaxhoni Pushtetin.

Ju lutem mos e shisni ende tokën tuaj
në këmbim të lirisë.
Nuk dua të shoh më vdekje në malet e Prekazit
për të qenë më pas i lirë
të kafshoj *pop corn* dhe të pi *koka kola* në Prishtinë,
tek *Pedonalija*¹.
Pastërtinë e popullit kosovar
që merr frymë me dy mushkëri
dhe ka dy zemra në gjoks
asnjë bankë nuk ka kapital ta blejë.

¹kurs kryesor i dedikuar për shëtitjet në Prishtinë

THIRRJE I HEROIT KOMBËTAR SKËNDERBEG (DHE KALIT TË TIJ)

Ne që jemi Historia
ne që kemi luftuar kundër çdo pushtuesi
kemi udhëhequr Arbëreshët në Itali
sepse donim lirinë dhe bukurinë.
Ne që kemi urryer muzgërimin Turk
ne që kemi vdekur për asgjë
ju kerkojmë juve që jeni kronika e zezë
që prodhoni të papunë
dhe i keni përzënë nga Shqipëria
e i keni çuar në të gjithë botën.
Ju që keni pranuar përhapjen e xhamive
dhe financimet e Turqisë së Erdoganit
me fanatizmin e verbër të qeverisë Arabe.
Ju që keni lejuar zaptimin e territorit
me tëmpuj lluksozë,
të kotë me idhuj të rremë fetarë.
Ju njerëzit e kronikës televizive
të *talk-show* dhe të terrorizmit mediatik
që e keni droguar këtë popull të lashtë
me mite të reja dhe tregime

mbi modernizmin e koshereve të çimentos
të shëmtuara dhe të ndërtuara me budallallëk
që u keni dhënë çelsat e Tiranës
kapitalizmit financiar dhe bankave
që keni transformuar sallonin e sheshit e përreth
në një *Disneyland* të pakuptimtë.
Ne që jemi Historia ju THEMI
që nuk kemi luftuar për të pasur këtë Shqiperi
me piramida të reja
simbolike të superfuqisë së naftëtareve¹
dhe bankierëve.

KËRKOJMË

që të na zhvendosni nga ky shesh
sepse duam të qëndrojmë në zemrën e këtij populli
e jo të burgosur mes grataçelave “Hotel”.

¹tregtarëve të naftës

BALLKAN I ËMBËL DHE I ZEMËRUAR

Këtu sollën të gjithë bronzin e Tokës
 për t'u dhënë trup shtatoreve
 (nuk ka rëndësi më këmbë ose mbi kalë).
 Çdo shtatore vlen njëqind luftëra dhe pak paqe.
 Ndërsa në Hapësirën/Kohë në Shkup
 heronjtë Filipi (i Ati) dhe
 Leka i Madh (i biri) me shokë
 më shikojnë duke rrudhur hundët
 Muzat bisedojnë me ftohtësi aristokratike
 në të dyja anët e urave
 nënat të ulura në rreth
 në skajet e burimeve ushqejnë me gji
 dhe djersijnë bakër.
 Vetëm udhëheqësi Skanderbeku *i pa fan*
 rri i gozhduar si rojë përpara një bankë gjermane
 (kërkon bashkëpunim dhe solidaritet
 kundër revizionizmit të historisë bashkëkohore)
 Leka i kërkoi Lisipit¹ të gdhendte statuja
 për të zbukuruar qytetin e muzave
 (më vonë u zhduk nga pushtuesit romakë në 146 p. K.)
 sot një lloj donin të bënin Qeveritarët e rinj!
 Unë vëzhgoj nga këtu Ballkanin tim
 i ëmbël dhe i zemëruar
 me një vështrim filmik

shikoj kufijtë, doganat, telat me gjemba,
 afresket e Shën Mrive dhe shenjtorëve
 të rrahur me dhëmbëza ndryshimin i gjuhëve,
 kambanoreve dhe minareve,
 malet dhe fshatrat,
 urat mbi Lumbardhin në Prizrenciganët të bjerrë
 në shtrembërimet e klarinetës në notat të *Tumankuqes*
 katundat me dy emra (ose vetëm me një dhe tjetrin të fshirë)
 dhe më pas pazarin ... zëri metalik i muezenit,
 kromatizmi magnetik i ikonave të kuqe të Onufrit
 qofte me kripe roze Himalaje
 specat të verdhë nga Peja, ...
 Në këtë esplanadë koreografike me shtatore e shatërvanë
 u vu në skenë përfaqësimi i historisë dhe konflikteve
 me restorantin “Anija e çmendurisë”
 që hodhi spirancën përgjatë lumit Vardar
 në pritje të përhershme si ambulanca e Historisë.
 Skenari është me shkronja cirilike
 kurrë në paqe, kurrë i mundur nga harresa.
 Ulur në Çarshinë e Vjetër, dmth në Стара чаршија,
 në shoqërinë e Lekes dhe Nënës Tereza Bojaxhiu
 nduk vegime e gjerb çaj mali
 duke lëvizur përpara një trileç
 ekuilibër i ëmbël dhe magjik
 midis njohurive të popujve.

¹*Lysippus* ishte një nga skulptorët më të mëdhenj grekë të shekullit të IV p. K., i preferuari i Aleksandrit të Madh. Nga 1500 statuja që Lisipi do të kishte bërë, asnjë origjinale nuk ka mbijetuar. Sipas Plinit, Lisipi gjithmonë thoshte se ai i përfaqësonte njerëzit jo ashtu siç janë, por ashtu siç duken, me probleme, shpresa, gëzime dhe hidhërimi, duke hequr dorë nga përpjekja për të përfaqësuar absoluten dhe idealen.

SY IKONASH

Edhe një herë
Yjtë po kumbisen
mbi shtret(r)a ëndërrash
Zërat e engjëjve(t)
pa tone të veçanta
thërrasi(j)n
Ikonat më vërejnë
me sy mjegulle.

NATA E DIELLI

Nata rrozbisi¹ sisët e diellit
 mbi ujin e dejtit
 pëllumbat e bardha në fluturim
 pa turpë vanë e u mbodhis(t)in²
 brënda manushaqavet të dushqëvet
 ... kështu zuri Jeta.
 Pastaj erdhi pranvera
 e ndëndur
 me erën mishit të një(j) djali
 djepin i ylëzvet
 zërin dhe ngjyrat
 qeramidhat³ e gjitonisë, e më e më ...
 sa zëmra t'e ka ënda.

¹fërkon, fshien; ²futen, fshehën; ³tjegullat

KRAHË VOREJE

Djali qan
 e qurrat i venë si llavinë¹
 e jëma
 rënkon me zemrën të maxafjartur²
 pjaka
 fjet fjet³ e rrëf(i)en përralla
 pa krye e pa këmbë
 gjithësia
 me krahë voreje
 rri pa folur
 edhe u' që (do të) doja të fijosja
 s'kam më fjalë
 i shkreti Aus⁴
 m'i nduki⁵ si vezë pëllumbi.

¹rrëshqasin, venë; ²në grimca; ³plaka flet; ⁴humnerë po edhe fuqi
 magnetike e padukshme; ⁵thithi

LËNG KORRANXEZI¹

I bëri tryesë(n) e jëma nuses
 e shtroi, si duhej,
 me mësalën e bardhë
 atë e qëndisur me zogj e kokanara² rrushi
 grepat, lugët, qelqet³, verën e kuqe si gjak kaciqi⁴.
 Në vatër
 vurën një kucër të madhe e zjarrin dhezën.
 Nga njeri flet për nusen
 ndonjëjtjetër
 po shikon dhëndrin.
 Jashtë mjegulla
 fjet me Krishtin⁵ mbi ata rehje.
 Ne brënda ...
 u rripuçquam⁶ si te një krokë⁷ veze!
 Nga njeri rrëfienë⁸ (çdo)gjë
 Pasqyra shikon e qesh
 me buzën këtu e këtje e lyer
 me lëng korrnanxezi.

¹lëngu i manit të kuq; ²bistak rrush, kalavesh; ³gotat; ⁴keci; ⁵shprehje popullore, mjegullë shumë e trashë; ⁶mbloodhëm; ⁷lëvozhgë; ⁸ka për të rrëfyer.

PASQYRA TË SËNDIRTURA

Si e shkoj motin?
 Qeveris sytë, këmbët,
 shëroj ethet e buzës ç'më zënë
 kur trutë djegin ëndrra e kashtë
 potis(inj) dherat me shegë
 çë rriten kur qesh(inj)
 pra prirem në shpi
 sa të sëndirinj¹ pasqyra.
 Fjala ç'i thom Zotit
 rrozbis(in) fuckat² ngjyrash
 çë plas(inj) kur djalli zë vallen
 me kroje argjëndi për krahë.

¹të dëmtoi; ²fërkon fluskat

DRUDHËZAT DHE NATA

Një ditë më tha mëma:

“Ti bir, mos e shkund mësallën në ballkon
kur është natë!

Drudhëzat bëjnë të mblidhen Orët e Liga
e shpia s’vete përpara”.

U(në) e përqesha e ajo me zë të ulët u përgjegjë:

“*Bir! Mos t’it shkelë kurrë Kau i Zi!*”

“O mëmë, ç’thua?

Si mund (të) jetë se për dy drudhëza
shtëpinë e merr një manastrofë¹

e a siell në Pisë²?”

Si s’fola më

(me krenarinë e atyre që nuk dinë faregjë)

Argalia u vu të endte një pëlhurë të zezë
e sënduku u mbjua³ me një palë⁴ helmi.

Mënija, mënija⁵!

Her’e herë e sheh ç’të bëjnë dy drudhëza?

Po nani kuj mund t’ia rrëfienjë⁶?

Mëma vdiq e po rritet

te praku i shtëpis kristla⁷.

¹stuhi; ²ferr; ³mbush; ⁴në pajë; ⁵djall të vejë; ⁶rrëfyej; ⁷krisja.

MBIJDHU MË SHPI¹

A nxuar sallaxhin¹ Gjitionia, hapi derën e Motit
 somenatë ndihet skanxirre², si thomi ne “i ha bytha”
 por atyre pak njerëzve ç’atje qëndruan
 s’i shkon fare për krye³ se është vetëm një ëndërr.
 Gjitionia me ballin ç’i djeg me ethesi zjarr, s’ka më
 gjë për të bërë
 ashtu po bredh me dritën, masariar(in)⁴ vitet që shkuan
 cinxulljas(in)⁵ i shtrydh(in), i zdirrnar(in)⁶
 i kullon gjer sa shfaqen
 kuçurubëlit⁷ gjithë të dërsi(j)tur (t’i vrafshin!)
 që rrinin njëherë tek ajo udhë.
 Gjitionia i thërret një për një
 e zë e po shtie guizma⁸:
 “Ti, bir dose, hap sytë me atë rreth
 mos bëj të kërcëjë mbi atë nxilikatë⁹.
 S’e di se është e fjë ndrikulla Ngjisk, e a zgjon?”
 Vajzat rrinë te një jirë¹⁰
 ‘çu çu çu’ pa bërë dëm, fjasin me nusëzat¹¹
 i veshin i zhveshin një qind herë.
 U’ pata të shkoja
 te ana e tyre e m’u tiks gjaku kur i pashë ...
 “Pa, shi’ ç’bën malli?”
 Le të shpëtoj!

Kur korrobaça¹² e të vdekur
 venë ture gjetur erë trëndafilash mbi ballkonet
 manushaqe ndër kuturunet¹³
 ke të vësh hundët në trastët e të shpëtosh.
 Ajo është hera e tyre. Mbijdhu më shpi!
 Patjetër, .. po kush e di cila është shpia ime, nani?
 E pra s'di më
 në do të qëndroj(e) më me ato kuçuruba¹⁴!

¹mblihu në shtëpi; e nxori shulin; ²me nerv; ³në kokë; ⁴vë në rrëmujë,
 masariar; ⁵rraskapit; ⁶shkallmon; ⁷foshnjët; ⁸thirrma; ⁹kalldrëm;
¹⁰kënd; ¹¹kukullat; ¹²hijet; ¹³enë; ¹⁴fëmijë

BUKURIA E VAJZAVE

Hijet e mbrëmjes
 shtrohen xarra xarra¹
 mbi qeramidhet e shtëpive(t)
 dita lë këmishën e gjarpërit të fjalëve(t)
 Nani gjithë bota është qetësi.
 Pleqtë çëli(j)n zjarrin
 zogjtë e dushkut po kumbisen.
 Pasqyrat
 vëlojnë bukurinë e vajzave(t)
 me një pëlëhure të bardhë.
 Kështu çdo mbrëma.
 Nga njeri njeh këtë visëndir²
 katamiqoset³ çdogjë te vendi i saj.
 Edhe helmi.

¹dal'e dalë; ²litani; ³zë vend

VALLJA NË SHKURT

Sonte

zëmë virrënezin¹ në tryesë
 si të dejmë² thërresim pa turpë
 për gjitoninë e njerëzit që ikë(ti)n
 për miqtë që vdiqë(ti)n
 për udhët me buhua³
 për kuturunet⁴ pa lule
 për djepat e zbrazëta
 edhe për dallëndyshet, që të nëmurat,
 nuk bëjnë më folenë.
 Çë kur gjitonia llaftaris(in)⁵
 që kur korrobaçat⁶ zu(rë)n vallen në shkurt
 na erdhi nxea e gjitonisë⁷.
 Mosnjeri kujton
 se Moti përmyt përrallat
 dhe ferrat me hithrën
 vuan gusht kush mbulon më shumë udhë.

¹rënkimet; ²si të dehur; ³pluhur; ⁴enët; ⁵dergjet; ⁶fantazmat; ⁷na erdhi nostalgjia, dëshira e gjitonisë

SHPIA ËSHTË VATRA

Mund thomi se ndër katundet tanë shpia është vatra.
Pleqtë si Priftërinj, nga mbrëma djegin(jn) kucëra e
degë lisi

sparta¹, gubonja² ulliri,

shkoza, lëmishte, çdo dru të thatë i sjellin.

Vatrës sikur të ishte një bijë i jepi(j)n të hajë

e mëko(j)n me bukë në grykë!

Pa thonë, kamnoi³ e di si ia bënë muret e shtëpisë?

Si llinijel⁴ dhe astërku⁵ i ngjallaparet⁶ me hi e kamne.

Po s'kan ku të venë të nëmurit pleq!

Mëmat e Vatrës

të gozhduara atje prej Moti

i thanë: “ Po mbani dhezur zjarrin për sa të rroni

e në kamastër varëni përrallëzat, yjet, rrethin e diellit.

Në qoftë se shuhet shuheni edhe ju!”

Pleqët flasi(j)n me zjarrin

një ditë mallkonin e do të vdesin(jn)

një tjetër vënë nëmë se s'kanë më fuqi.

Po kur kanë areks

bredhin me cimbthin e bënin shkëndija.

Toshku toshku⁷

thonë se kur është Nata e tyre ato shkëndija bëhen

dhen, grurë, miell, kaciqe, lopë, pula, ...

thonë se shtëpia mbushet me ç' do të dëshirosh!
 U' s' e di kush i nxori këto parastoqe⁸.
 Le të jetë si të duash!
 Dica thonë vetëmia, dica Ato të Mirat,
 ndonjë tjetër... fuqitë e Dushkut, mund jetë edhe Besa.
 Thonie si ta doni po të mos ishin ata Pleq
 në mjegullën e kamnoit ta mëkonin e ta nxitin zjarrin
 shpia do të mbetej esëll e Qielli pa yje.

¹gjineshtër; ²gungaçe; ³tymi; ⁴ngjyrë e zezë e nxjerr nga bima;
⁵dysheme; ⁶ndyhet; ⁷serioz, ndoshta *toshku* rrjedh nga karakteri i
 toskëve; ⁸gënjeshtra, gjepura kalamajsh

NGUSHTI

Vura një ngusht¹ me Poezinë
 do të përpiqem me Zonjën Marrëzi
 një mbrëma dimri.
 U' do t'i dal me një hjerapan² i lyer në krye
 një kopan³ druri te dora e djathtë
 si mbreti i katundeve(t) me gjitoni pa njerëz.
 Jam te ky i shkretë zall dejti, Sybar,
 kjo është Nata e taksur.
 Atje më pret një monotrofë⁴
 guizma⁵ (su)valash të parrëfyeshme
 sjellin s'di nga ku
 një cohë nuseje e shqyer
 një tufë lulesh nerënxe të kalbëta
 e çika staçëza⁶ guri
 të shkulura nga mozaiku i perëndive(t) trup-kafshë.
 Mund jetë edhe se këta janë drudhëza
 çë qëndruan pas dasmës së Hyjnive(t).
 Rri mbi ujët e errët kufoma e Rruzullimit
 Nata dhe e bija Eris shqyejnë ikona
 dhe po u shtien baltë simetrive(t).
 Omer ku është Agimi
 me ata gishta ngjyrë trëndafili?

Ti bir, prit! Duhet të pikset dita!
Qëndro këtu!
Ku do të vesh?

¹basti; ²leckë; ³shkrifëse; ⁴stuhi; ⁵llokoçitje; ⁶rrasa

LUMË QUMËSHTI

Kur unë eci
nëpër rrugën e fëmijërisë sime
përposh nxilikatës ¹ prej guri
ndiej se rreh
një dell me ëndrra
një lumë qumështi
kurse Nata mbi rehjet
çel zjarre me kashtë.
Atëherë
vishen me stoli të shkëlqyera
dhomat e Parajsës.

¹kalldrëm

RRËNJË E HONE

Nga kronje
 ç'kanë rrënjë në honet
 rrjedh një ujë me lule sparte e gjishtlash¹
 lumë i bjerr në ngjyrat e shegës.
 Ujë pilikaç², ujë i thellë
 çë qetëson zogjtë në pranverë
 dhe ç'bën t'i qaset nusja dhëndrit
 u' edhe sot po e kërkoj.
 E dal trush³
 hollë hollë pyes ëngjëjt
 sa të zbulojnë algjebrat lirizmi
 çë pështjellin brënda huallit të botës
 në etjen e diellit.
 Ti je harresa
 çë ngë kallëzon faregjë
 je kujtimi i Motit.

¹dorëzonje; ²i zhveshur; ³çmendem, humb arsye

RE MBI ARAT

Vete tue ecur mbi udhë hiu'
të rrethuara
me trëndafila gjëmbe-hekuri
atje rrëmbehen
leshi (i) shaban(ra)vet pa delarë
buzë të varfëra dhe retë mbi arat.

Kallinjtë shkoqen
si muret e gjitonisë.

¹prej hiri

SHTRATI

Shtrati im është katundi.
 Ku flë unë
 ka një plasë të madhe si përrua¹.
 Natën
 atje po shkojnë
 rënkimet e (të) pleqëve(t)
 dridhma fëmijësh
 kamnoi² i drizave dhe të konopicave³
 pursëlluara prej bujkut në kallamën⁴.
 Në lëmë
 Moti hedh ditët
 e puka⁵ po më zbardh lesht⁶.

¹arbrisht: luginë; ²tymi; ³andrave; ⁴kllamishtet; ⁵byku; ⁶flokët

KASHTA E KUMTRIT

Me këthistrën¹ sonte
 po gërvish qiellin
 buhoin e errësirës
 dhe e shtie poshtë
 në buxin'jetin²
 të ëndrrave të Gjithësisë.
 Ec(inj) te Kashta e Kumtrit
 bashkë me dy ëngjëj të shporrur
 edhe gojë hapët.
 Çfarë rrugë të jashtëzakonshme udhëtoj!
 Sihjehet³
 moti të ndahet trish!
 Mendoni
 se trëndafil(a) trihëmiset⁴
 vetëm me ahjtën⁵ e një(j) shamaku⁶.

¹rashinën, kasistrën; ²kazanit; ³neveritet, sikur të hidhem; ⁴shkundet;
⁵frymën; ⁶qurraveci

MOTI QËNDIS

Një vohë¹ e fshehtë lëshon dritarja
 korrilat fluturojnë mbatanë detit
 spartat dhe trëndafilat
 i pëshpëritin ndogjë te veshi
 Dielli
 ka dera e qiellit i nxier shapkën
 në shesh vajzat bredhin me rrethin
 kopilet ëndërrojnë
 kronje me ujë argjëndi
 Vetëm qetësimi
 derdh(in) gjak mbi xamaqet²
 dhe Zanat në mbrëmje
 kërkojnë dyer me çofa³.
 Moti qëndis(in)
 kallinj e plisa me fije merimagash
 i Huaji
 këndon me kungullin⁴
 fjalë të zgurdulluara⁵
 të (n)xëna nga Hyjni të veta.
 Po kush m'u ul te praku e syve(t)⁶
 të shikojë të gjitha këto?

¹grahmë; ²zambakët; ³shirita; ⁴shprehje popullore: dikur, në katundet tanë, gjatë natës një grup njerëzish të armatosur, me fytyrë të maskuar, rreth lagjes, denoncoi fakte dhe njerëz, duke përdorur një lloj kunguj të zgjatur, i zbrazur, si megafon; ⁵nëmë, fjalë të pabesueshme; ⁶luleja, pragu.

NË PRAK

Kush dolli në prak?
Dolli vajza e rrethuar
me nënd hënëza të zbehta.
Për martëri lisat e zinj të dushkut¹
atë natë me manastrofë².
Zëmra iu drodh
në të ftohtët e borës.

¹pyllit; ²shtrëngatë

PILIKACRA¹

Katundi i ngridhur²
me qetësimin
në natë të dashuruarit
u bën shtratin në shesh.
E ëmbël dhe e sëmurë
rrjedh fryma drejt yjeve.
Jirat³ e vjetra e murëve(t) (prej) guri të gjitonive(t)
bëjnë martërin⁴ bashkë me dushkun
të gjitha pilikaçës⁵
i mbështjell vetëm ari i ikonave.

¹të zveshura; ²mbrujtur; ³këndet; ⁴dëshmi; ⁵lakuriqe

BUKA ËSHTË DJERSË

E emëronin bukë
 e në thelb ish djersë
 ashtu shpia plotë bij
 vetem vatër me hi të ftohtë.
 Qielli i nxivartur¹ me (su)valë
 drite e dallëndyshe
 mbjatu² në natë
 jo pas një shekull
 u mbush me korrabaça³ e lakuriqe.
 Nani
 përmes dyerve të zgardallisura⁴
 shoh djepa të zbrazëta
 televizore pa zë
 ferra gjer mbi qeramidhat⁵
 të vdekur e të sëmurë.
 Nëse kështu vete Jeta
 pragu i ditës
 u bëftë kryqevotë⁶ dhe vohë kraveleje ⁷ furri!
 U' pres.

¹derdhës; ²menjëherë; ³lugata; ⁴hapëta; ⁵në çati; ⁶udhëkryqi; ⁷aromë
 prej bukë furri.

DIONIZI

Ahjimazë¹ katundit në ditën e përshtatshme
kur bujku pati nge
ropi një dhi
e me lëkurën
bëri rrëshiqin e karramunxavet².
Holloi një copë dru me thikën
e bëri fishkaruallin³
vërat⁴ i shpoi me flakët e Pisës⁵
dyer çë sjellin drejt tragjedisë.
Parkalesi⁶ tue parë
malet, arat, një spikë⁷ dejtj.
Bluajtj e ngjeshi
Parajsën me përrallat e fëmijërisë
ëndrrat e fatin.
Pranë mori frymë
e papritur mburoi një muzikë
mbase prej dhisë a prej shpirtit.
Ullinjte e dhafnat të gëzuar
u skazartën⁸ nga trolli
dhe luajtën valle
me këmbëzën⁹.
Për atë pajë të ndryshme

qeshte Dionizi
nën hijen e lisit
në një vapë çë startaroste¹⁰ edhe cinxërrat.

¹nën, poshtë; ²gajdeve; ³fyellin; ⁴vrinat ; ⁵skëterrës; ⁶lut; ⁷cep, kind;
⁸shkulën; ⁹një hap i veçantë i vallëzimit për të cilin flitet në tragjedinë
Bakanti; ¹⁰vrit.

FJALË TË HUAJA

Një kalli gruri i madh si një lis
digjet në natë.

Mendimi dhe zëri pilikaç¹
dashurohen në ishullin e dritës.

Një ditë

do të pjellin një fjalë të vetme, të fshehtë.

A ju duket pak?

Do të jetë një turpëri e madhe
dikush do të shtrojë një rit
një tjetër një therje.

Poeti *i dehur t'ikëmjie*²,

thot De Rada

në kushall³ çdo herë

ka një grusht asisoj fjalësh

por për njerëzit

janë vetëm fjalë të huaja.

¹lakuriq ; ²i dehur për ikje; ³xhep

NË SHESH

Në shesh
 u mblodhën gjithë hijet e lisave
 u grumbulluan guizmat¹ e shtypura
 hiri i zjarreve(t)
 sqepi me yje këndimi i cinxërrave(t)
 vëllezërit dhe motrat
 ëngjëj zjarri, ëngjëj të mallkuar.
 Pastaj katundi
 i foli edhe gurëvet:
 - Kalluan² kezën argjëndi
 cohën e hënës
 fytyrat e njerëzvet!
 Kush i mori le të ua thotë dallëndyshavet
 syvet të të dashurvet
 ashtu dyerve të mbyllura me sallaxh³.
 Vetëm atëherë udhët
 zgjidhëtin⁴ nëngjat e kryqavotëvet⁵
 patën turp e brënda sënduqit
 gjetën kezën dhe cohën.
 Po ato fytyra burrash
 kush i mori
 i fshehu prapa rahjit⁶
 në netët e errëta pa Kashtën e Kumtrit

¹thirrat; ²vodhën; ³shul; ⁴zgjodhën; ⁵nyjat e udhëkryqeve; ⁶rrëpirë

GJUHË ZGANXIRRE

Sot e nxora jashtë këtë gjuhë zganxirre!¹
 Le të shkojë pa kapistër, thashë, si mushk e egër,
 të nisni shqelba, të rrëzohet ndapër karrara²
 me ferra e murriza, gramina e përrenjë.
 Lë të hipetë në rehjet me potkonj ari.
 Murga, gjuha imë e vjetër, gjuhë me arna!
 Të kishin ulur mënjanë si murgazezë³
 te një vatër e ngrirë pa urë e zjarr
 vluar brënda një sënduk
 me cinxulla të ngrëna nga kapica
 e tumtura të shqerra⁴...
 e ti rrije e ruaje e butë e butë!
 Të nxora e të ndejta më diell në perivol
 të marrësh ajër, frymë,
 ti gjuhë pa gjak, pa shkoka të kuqe.
 Ishe e startarostë⁵
 mbi një tryesë akulli te një Laborator
 me jatronj ⁶ rrotulla edhe një Prift:
 “Bëj kollë, të thoshnin!! Bëj gromësira.
 Bija e tatës, thuaj *zho-zhu-llë*,... *zhgël-ba-zë*!
 Uhhh s’është fare mirë, ti je sëmur... ke llupjelin?”
 Ty fëmijë e egër përveç si të shkoi ethja
 u vure të bëje shurrë pa turpë

mallkove me fjalë të zgurdhulluar
 e xathur brodhe me nusëza.
 Një ditë
 të stolis(t)ën me xigarele e të veshë(të)n
 një cohë llambadhör⁸
 të zunë pickandora⁹ e ti ece te udha e madhe
 në vallet e Pashkëvet.
 Gjuhë pafanë
 me tij shumë kanë bërë tregti, e u begatën.
 Të morën për një dosë, të hëngëtin¹⁰ e të pin!
 Të sollën këtu e këtje
 sa të të ndërzejnë¹¹ edhe jashtë Shtetit.
 Po ti je e pastër si brumi
 çë mburon prej magjsë e shtripon
 vëhe piçkulaçë¹²
 je karvele shpie.
 Ku do vete shtie rrënjë te dheu
 në zemrat, te malli,
 në erën e fjalëvet,
 në luftën kundër harresës.
 Ti shuan etjen, krua me ujë ëndrrash,
 potis kopshtet e truvet
 vë ngushta me mendimin
 kush bën kocëkatrumbulla¹³ më të llavura¹⁴.
 Zëri me bukuri këndon me tij
 po ti gjuhë ngatërrohe
 kur për veshi e me shqelba te bytha

të qellën në skollë
 sa të të vënë zigoin¹⁵ mbi xerk, si një çofez¹⁶.
 Ty ka pesë shekuj
 çë e bënë frëng e s'i vajte fare:
 një shekull t'a rru barku
 një tjetër t'a rru kurrizi!
 Ashtu nani drej drej
 të dërguan në Universitet!
 Ti linde jashtë, ndër malet,
 në mest argom'vat, me dhentë,
 kur piksej qumshti
 dhe frynte voreja, në mërgim.
 Ti mbath kepuçë të trasha me taça¹⁷
 ecën ndër balta në dimër
 po me cariha¹⁸ lëkure i qase djepavet
 e lehtë si dallëndyshe.

Zotrote, Gjuhë Kocë-gajdhur¹⁹,
 i jep mësimë atyre murgjve ç'kanë skollë!
 I mjeri Jeronim De Rada të skallionte²⁰
 të njihte llapirdhaqet²¹ e tua.
 "Xa, më the, mirr te trasta këto fjalë,
 shi' se gjen edhe dica shegë"
 e a zbrinjarte²² ashtu si erdhe
 u ngallose në kriqavotet e gjitonivet pa njerëz.
 Këtu si Ora zezë
 dica pëshpëritën se vdiqe ... po është e rreme

ti fshihe e tund(in) flamurin e kuq
 më bën sythin nga një jirë.
 Ec me shëndet,
 gjuha ime e hollë, gjuhë zganxirre.

¹e paepur; ²nëpër shtigje; ³e shkretë; ⁴me lecka të brejtur dhe rrjeta si çarçafë për të mbledhur ullinj të në tokë; ⁵e dërrmuar; ⁶mjekët; ⁷kancer; ⁸petk i indur me ar për veshjet e gravet; ⁹i ngritur për krahu e këmbë; ¹⁰hëngrën; ¹¹bashkim seksual midis kafshëve; ¹²i përdredhur; ¹³kollotumbë; ¹⁴si të çmendura; ¹⁵zgjedhë; ¹⁶fjongo; ¹⁷gozhda (për çizme a këpucë të trasha) të shkurta e me kokën të gjerë; ¹⁸sandale prej lëkurë, caruqe; ¹⁹kokëgomar; ²⁰hulumtonte; ²¹gjëra pa mend, budallallëk; ²²ika shpejt dhe fshehur.

KRISTLA NË PRAG

Atje ku ish gjitonia
nani puthen Hijet
me buzët e kuqe
të lyera me lëng korranxezi¹.
Ëndrrat pilikaçe
flenë
(m)brenda shpi(ve)
me kristëlen² në prag
dhe qelqet e dritareve(t) të sëndirtur.

¹mana të kuqe; ²gramë, farë e keqe, krisje

HIJA E LISIT

Lis e humba hijen
 edhe ti shpi
 nani je e huaj në gjítoninë tënde
 zëri u nda nga fjala
 zëmra nga dashuria.
 I egër një helm
 me këpucë të trasha
 troket dyer(ve) të stisura me gëlqere
 tue pyetur për Jurendinën dhe për t'jëmën.
 Më vonë
 me një kalë të zi strushëlaret ndë dushkut!¹
 Mën'ja, mën'ja!²
 ky qetësim bore
 është më i rënd se shkëmbi
 më i thellë se honi³.
 S'i kam fare besë
 trëndafilít as ëngjëjvet
 se mund hapin dritare në agim.
 Jemi të vetëm
 yj çë gramisen në llakë⁴.

¹ikën shpejt në pyll; ²qyqe, oh Zoti i madh; ³humnerë; ⁴luginë

ME URTH¹ E PA GRURË

Çfarë donte?

S'gjen lule në këto shtëpi

sepse s'ka më njerëz!

Sheh të shprishura mbi truall

vetëm livere² të shq(y)err

kufa me urth e pa grurë

ndihet një erë e rreshkët

ndër dhomat të mbyllur.

Hyjnë dica të dejmë

brënda shtëpive të zbrazëta, pilikaçë,

me një qind pasyqira

që i sihjehen dritës

të mbështjella me tumtura³ të lyera me vaj

shtretëra pa zbringa⁴

ku nata pa ëndërra gramiset.

Dita s'do më të pikset

pse nuk dëgjon petkonjtë e pelës

mbi nxilikatin⁵ e gjjtonisë.

Katundi im

i rrethuar nga qetësimi

të lut pëshpërit fjalët e moçme

të shkurtura si jeta e të thella si errësira.

¹egjër; ²të veshura me cule; ³pëlthura pilkuraqe; ⁴susta metalike e krevatit; ⁵kalldrëmin

ZËRI NË GJUHËN SHQIPE

Zë i lart, i ulët, i dobët, i qartë, i hollë, i trashë,
 burrëror, femëror, i ngjirur, i ëmbël, i dashur,
 përkëdhelës, lutës, i ashpër, urdhërues,
 me zë të shuar, të mbytur, të dredhur,
 të shtruar, të butë, të ftohtë,
 të ngrohtë, të këputur, të mekur, i mirë, i pjekur,
 zë kumbues, zëri i parë, i dytë,
 zë gryke, koke, me një fill zëri,
 përgjigjet me zë, qan me (pa) zë,
 humbi zërin, e ka zërin bilbil,
 zëri i erës, zëri i pushkëve (i topave),
 zëri i ziles, zëri i këmborës, zëri i bririt,
 përhapja e zërit, jehona e zërit,
 zëri i radios, zë i brendshëm,
 zëri i Atdheut, zëri i detyrës,
 zëri i ndërgjegjes, zëri i zemrës, zëri i gjakut,
 zëri i kushtrimit, zëri i protestës,
 zëri i popullit, zë nga burime të sigurta,
 me një zë, njeri në zë, është në zë,
 ka zë, bëj zë, fliste nën zë, është pa zë,
 i mban zërin, zë në shkretëtirë,
 ngre zërin në qiell, zë i bardhë,....

*Preji sīt e vèsht fanīt
po e ndīnt shkòjn te zëa
pâ ngār ato, më se ndjē dier te faneme.*

(Jeronim De Rada)

HIJA

Hija i jep madhëri Fjalës
 atje fshehi(j)n poetët
 qyçin e kuptimeve
 nderin e njerëzve(t).
 Burri
 çë varrosi Diellin në dushk
 gjurma lëshon
 gjatë shtigjevet të Motit
 fjë në një katunde qelqi
 brënda gjumit mungë të gurëve(t).
 Shkurt
 trëndafila më hije shërton
 s'gjen më fjalë të reja
 sa të rrëfejë
 yshtjen dhe mahnitjen e agimit.

PA LIPISË¹

Pse fjutorojnë korrilat² e dallëndyshet
 tek qielli i këtij katundi
 ndonëse udhët e sheshet janë pa fëmijë?
 Kush i pret?
 Mosnjeri!
 S'e shohin se njerëzit u larguan?
 Se gjitonitë u stafidhjos(t)ën³
 se historia u bë rrëfatë⁴?
 Mund jetë se i kanë besë
 magnetizmit të kujtimevet
 rrrathëvet piçkulaç të pastër
 çë zbulohen
 prej buhoit⁵ i qetësimit të botës
 si martëri⁶ atij moti
 kur mbytej në sqithrat e pasqyrës
 në syrin e nuses dhe në manushaqën.
 Të pafajshëm dhe të egër
 fluturimet e zogjvet migrues
 t'ehjura⁷ si thika, pa lipisi⁸ si malli.

¹pa mëshirë; ²lejek; ³u thajtën; ⁴fre, kërcell; ⁵pluhurit; ⁶dëshmi; ⁷të mprehur; ⁸mëshirë.

DHIMITRI RERËS DHE KALI

Përralla të dhimbëshme
 bota rrëf(i)en çdo ditë me fjalë
 të mësuara përmendsh që s'ndërron kot
 edhe kur harresa fshin veprat o(se) i largon.
 Historianët me ndërgjegje të qetë
 e me pak fjalë bëjnë
 të pamundurën të gjejnë
 dokumente në pluhurin e arkiveve(t)
 data simetrike dhe shënime në fund të faqes
 sa të lajmërojnë të pranishmëve(t)
 zbulimet e çastit
 udhëheqës të paqenë dhe prova të rreme.
 Me ndërgjegje të shqetësuar
 gjer në shekullin e XV
 bij kush e di të cileve nipa shqiptarë të arratisur
 të shpëtuar nga kërditë turke të përhershme
 fjalë për fjalë
 tregojnë të rrëmbyer
 urdhëresat e fundit që Skanderbeu i pafan
 i sëmurë dhe i zbetë
 i dha stërgjyshërve(t) e tanë.
 ”... *ndë zallit detit,*
atje është një qiparis

*i hjeshtëm e lipëmadh;
 atje lidh ti kalin tim ...
 Mbi kalin, erëvet detit,
 ghapëni¹ fjamurin tim;
 e ndë mest fjamurit lidh e lé mahjeren² time.
 Kur t'frinj vorea e keqe
 murxhari më ghingllisën³
 fjamuri përghapjet
 e mahjerja trindëllisën⁴ ka i vrërti qiparis.
 Turku i gjegjën e, i trëmbur,
 tue kultuar vëdekjen çë fjë te mahjerja ime
 as ju pasën ngagha vart⁵”.*

Edhe gurët dinë se
 veprat nuk qëndrojnë
 pse mërgimi dhe vdekja pluhur i bëjnë
Omnia fert aetas, animum quoque⁶,
 shkruan Virxhili,
 po fjalët e atyre tregimeve
 janë të stisura përjetë
 në vjershat e rapsodëve(t) e në ankthet e të ikurve(t).
 Këtyre i përket
 të gërshetojnë ëndrra
 të tjerëvet
 i nget Apologjia e Historisë.

¹hapeni; ²shpatën; ³kali hingëllon; ⁴shpata tingëllon; ⁵nga kjo ai pohon se duhet të ikë; ⁶Koha merr gjithçka, madje edhe kujtesën.

MALL

Zëri u rrëfiks
 e lindi heshtja
 u piksën ëndrrat
 e u bënë gjumë
 drita brënda zemrës së pasqyrës
 u ngjesh me hije.
 Nani
 xura se malli i stis(in) vendet
 djeg trëndafilat dhe mbështjell kohën
 me pëlhurin e harresës
 si era e ngrohtë, si uji.
 Me anë të fjerrit¹ të këtij katundi pilikaç
 pata si të zbuloja matafrin² e Mallit e të rrënjvet!
 Kush t'ë thotë,
 po më duket se kristla³ në prak
 është mar'tria⁴ e t'ikurit
 sënduku çë vlon kezën dhe xhipunin e kaltër⁵
 varri i atij qielli dhe i atij dielli.

¹portreti, fjala s'është në fjalor, përdoret edhe në Horë (Piana degli Albanesi); ²lëmshin; ³gram ; ⁴dëshmitar; ⁵fanellë, jelek me mëngë i rrimtë, femëror, prej mëndafsh dhe i artë.

VOREJA

Poetët s'kanë dokumente
 s'mbajnë arkive
 flasi(j)n një gjuhë që nuk kuptohet mbjatu¹
 shumë herë s'dinë ato që shkruajnë!
 Për këto është një gabim të ligjërojnë
 rreth kalit të Skanderbeut (gjok a karat?)
 mbi mahjerën e tij (e rëndë a e lehtë?)
 për ditën që mundën shqiptarët (e ënjte a e prëmtë?)
 për natyrën e Turqëve (ishin ujq?)
 e për atë t' Arbëreshëve(t) (ishin lepuj?)
 Të lumtë
 sot dimë si ish moti në Shqipëri
 në vitin 1468, 1469, 1470 e sa zëmra më ka ënda
 e Poeti mund të rrëmbenj vorenë
 (vërtetë frynte në ato vite!)
 e të shkruanj abonsina²
 mbi murxharin³ e Skënderbeut që *ghingllisi*
 mbi flamurin ç'u përhap
 qiparisin ç'u shkund
 mbi mahjeren⁴ që *tringëllisi*
 edhe se turqit e arbëreshët
 nuk qenë as luanë as frikacakë
 dhe se përrëz⁵ e tyre ish: Dhon Kishoti, Sanço

Panca, Dulçinea, Xhiuljeta e Romeo,
 Kostantini e Jurendina, Ballabani,
 Karavaxhi me një ikonë nënsjetull
 Romanos Melodi
 një prift anarkist edhe malli imi ...
 Popo çë fat i lig
 të humben meqënëse nuk frynei⁶ voreja!

¹gjithnjë, me lehtësi; ²pa të rreme; ³kalin; ⁴cakorren; ⁵përrëth; ⁶frynte

GJELI E KOLLA

Nata me tërkuzën
 errësirën e lidhi te vukulla guri¹.
 Po ngjyrat dhe zhurmat
 shpëtuan nga anemi i heshtjes
 e nani eci(j)n mbi vaulla shurale².
 Helmi fjalët emrat mendimet
 gjumi pjanepsor i losi³.
 Shpitë, sy të ulët,
 fshijnë lotët qeramidhëvet
 e mbylli(j)n buzën dyervet druri
 Nuset vlojnë
 xhipunin e galtanin⁴ në sënduk
 pasqyrat e lodhura prej përfytyrimeve
 u vënë kallashinin⁵ hijevet
 vatra shturi prushin në policët⁶
 argalia s'yen⁷ më
 sollasteni masurët cungrana⁸
 prëhen mënjanë butë butë.
 Popo! sa djersiti Nata
 të nderonte gjërat e të pastronte Gjithësinë!
 Si sosi kolla e atij pjaku e këndimi i gjelit
 herët ajo pëlhurë u shqep.

... Ndërkaq, si thuhet,
shprish një dorë krunde
e psaj⁹ ec ti e mblidhe!

¹unazë guri; ²ripa rëre; ³mashtues, i remë i treti; ⁴fjongo me vlerë që i vendoset nuseve në kezë e që zgjatet deri në thembër; ⁵shulin; ⁶zgavra ku hidhet hiri i vatrës; ⁷tezgjahu 's'end; ⁸liq, kalam, krehër i rezgjahut; ⁹pastaj

DASHURUESIT

Nga zgavra hyjnore
të dehur e të papërmbajtshëm
qumësht dallëndysheje
pinë dashuruesit
pastaj
të Erosit trupa
më rrëqethe
ndryshimi të përbashkëta
shastisje e qiell
i bëri.

KUSH T'E THOTË

Kush t'e thotë mund t'jetë
 se ëndrrat ishin lumenj
 çë tu(r)e rrjedhur gjatë fushavet të natës
 shprishë(j)n gurë shurë baltë garoçe¹
 bashkë me dëshirat mallrat ankthet
 me të cilët stis(t)ën katundet tanë të jugut
 i rua(n)j tashmë dhe janë të xheshur
 duken pëllumba të bardha majë një druri
 ose kopile çë bëhen gra
 e pasqyrohen në qiell
 gjinj qeramidhesh të ndera në puhi
 dhe me buzë të kuqe
 në vrundullin e monostrofës.
 Le të prëhen ... le të stolisen dal'e dalë!
 Gjeografia
 do të ketë shekuj me kufë²
 sa të qëndisë(nj) pëlhurat e shkretëtiravet
 me kronje të reja
 këmbë ulliri, shegë, konopica³
 perivole⁴ me vasilikuan e trëndafilin
 edhe të bukurat gjithoni mes-holla!
 Historia

herët do të marrë hua gjinde
ku do të ndodhen
për të grumbulluar helmëzen⁵ e botës
kur të ketë ngé
kur të ketë mot.
Nani, ju lutem,
le të prëhen ... le të stolisen dal'e dalë!

¹strung i kalbur; ²sasi; ³landra; ⁴kopshte; ⁵lemzat

NDRI', KU VAJTE?

S'ish e varfër ajo shpi
 ish një shpi si gjithë të tjerat
 në verë dera e katoqit¹ po rrij zgardallist²
 e nganjëri mund t'i shih(te) brënda
 tryesën, vatrën,
 një kalendar të kamnisur varur në mur.
 Nga ana tjetër ç'kish të fshihte?
 Shpia s'mund të ketë turp
 dhe sytë s'mund të priren prapa
 as të trokullisin(jn) në derë.
 Si është zakonë tek ne, në Jug,
 gratë e bushtra
 pasdreke rrinë (të) ulur(a) në gjitoni
 me anemin më truall e boshtin n(d)ë duar
 ture tundur krahët n'ajër, të lehtë.
 Mbi qiell fjaturimi i dallëndyshëve(t)
 ngatërrehet rreth diellit çë trakulon³
 tjerrë(t) mblidhet te lëmshi i hënës.
 Po gratë s'i vënë fare kufi
 e çuçulisijnë⁴ me këdo shkon:
 "Ndri'⁵, ku vajte?"

– “Njo, vajte te Ngjiska”

“Rri mirë?”

– “Oh oh, rri si pjaka ç’është!” -

“Poka⁶ ec me shëndet!”

Zoti Krishti im!

Si bëjnë ato gra të jenë të lumtura
pasi vunë jetën picmbëkocë⁷?

¹kat përdhes; ²e hapur tërësisht, zgardhëlluar; ³perëndon; ⁴bënë muhabet; ⁵ndrikull; ⁶prandaj; ⁷së prapthi, kokëposht.

ME THIKËN E POEZISË

Ëndrrat i vesha fillandin¹je
 sa të ruheshat nga akulli i dimrit
 e fillandinën m²e hëngri kopica.
 U vura kundrela² diellit
 sa të mblidhja rrezet
 e pasqyrat u mbluan me hije.
 Atëherë me thikën e poezisë
 grapsova³ natën
 të mos shkrepnin yjtë
 pastaj Gjithësia u derdh
 së bashku një lumë me markadesha⁴.
 S⁵ke çë të thuash!
 Ndonjëherë poetët janë
 martri⁵ të paditur
 të grackës së ngjarjeve(t).

¹fanellë leshi dysh, e trash; ²ballë; ³gdhend, çaj; ⁴xixa; ⁵dëshmitarë

SI RRINË SHPITË E GJITONIVET?

- Si rrinë shpitë e gjitonivet? –
 - Të gjitha pa folur, në mëngjes -.
 Njera shpi krahë ngryq
 - rri e tiksurr¹
 shpia tjetër krahët hapur dhe pëllëmbët e duarve
 drejt qiellit
 - në lutje
 ajo afër krahë ngrëjtur mbi strehun
 - e pafanë
 një tjetër shkulen qeramidhet² e i hedh në erë
 - e çmendur
 kjo hundëkërruste ruan fikun e zi ç'u bi në prak
 më e pikulluara buthëton³
 ndakat të vatres si lavoma⁴
 të sprasmet rrinë për gjunjë me dritaret e çara.
 (...) Jashtë ja zdredh⁵ bora
 që grumbullohet rreth një(j) fjale.
 Unë i tiksurr, në lutje, i çmendur, i pafan,
 si shpitë e mia
 me kyçe kopile të një mijë fjalëve
 shpërthej derën e gjërave(t) të heshtura
 ndjenjën e lëpushës mbi zdramët e mureve(t).
 Ju e dini se si janë shpitë

*nëse ty i zhvesh
ato ngurtësohen menjëherë,
kështu thotë Gjergji Saferis!*

¹të shtangëta; ²plakat; ³tregon; ⁴çarjet si stigmata; ⁵borë me vorbull.

BARUT¹

Prapa pëlhurve(t) baruti plot buhua²
 avullojnë katundet e jugut
 si erëz gjishtle³
 në varganët e majit.
 Gjitonitë - eshtra të bardhë fluturash -
 shpërngulen ndaj gjeografive(t) të tjera.
 Unë e di pse i pagjumë
 dëgjova lehmitë e qenve(t)
 dhe zërin vajtues të qyqeve(t)
 më të thekët në thellësinë e Motit.
 Fajtorë atë zë statujat prej gjipsi
 me mbulesa të përlyera me *pathos* e korranxeza⁴
 ik(t)ën nga qoshet
 e në rresht keza, vatra, valle,
 finja e ylberit e vidha e saj
 gjestet e përditshme të kalimtarit, besa,
 urimi *rrofshit sa buka e vera*
 tejkaluan zgjedhën e hapësirës
 të vëzhguar prej syve(t) të Nemezis.
 Në arkeologjitë e zbrazjes, tani,
 të paktën ndihemi të trazuar ...
 çdo gjë na duket e pasigurt
 harresa e dalldia e përmbajtjeve(t)

me të pazgjidhura enigma plot.
 S'dimë më nëse gëzhollja
 është një zog
 ende një fletë misri
 dhe guguçja një vajzë ose një pëllumbeshë, a ndryshe.
 [Në shkatërrimin e zhdukjes
 nuk e dimë se cila nga të dyja do të humbët].
 Heshtja s'ia lë ngëmshtin⁵ vetmisë
 tu(r)e nxjerrë pa ndërprerje
 me pasqyra dhe jehona
 bredje përfytyrimesh
 fjalë në rreshtin e tingujve(t).
 Popo, Jugu im,
 i kthjellët dhe me ngjeshje epshore
 të lutem më thuaj nëse *vitorja*
 ende është një gjarpër me bri(rë) ari
 një lopë, ... një pulë,
 një bletë a një ndër *Tre Zanat e Natës!*
 Dëshmoje se njerëzit
 i shporr jashtë tokës së lashtë
 vetëm për t'i pasqyruar
 në dhilpet⁶ e jetës
 ku dalldi dhe trallisje po japin jerm.

¹lëndë plasëse, por këtu shirok; ²pleh; ³dorëzonje, llumere; ⁴mana të kuq; ⁵rri pas pas si hija; ⁶klindet, niet te Hora e Arbëreshvet

JUGU DHE FYTYRAT E NGJARJEVE

Gjithëçka sfaret
 por si hardhucë
 Jugu theket në diell
 mbi shtyllat të Tempujve(t) prej guri
 të shtrira për tokë.
 Jugu rri.
 Përgjon dhe rrudh¹ supet për kufijtë
 ç' duan të vendosin(jn) në Mesdhe.
 Ndërkohë po hipen ca njerëz e zdripen
 si grerëza lëvizin
 stafidhjosën² katundet ...
 Jugu si fëmijë buzëqesh i porsalindur
 qan me sytë e të varfërit
 furishëm nëm si nënat.
 Jugu tundet vetëm
 ndose ka nxe³ e nge!
 Nga ana tjetër,
 Tragjedia i rrjedh në dejtë,
 dhe Filozofia e rëndë i këput(in) kurrizin
 kur ec(in) në arkeologjinë e përgjumur
 të fushave(t) sot me dredhëza, sparta e gorrica⁴!
 Në diellin e xhullandave(t)⁵
 mendimet, ëndrrat, asgjësimet në luftë

lumenjtë me lot
 Jugu për çudi i bën të thahen
 si fiqtë ndër rujanjet⁶.
 Për të lëvizur, për heqjen e samarit
 Jugu i moçëm pret vetëm një shenjë.
 A do të jetë hëna ç' erret ose dielli çë nxihet?
 A është vallë ai baruti çë përcëllon trëndafilat?
 Mbase... anijet e mirënjohura në rrethin e qiellit?
 Këtu çdogjë është e ngatërruar.
 Si thoshte Euripidi

*Po ndryshojnë fytyrat e ngjarjeve,
 baras zgjidhjet e Hyjnive kujt më s' u kishim besë;
 ajo që prisni nuk ndodh
 ndërsa Perëndia gjen shtegun për të bënë detin kos.*

Njerëzit s' e dinë se shikimi i Jugut
 ka fuqinë të djegë pëlhurë e Argali⁸.
 Tërbimi plot zbrazëti e zagush
 njësh me thumbin e zeskut⁹
 bënë lëkundje në gjeografi
 hutime midis popujve(t).
 Këtë thonë¹⁰ Rrasat e Armonisë.

¹ngre, shkund; ²veniten, fishken; ³kur i dheksset, i ka ënda; ⁴dardhishkja;
⁵brezareve; ⁶kanistra.; ⁷i vrenjtur; ⁸avlëmend; ⁹zekthit; ¹⁰dëshmojnë.

NGJASHMËRI TË MOÇME

Virgëndja¹ çë tagjis sirkun me fletë mëni
 pret një shenjë nga klindet e mëndafshta të puhisë
 picihudhra² më tryesë
 tërheq shikime nga padukshmëria
 jehona e hapave të errësirës
 i përgjigjet pragut të gurtë të mbytur në diell.

Ngjashmëri të moçme
 u shembën në vrundujt e fjalëve(t)
 gërmadha të kalimit e tyre
 ç'gjuha më s'i gjen
 buzë ëndrrave(t) e gjellës.

Gjetiu ngjeshet brumi në magjen e Rruzullimit
 rritet një qiparis me degëza argjëndi
 ndërsa në zagushin e zjarrtë të dherave(t)
 shprishen zbrazëti e markadesha³

Në zemrën e të huajt magjia fsheh(in) rrënjë
 dhe bukuria e egër e tokave(t) të largëta
 shpërthen manushaqen e humbur.

¹Gruaja përgjegjësja e ushqimit; ²lëmoshë që i jepet të varfëve të shtunën e të vdekurve për kujtimin i tyre, zakonisht misër i zier, bukëza në trajtë e zgjatur, në arbrisht "picatul" edhe grurë; ³xixa

JUG-KALYPSIS

Ra i ri! - tha Rea.

Mbi shtratin e qiellit Dielli te një lëmë gjaku
rrezet shkoqi sikurë të ishin koqe prej shege.

Dëshmor si përherë
vdiq katërqind dërhëmë
edhe sonte në të grysur.

Dielli s'ka të vejë më andej se sa i përket(ë), thot Erakliti.

Në Thuri, më 379 para erës sonë

rreth tryezës së gjelbër

Hyjni të mbledhura në kuvend

bisedojnë rreth caranit

nëse është kujtimi i tundjes ose amull

dhe rreth dilemës së thekët të Voresë

“A ka më rëndësi një Qytetar Nderi ose Perëndia?”

Ende në Fushën e Sybarit, më 2008 pas erës sonë

ndërmjet lumit të vjetër e detit grek

të mbështjella me të zeza

nënat vajtojnë bijtë që ranë të ri

çë sot Lugetër fluturojnë

të nxirrjartur¹ mbi argomat

si farë karkoresheve².

S'ka dyshim

Ligjet e caktuara për Diellin në kupën e qiellit
janë të barasvlershme edhe për njerëzit mbi Tokë.

*Me luejt kufinin midis Demokracisë e mizorisë
është një si me luejt me eshtent e të dekunve, thotë Kanuni.*

¹të tërbuar; ²lulëkuqesh

BUHOI

Në këmbë, Zotërinj.
 Unë jam Historia!
 Në këta vende kam shkuar dikur
 ... do të më njihnit tashmë.
 Paçi poni për mua, ju lutem, për hir.
 A mosnjeri s'ka parë gjë në buhoin¹ e Motit?
 Si prirni sytë djathtas
 gjeni njëzetë hapa
 janë ata të çizmeve(t)... të Njëzetvjeçarit.
 Gjashtë të tjerët mbi rërë?... të luftës të së Gjashtë
 Ditëve(t).
 ...Thundrat te lucet e udhëve(t) të Jugut
 i la kali i heroit Skanderbeg.
 Nga larg, mbi borën,
 po duken (endel!) gjurmët e elefantëve(t) të Hanibalit.
 Pas aq ngjarjeve
 vetëm vragët mbeten- mbi buhoin
 rruvijat² e përcipta- në kujtesën.
 Atyre u lyp strehim Historia
 për të vënë rrënjë të pazgjdhshme
 e hije dredharake.
 Për ne të vdekshëm
 shpëtimtar është të haraksurit të ditës

fshiesat (prej) sqini ³ që pastrojnë
gjurmët të ngjeshura me gjak e lot
zinxhirët e tankeve(t) në kopshtet e Tian'anmen-it,
të Shën Vençeslaut ... të Drenicës.
Jo vetëm poetëve(t)
edhe trëndafilave(t) u bëjnë efshe ata hapa.

¹Pluhur i holl; ²gjurmët; ³dushkull i rëndomtë, shqind, xinë.

E BUKURA MORE OSE LËV DATË I PAVENDIMIT

*Kënaqësia për të udhëtuar
Drejt gjallesave të harruara
Nëpër rrugë të paharrueshme. (Paul Eluard)*

Nga pesë shekuj po këndoj
një kthim të pamundshëm në të Bukurën More.
Këndoj si po dinë blegtorët endës
gjatë brigjeve të Jonit e të Mesjetës.
Këndoj afër zjarrit të kasolleve
që Peshkopë e Princa
më bënë të ndërtoja
në gjeografinë e pavetëdijes
ku shtigje të paparë e të brengosur
dallëndyshe afrikane marrin frymë
të dehura nga vjeshta.
Nga pesë shekuj i njëjti pathos
i njëjti ritëm të foljesbukë.
*O e Bukura More
që kur të lashë,
kurrë më s' të pashë!*
Në muzgun e kohëve
Bujarët, në rrathë, pas shpagimit të të dhjetave
mbollën djallëzoren vazhdimësi të së tanishmes

dhe në bebëzën e vesës së bijve
vendosën trashëgiminë e ditëve
dhe ethet e ringjalljes.
Gratë krenare, fytyra hëne,
mbi malet e Kalabrisë dhe Bazilikatës
shikuan të tërhequra Morenë
dhe ne bij plot mahnitje
shikuam mëmat yjsh të stolisura
dhe fushat shegash
që e folmja-vizatuese e tyre
na qëndiste në purpurën e kujtesës.
Të Bukurën More
kërkojmë ende, unë dhe Zefi,
tokë e lashtë mërgimesh të pandalshme.
Zefi është shekulli XVI
dhe ecën shpejt zbraps
tue shikuar myshkun e bredhave të mi.
Zefi thotë se e ka parë të Bukurën More
dhe dhjetrave lajmëtarësh
ua ka bërë ta binin vronjën
dhe ta shpallnin urdhëresën ...
Do të jetë Besa e shtrënguar me kohën
malli endacak të bashkërenditjeve
por e Bukura More ime
është ndoshta vetëm një kundërmim i përkohshëm
që zbyll në të tanishmen hapa
e asgjë tjetër.

VILIVILI

Në Orën çë më ra
 llomotis(inj) një gjuhë ç'po sëndiret¹
 me mall të vjetër
 mallin ç'njerëzit pështuan² brenda dushkut
 pas gjëmimit në qiellin prej myku.
 Po rrjedhin
 si ujë të fshehtë gurrash
 në zallet e përrenjve(t) të firastë³
 fjalë
 të gërmuara nga shtjellat e jetës.
 Një vilivil markadeshash⁴ në natë
 shndrit kamnenë⁵ e tregimeve(t).

¹plaset, kriset, davaritet; ²shpëtuan; ³humbja nga tharja, fira; ⁴vezullim, përshkënditje edhe 'viriviri' i xixëllonjash; ⁵blozën, tymin

DORËZIM I PAHIJSHËM

Duart unë e di
si dhendurë
duan gjëra të ngasin
të shtrëngojnë
ndoshta për këtë arsye u kanë lindur
anasjellas sendet
në një njohje të paanshme
si nuse rrin pezull
atje ku gjenden në pritje ...
dale, ëndërra
shpeshherë rrjedh vetëm
drejt një dorëzim i pahijshëm
brenda njetër ëndërr.
Kjo vallë
është natyra e gjërave
për të takuar duar të vendosura
sepse këtu në Botë
s'dinë më të vegojnë.

●

S'ka rëndësi
 nëse pika është e para
 ose ajo e fundit
 ajo që hap(in)
 a mbyll(in) shprehjen e tregimit
 disa herë edhe gjellën.
 Ajo mendon
 të na ndalojë si tank
 të vendosur përpara një fushe me (dë)borë
 një heshtje që tremb(in) fëmijët
 një pushim i gjatë.
 ... Megjithatë
 ne e bëjmë zemrën gur(i)
 shko(j)më nepër radhët
 ne vemi përpara.
 Mos harro
 se s'ka përplasje
 që në të njëjtën kohë s'është krijm
 dhe qëndresë që s'është
 drejtpërdrejt hapje e botëve.
 Këtu meazallah¹
 s'kemi një çështje të ditës gramatikore
 por një çështje jete a vdekje.

¹kurrë

THONJËZAT

Përpara atyre “ ”, thonjzave, si në skenë,
 her’e herë ngjan t’i japësh
 një(j) letrari fjalën ose njëj bujku
 s’është një problem klase(je)
 rëndësi s’ka nëse ai është (i) gjallë
 o prej mijëvjeçarësh vdekur.
 Fjalët e tij
 (ndoherë të ashtquajtura *citime*)
 vendosen, pas rastit,
 brënda një kthine a në vargje
 në mënyrë që pastaj mund t’i varen
 dy kaçurrela “ atyre syve të huaj

[Thonjëzat janë dredhi të mbizotërimit të shkrimit
 i cili, pas Trubeckojt, kërkon lidhje gjuhësh
 dhe poezinë e gramatikës
 një përzierje fjalësh dhe gjuhësh
 të brezit të aftësive, thotë Jakobson]
 në pritje turbullirash të tjera
 është bukur të përfytyrojmë
 ata zëra në librat të KUNDËRVËHEN
 këtu dhe tani
 dhe të mbrojnë një parim DEMOKRACIE

gramatikore
ose përndryshe VETËVENDOSJEJE

(me pak fjalë *nëse*,
ku, dhe *kur* të marrim fjalën për:
1) të psherëtiturë; 2) të qarë;
3) të uluritur; 4) të lutur ose të nëmur;
5) të kujtuar; 6) të soditur;...
të hapur ose të mbyllur thonjëza të tjera ...)

Ato fjalë me pranga dhe në mërgim
po i shoh çë rrëzohen
ku s'ka më as tokë as ajër as qiell
në kontekste pa 'merak'
dhe jashtë territ të pakufish
përtej lumenjve të ngathët të natës së errët
të themelojnë
si kolonë greke, *polys* të reja,
ku duken kronje dhe shtretër
kallinj gruri të korrur në heshtje
.....
çdogjë në 'të pritje të stërgjatë ku
*"edhe të folmet tona duken të dyshimta
aq sa dhe rreth secilës së këtyre lëndave
është e pamundshme të mendohet me ngulm
nëse jeton nëse jo
po të jetë e të mos jetë
po të mos jetë e të jetë"*. (Platoni, Republica 479 b-c)

HYJNITË U LODHËN

Alla skultata¹ rrëmbeva Hyjninë në një lodhësi
 të rendë
 drej e sfatur, pa turp, e shtyer te një hjirë².
 Përjetësia lodh(in), këtë e dimë!
 Ç' do se të rrëfij!
 Me shoshin s' mund fshehet dielli!
 Shenjtërit, në shkurt, ishën me mjekrën të bardhë
 të gjat njera ndër këmbë
 e bardhë si Kashta e Kumtrit
 gjirin të sëmurë për zemrën
 një tubet me pilula i vendosur mbi një re
 dashnorët flisi(j)n me fjalët e televizionit
 petalet e trëndafilave(t) të përmystë
 ashtu lulat e spartave(t) gjat udhat të mbrazta
 të katundeve(t)
 ishën të shtypura nga tanke.
 Pa tjetër Hyjnitë u lodhë(ti)n!
 Nuk kemi më si t'i pataksëmi³!
 Të dymbëdhjetë yjësitë e zodiakut
 si anema sillen rreth e rrotull gjitonive(t)
 tu(r)e i përqaftuar edhe kuturunat me vasilikon⁴
 një kezë pak e sfitilostë
 një pasqyrë e sëndirtur

këshetët të Jurendinës e më e më ...
 Fatkeqësisht s'kam martri
 sa të puthin(j) benë për ato çë pashë
 me sy të zgurdhulluar!
 Po në grusht më qindruan dy lule spartash⁵
 era e këndshme e vasilikoit ndër nunëzat.
 Ng'mjafton?
 Çdo herë gjetkë dhe i ndryshëm
 plaku Dyoniz, i huaj, trokullis(in) dyert e një(j)
 vendi pa njerëz
 kurse kumborët bien më harë
 korraçat dredhin valle me karramunxat⁶ çë fryjnë.

¹befas, papritur; ²kënd; ³t'i kuptomi; ⁴enët me borzilok; ⁵gjineshtra; ⁶gajde

SHKRONJA H

Shkronjën H e kanë piksur Feniksët
 për ta ish heth, një frymë çë thithej
 dhe gjurma i gjit¹ një(j) vathi po kush t'e thot nani!
 Veç italianët për atë gërmë kanë pasur llijena²
 aq se e hodhën nga folja 'kam'
 e vuan një theks mbi zanorët a-ja, o-ja.
 E ultin te tryesa e abetarit
 por mbi gjunjët e të tjerve(t) tinguj.
 Fashizmi pra e nxori drej nga shkolla fillore!
 Unë nuk di pse popujt dhe gjuhët
 kanë zakona aq të ndryshme
 me këtë Shkronjë.
 (Di)ca shamarikujë i taraksin³
 me H-jan e madhe
 bashkëtingëllore e heshtur dhe e shurdhër
 përpara zanoret e pafajshme
 bëhet e thatë me diftongat italiane.
 Gjetk, nënat mbruanjë zërin e bukën
 e thënë: Ha, biri im!
 ndërsa më gra ndër gjitonit
 zënë fill e flasi(j)n me një hë
 çë përmbledh heshtjet dhe së bashku
 shpresat e popujve(t) të shtypur.

Te Dheu im H-ja është shumë e rendë
 ja dica fjalë: HYJ, HI, HYRÌ, HIÇ, HALL,
 HARÈ, HELM, HARRES, HON, HIJE...
 Të gjitha janë puhjiza
 sqythra të izotopive semantike
 gati të lirohen nga praku i gjuhës
 deri të derdhen në grykajën e heshtjes.

¹i ngjante; ²problema; ³dica fëmijë i trembin

KUSHDÒ MUAR GJË NGA KATUNDI

Të gjithë morën diçka ka katundi
 kush hjën e dushkut, verën, valët, bukën e shpisë,
 kush një fotografi nga taraturi¹
 skamandilin² me ngjyra të mëmës
 qetësimin i gjitonisë e të falat
 kush një përfaqim nga gjirit
 një shikim nga të vdekurët ndër varrezat
 kush muar ndër rugat erën e malàtit³ në lëng
 një qelq pjukur⁴ me shokët
 ngjyrat e qiellit, retë të larta e vapën e verës
 profilin e maleve
 mindullat⁵ me lule në brinjë
 tingujt e hapave në nxilikatë⁶
 dhe këndimin e cinxrravet të çmendura
 kanë qënë dica çë morën
 ngrohtësinë e shtrëngimeve duarsh
 kujtesën e dashurisë së parë e njëj fjale të moçme
 një lutje në gjuhën tonë
 palacat⁷ të yejtur nd'argali⁸
 ata të ndëjtur ndër ballkonat kur shkon Shën Mëria
 e psa(na) pamjet dhe kupolat e kuqe të lindjes
 karramunxat⁹ çë fryjnë, uratën e plakave
 arin e ikonavet, dica morën farën e karafilavet,

të tjerë njerëz ato të nënshtimit
ata të turbuar në gjoks ngallostin mallkimin
më gjindë në trastë ngallostën
farën e krenarisë e të kryengritjes.
(...) Kushdò mori gjë ka katundi
e katundi i rrëmbej të gjitha
dhe i pështolli në heshtjen e lashtë
të atij çë di dhe kurrën e kurrës mund të flas.

¹sirtar; ²shami; ³tredhak; ⁴gotë me verë të fortë; ⁵bajame; ⁶kalldrëm;
⁷mbulesë; ⁸avlëmend; ⁹gajde.

KËNGË ORFIKE PËR JUGUN

E bija ruante të ëmën në shtrat, e vdekur,
 e me sytë i fliste sikundra ish e gjall
 bisedonte si përditë
 vetëm se ajo shpi tani është plot gjitone¹
 çë i rrethojnë të dy në mest dhomës
 si vajtores të moçme pa hjidhi
 qetësi duhet, pezull Gjërat.
 Nënë (m)burime së Gjellës e njohin mirë Vdekjen
 e me to vënë ngushtë², bëjnë treg.
 Për këtë arsye Tragjedia ndoshta hjetullohet me ëmbëlsi.
 Kur shpitië qindrojnë pa njerëz e pa zëra
 pse grat ikën përherë
 një thirrme si gjëmim
 shqep Gjithësinë dhe muret të turpshëm të gjitonisë.
 Te Hora³, sot e mot, kurrë do të jenë Mëmat,
 të Mirat të ruajnë zjarrin e Vatres
 dhe fshehtësitë e Fjalëvet
 në trajta lulesh dhe kokonara rrushi⁴
 mbi palacat të yejtur në argali⁵.
 ... Një tjetër shpi e zbrazët, një tjetër derë e mbyllur!
 Ki është Jugu im.
 Burrat rrinë jashtë shpisë më lip
 presin mbë udhë të dal i vdekuri

ture folur me lehtësi për stinat, fushat,
 verën, vajt, drutë për dimrin, ...
 por edhe për zigan⁶
 çë pat vëjnë nën shtratën pse s'i dilte
 shpirti i njëj burri ...
 Kjo është Vdekja në Jug.
 Darakopsem⁷ te rehjet me ullinj
 drejt Detin Jonë, pranë Kroton,

guizmatë⁸ e shpivet të zbrazëta
 më vijnë pas, ngë më lënë këmbën.
 Këtu, një herë, breg detit,
 nëxënësit e Orfeut me lirën e vjershat
 ndalojnë lumenj dhe erëra
 mishërojnë gurët
 lisat rrinin me veshët të hapura
 kafshët butësoshshën
 bashkë me njerzët.
 Por ndër fshatrat malësorë
 ngë qëndroj as një mizë
 pështuan edhe Hyjnitë e Pyjve!
 Vetëm një filozof, te sheshi, shkon motin
 me një grusht pleq
 e rrëfyan rrëfyan me ëmbëlsi se
 shpirti e kurmi janë të ngjitura për gjithëmonë
 ashtu si harmonia me telat e lahutës
 edhe se fryma do të vdes kur shqitet nga kurmi

ai filozof plak quhet Filolao
e ka qenë mjeshtri i Arkitës ...
Por grat ka mot e jetë dinë më se aq
... kur të ndodhet se kurmet⁹ ndahen nga shpitë
dhe shpitë të qëndrojnë esull,
dyert të mbyllura me sallaçin¹⁰ prapa
do të thot se Bashkia, ... Gjiria vdiq
katundet si lahuta u shuajtën.
Ahirna grat vajtojnë me zë çë plasën Qiellin
shqyer pëlhurën e Natës.
Kushdo le të trihjimiset për ata shpi të mbrazëta!
Ndënjeri të zgardhëlloftë¹¹ ato dyer!

¹fqinjë; ²bast; ³fshata; ⁴bistak rrushi; ⁵mbulesë në avlëmend; ⁶zgjedhë;
⁷zbres; ⁸ulërima; ⁹trupat; ¹⁰shul; ¹¹hap

XIXËLLONJA E VETMJA

Do të ketë qenë ikja e vetmja
 a thjesht errësira dhe frika
 çë shtyjin të mërguarit shqiptarë
 (ata të shekullit XV çë zunë detin drejt Italisë)
 të gjejnë aq emra
 për këtë kandërr e nëmur¹ dhe romantike

panikuçe, bukurezë, bukadjathëz, çikëlore,
 cilivile, kakëdhonë, çikëverë, papadhine,
 karmaneshe, bubaleshë, shkëndijëz,
 bubareshe, bukure, mashkunjare, bukere,
 nusaz, bukureshë, buburiskë, çik, llambro,
 vezullonjë, xixëllimë, xixëllonjë, kakëdhözë,
 pirokë, gjelbaba, gacullinë, zjamez,
 gacullì, gacemgjigjë, markadeshë ... !

Historianë dhe gjuhëtarë thonë se
 ka qënë kujtimi i kalbët i shqiptarëvet
 çë shtoi gjithë ata emra madhështorë
 për atë thërmijëz ... por patjetër edhe
 i ashtuquajturi Moti i madh pati një pjesë e rëndësishme.
 Me kaq, sot kush mund puth bé si vanë gjërat!
 Të errëta janë rrënjët e asaj fjale.

Përkundrazi u humbë(të)n
 markadeshat ndër fushat
 e janë tue humbur edhe fushat
 njerëzit duan shpi
 po shpitë të grumbulluara nuk bëjnë më gjitoni

Po me një shpi e një shtrat ngë ëndërrohet!
 Sheshi ngë është më kërthiza e kryengritjevet.
 Ka do shkon bihen shkretëtira
 mitologjitë janë të skotisura
 kali i Skanderbeut vrapon brenda një rrotullame
 Qishë dhe Minare përkrahin Kulla/Hotel
 të shuar fara e Besës, ëndërravet e vegimevet.

Mund jetë se i Ligu na mallkoj e na zu nëma:
 - “Ju dalt hithra në Vatër!” –
 e Vatra u bë shterpë, nuk polli më fjalë,
 ngjyrat janë po dy ...
 Xixa është vetëm xixë
 Vetmia mbiu kudo
 e u shprish si egjër në drithët.

Akademia thotë me një zë
 se ky është Kurban për një Jetë të re
 e se me to Hyjnia
 Motit kështu vendosej në Historinë.

Por Hyjnia ngë të shet e të blen!
Kanë hedhur gëlqere mbi emrat e xixavet.
Humbjes dhe Vetmisë
nani i thënë Zhvillim.
Aq e kaq.

ARGALIT E PENLYPSES

Mbi fytyrën dhe në sytë e tu
 njeri mbi jetrën shtrohen stacionet dhe shinat ...
 ndërsa treni me vrap
 na sjell larg nga gjeografitë e pavetëdijes ..
 Andej dritares rrënime arkeologjikë
 shtylla dorike, gjyre hyjnore dhe pjellore
 përrenjë me shi ndoshta lotët e Herës Laçinia

Pa kufi po me ëmbëlsi shkojmë përkrah detit
 e prapaz neve shikime
 çë mbjidhen si qilima të mëndafshhtë
 strosën me fuqi
 plot me erë spartash, shkumë deti,
 uji të bekuar nga prifti
 po edhe uji i krojeve të harresës së katundevet
 me gurgujt të ëndërrave(t) të burravet të motit
 par të mërgoheshin drejt Amerikës së Humbjesë¹
 e psa ishuj, fusha, vreshta trimosh, shega, ...
 shpi të mbrazta e të grumbulluar mbi kodrat,
 udhë me nxilikata², ...

E pas neve vjen si Fati një ani me pëllhurën
 e fryrë nga Puhia e vegimet e të marravet

çë asnjeri mund reshtënj
 ... sikur t'ishim fëmijë të magjepsur
 nga këndim i cinxrrave(t) në mest aravet
 a nga vargjet e barkavet në të ngrysur
 në erën e kriposur të detit
 çë shprishet ku do janë kulla
 dhe tingëllimi i kambanavet bizantine në murrilan.

Ti e shtrirë mbi shurën më fal lëkurën
 sa të ngjyros me lëng korranxesi
 hieroglifë të kuq
 ndoshta gjitoni të vjetra e harta të fshehta
 llavina³ prej purpure dhe mjalti me mijëra araz ari
 çë rrëzohen nga gjiu e nga zëmra
 si vara të bjerr ndër pyjt ...
 Kurmi pa mbrojtje
 hapet vërshimeve të beduinavet dhe të asketavet
 në bregun e bardhë një grusht margarita
 gjeometri pitagorike të mbuluar.
 Zëmrën e ke tokë e uji
 kurm⁴ i madh e i bjerr në rrugët
 të ngatërruara të ndërrimeve të dritës.
 Ty shtyj në një qiell i banuar nga Hyjni të lashta
 të ulur në rreth në vapën e plogët të Jugut
 grushta shekujsh
 një shi yjesh me bisht bie drej
 mbi rreshtat e vreshtavet

midis horizontit dhe hënës
 si fishekzjarrë ndër netët e verës.
 Kupa e qiellit dhe Zodiaku vallëzojnë
 me muzikën e karramunxavet
 të katundeve të zbrazëta
 Gjithësia fryn mbi rehjat⁵ me vorën
 tue shqyer mbulesat e argalivet
 në një vrundull me lule trëndafilje e gjishtlash⁶.

Pasqyrat të mbuluara në natë me pëlhura të bardha
 më prirëjnë Hyjën që shikimi brumon
 sa të stis Toka dhe Gjella të shumta
 Jugu im!, me fusha plot me kroje e badhra
 jehona jote dhuron ëndrra
 të thurur me luftë, mall dhe dashuri
 dhjâ si vasha që u bii dhrii e baardh e u cumbis
 te kipariszi.

¹Amerika jugore; ²kalldrëm; ³rrjedhë uji pas shiut; ⁴trup; ⁵kodrat;
⁶dorëzonja

NGA DRITARET E HIDHURA TË HISTORISË

Rrëzohen këmba këmba
ka shurat e shkretëtires
kërcejnë telat gjembore të filaqive(t)¹
fshehuraz pështojnë nga ushtri dhe tregëtare
sa të bëjnë udhën
e çafkave(t) e të kurrilave(t) mbi Mesdhetin

[...] Shumë ndër këta të nëmura
mbitan në mest valevet
deti i ndukin si ve pëllumbi
Keraaman e Khatebeen dy engjëjtit
çë Kurani kumbis
mbi shpatullën e djathtë dhe të majtë
kryesisht të këtyrve të shkreta
sa të marrën vesh çdo ditë
vepravet të mira ose të liga
mund prëhan ... s'ka më punë për ta.
Nëng shikoni se vdiqë(ti)n?
Trupat vanë posht
në thellësinë e ujërave(t) të kaltër
pranë anive të darrakopsura²,
statuja prej bronzi, ena, ...

krerat duhet të jenë të pjerra drejt Mekas
 topologjia dhe feja ashtu dëshirojnë
 për fat të mirë
 trupat u pastruan një tek herë edhe më ...
 Të gjallët me Zanat vetjake për krah / *hafaazah*
 arrijnë dalë-dalë
 midis fusha si shtoja- sajājīd
 dherat e Megale Hellas të motit
 marrin vend
 brenda kalive(t)³ me lllamarina hekuri
 midis binarët të stacionit në Kroton
 ndër shpiza prej guri
 me ndaka e pa qeramidha⁴
 të vluara ndër fushat e Metapontit
 a kumbisen në Sybar
 ndër katoqe⁵ të errëta, përdhese,
 të gjitonive(t) të mbrazta mbi kodrat
 Ng' janë më njerëz
 po drejt krahë për punë
 ndër dhera me narënxa, dredhëza, domate, ...
 të shprishur në gjermime arkeologjike të nxehta
 ku dielli s'ka lipisi⁶

[...] në këtë vrathaq dhé⁷
 pizull magj'jas⁸ të Jugut
 praku i Gjithësisë të filozofëvet Ipasso dhe Arkita
 njeriu për herën e parë

hetoj harmoninë e tingëlve
sasit të pamatshme

Të qenit qytetarë të atyre *polys*
për Perënditë ish(te) krenari

[...] Këtu, të mallkuarit e Jetës, pa tokë,
Shumica nani⁹
në lutje nani në luftë
e varfër lypën një shpi, strehim njerzorë,
drej si ndodhi për Danaidët
në tragjedinë e Eskilit
ki është Faj
çë mban popujt të poshtëruar nga uria
ndërsa mallrat qarkullojnë në liri!
Këta të varfër
hedhin baltë
në fytyrat e priftërinjve fodull
ndër Kishat e Tregut.
Kujtohet se trupa dhe fryma i gërvishiti
“një kufi i pakalueshëm në pronësinë e jetës”
[...] dallandysja të lodhura
në hartografi të shqerra nga heshtja
i japën shkopin këtyre migranteve
ndërsa popuj
çë erdhën mbi anije të moçme
me abetare ilire,

zotra dhe ikona,
 keza për mbretëresha,
 edhe ata të përzënë nga turqit në shekullin XV
 nani ju lëshojnë palën¹⁰
 vatrat, rrathët piçkulaç¹¹ të gjitonive
 melurgjitë dhe panajin¹² për të vdekurët
 'asha'al-mayyit' juaj
 edhe më ... burrat ju trashëgojnë grevat
 për pushtimin e tokave nga argatë
 brumin¹³ e bekuar të katundevet

[...] le të vazhdojë
 qarkullimi dhe prodhimi i miteve
 bashkoni edhe ju në varg
 hyjnitë e Qiellit dhe të Tokës
 me karramunxa¹⁴ e daulle
 le të vallëzohet Nëna e Madhe
 për dashurinë e nxehtë
 nderoni Ishtar-Astarte-Afërditën
 për pjellorinë e gravet zonjën Ekate
 në fund Dhemetrën-Persefone
 sa të mburojnë dherat.

[...] kur do të vijë moti
 për të mbjellë trëndafila të lashtë
 ne do të jemi atje me ju
 për t'i potisur¹⁵

me ujëra e panjohura të lumenjve karstikë
 erat e atyre luleve të çuditshme
 me rrënjë në kujtimet e popujve dhe në humnerat
 morën shpirtin e shkretëtirës
 dhe [të] zajeve të përrenjve(t)

nuhatja e asaj ere shumë njerëz
 janë të bindur
 se vjen nga dritaret e hidhura të Historisë.

¹burgjet; ²të munduar, të pushtuar; ³kasolle; ⁴me plasa e pa tjegulla;
⁵kat përdhes; ⁶mëshirë; ⁷një rrip tokë; ⁸buzë magjes; ⁹herë; ¹⁰pajën;
¹¹bashkë qendror; ¹²tharmin; ¹³darkë totemike; ¹⁴gajde; ¹⁵ujis.

ËNDRRA E NJË GJËJE

S'ka dyshim se Trimit
 s'i rrihet pa lëvizur
 të jetoi i stisur brenda një statujë prej bronzi
 a i ngjeshur në pluhurin e mermerit.
 Nga gjindjet Ai s'do temena me kokë ndër gjunjë
 inat shumë ka për puthadorët.
 Përkundrazi
 në Maqedoni janë të turpëshme këta naze¹.
 Ende ty Lekë thoshte se
 kush për së gjalli rrodhi Botën anë e mbanë
 për së vdekuri i mjafton një gropë sa një vërë².
 Pa merak baras është për ne të shfrytëzuara.
 Në këta netë verore me zjarrin e zagushit
 trupi yt, Leka, plot fuqi rinore, u ringjall,
 magnetizmin i tokës bëri të të vinte malli
 për të shkelur livadhin.
 Të kam shikuar që bisedoja me statujat vërdallë
 psa u zbrita nga kali
 ftoha fytyrën me ujën e currilave
 dhe u rrëzova me hapa viganë
 drejt urës mbi lumin Vardar që të këndonte
 midis tingujve të daullave, zurnave dhe defeve
 një vjershë e mekur.

Bashkë me Aristotelin kalova në Pazar
 për të rrahur mbi Subjektin Bashkues
 që kishte qëndruar jashtë letrës Fshehësia e
 Fshehëtësive³

(lat. Secretum secretorum).

Aristoteli qeshi si i çmendur
 kur tregonte se zoon politikon-i⁴ i tij
 së pari
 do të kishte shkëlmuar
 njeriun më vete formal- abstrakt i Kartezit
 të dytë

ato vetëdashës dhe i veçuar i Hobbes-it
 në fund

njeriun e pronës private i Locke-s!

Anasjelltas,

sytë e Lekës shkëlqyen kur fliste për Perandorinë
 për qytetet që shkoqeshin për shkak të luftës,
 për ndeshjetë,
 për shkatërrimin e fushave dhe qendrave urbane,
 për prishjen pa hesap të burimeve.

Deri sot, unë nuk di

nëse imi ka qenë një vegim shatra-patra!

Po dihet se në Maqedoni, ashtu në Ballkan,
 shekujt nuk ndjekin radhë radhë, në vazhdimësi logjike,
 por bashkëjetojnë dhe ekzistojnë krah për krah
 pranë njëri-tjetrit.

Historia dhe Kujtesa e djemnuem⁵ të sulmojnë, të mbytën,

frymën do t'ë mbash pezull
deri në rrethin e gjerë të arkitekturës
i banuar nga statujat e Lisipit⁶. [...]
Në mejhane Aristoteli
përsëriti e ripërsëriti me zë të lartë
se vatra kryesore ish Qyteti e Bashkësia⁷
pastaj shkaku themelor
ish lufta midis Pronës së Përbashkët e Pronës Private⁸.
Edhe në Shkup
që prej shumë kohë është e qartë
se bota ka ëndrrën për diçka
prej të cilës ka vetëm të marr ndërgjegje,
që ta zotëroj në të vërtetë⁹

¹në gjuhën gr. e vjetër proskýnesis; ²një mendim i Lekës; ³një letër i Aristotelit për Lekën; ⁴një përkufizim i Aristotelit; ⁵në gjuhën lat. damnatio memoriae; ⁶Lysippus jetoi midis 390/385 para Krishtit dhe vdiq pas vitit 306, një nga mjeshtrat e mëdhenj të skulpturës klasike Greke, punoi shpesh herë për Lekën; ⁷në gr. polis e koinonia; ⁸në gr. oikonomia e chrematistiké; ⁹K. Marx, nga Një letër për Ruge, 1843.

NEMA STO NEMA- S'KA GJË QË S'KA
DIÇKA TY MENDON TË KESH,
NË PAZAR DO T'E GJËSH

Në brigjet e lumit Vardar
ku rrjedh nën Urën e Gurit
bisedova me Kshetëzat flokëlëshuar -
(...) ata më kallëzonin që statujat tani abëtë,
motit, shkëlqyenin me ngjyra të ndritshme,
të kuqe dhe të kaltër,
ish zakon t'i lyejnin me ar dhe vjollcë -.
- Gjithmonë, në zbrazëtinë e bebëzave
në gropën prej mermeri të bardhë
tregohet se fshihet Gjëegjëza -.

Tutje-tëhu, Shtojzavallet lozonjare
luanin me Kuçedrën -
të hidhëruara me ata burra – shpirtzhuritur -
që sytë e Zanave i shndërruan në gur ose bronz
- A ishin Kreshnikë ose Viganë në një jetë tjetër?-
Disa thonë se statujat
janë trupa të gorromisur në tokë për të luftuar
kundër Harresës.
Lukreci pohon se janë Shenja - shkronja e abetares -

që në mbjelljet gërshetojnë
 ligjërime mbi “Simptomat e Shpirtit”
 Trupat bëhen vende të kalimit:
 Mittelpunkt, thotë Derrida,
 sepse Ballkani nuk mund të ketë kufij
 por vetëm pragje
 ku popujt gjitonë mblidhen
 për të fituar ndjenjat e vetmisë.
 Në pikën e rënies, të kalbjes, të dorëzimit,
 njeriu me tahmin takon trupin,
 simptomë që mishëron gjurmën e mbarimit,
 shkronjë që jehon mbi daullen e gjuhëve.
 Aty ku është rënie, nuk ka më unë dhe tjetri,
 unë me tjetrin, unë kundër tjetrit.
 Njohja përmes statujave e
 Goce-s Delchev dhe Dame-s Gruev,
 Metodija-s Andonov-Chento,
 Zarit Samoil, Dimitrija-s Chupovski,
 Xhustinianit,
 rebelit Petar Karposh dhe Gjorgjija-s Pulevski,
 Nënës Tereza,
 shenjtorëve Kiril dhe Metodi,
 Klementit dhe Naumit i Ohrid,
 madje Gjergjit Kastriot- Skender Bey,
 Lekës III dhe Filipit II,
 këtu është e mundur ose edhe pamundur.

Më shumë do të kisha zbuluar me Foucault
 nëse statujat në jetë do të kishin qënë
 trupat e të çmendurve
 sepse ata i janë besuar lumit njëmijë krahë,
 të lidhura me zinxhirë
 në drejtim të kryqëzimit të pafund
 bëhen të burgosura të Kalimit
 pa ditur në cilin vend do të zbresin,
 nga vijën dhe kur i vendosin këmbët në tokë.

Aman, por si është e mundur në Shkup të mblidhet
 një turmë aq e madhe statujash?
 Në Pazar, afër Hamamit Daut-Pashin,
 një zë moshe më erdhi në ndihmë:
 - I huaj, ne përdorim shprehjen: *Nema sto nema!*
 – S'ka gjë që s'ka
 Diçka ty mendon të kesh, në pazar do t'e gjësh!
 Nuk është asnjë Dhe si i yni
 i pasur me Shenja dhe simptoma
 të sëmundjeve të shpirtit.
 Maqedonia, si unë, është toka e kurbetit.
 Askush e di nëse e gjitha
 është vepër e Lugetërve apo Thopërçive! -.

GRATË E PAZARIT TË SHKUPIT

Gratë kur takohen qëndisin me rrathët magnetike të fjalëve
 pëlhura yjësive, bisedime dica herë të rënda
 ashtu ndodhi këtë mëngjes në pazarin e Shkupit
 midis specave të verdhë
 qershive të kuqe dhe zërit të muezinit
 që nga minarja përhapej gjithë rreth.
 Nuk dihet se si shkoi fjalimi
 mbi Vdekjen dhe Rininë, ... mbi Lekën,
 që vdiq 33 vjeçar!
 Thuhet se trupi i tij ishte zhytur me bollëk të madh erëzash
 për ta parfumuar dhe ruajtur në një arkivol
 i mbështjellë me ar.
 Dhe prej ari ishin mbulesa
 qëndisja mbi leckën/rroben e purpurt
 rrezet e rrotave të qerrave persiane
 tërhequr nga 64 mushka
 dhe kurorat rreth kokës së tyre
 ashtu dy këmbanat në anët
 ... ndërsa jaka ishte zbukuruar me gurë të çmuar.
 (Sipas tregimit të Diodoros-it Sikeliotes)¹
 ... Gratë flasin për të birin e Filipit II dhe të Olimpiades
 por edhe për fëmijët të tyre, për ata të vdekur në luftëra
 në qindra kufij e kësaj toke të zhveshur

përditë të huaj në anë të gjellas.
 Historia duall jasht hjibave², thotë Hamleti!
 në shqitjen (/hendek) e kohës së tanishme
 kërkojnë drejtësi nënat
 rojtare e fshehtësisë të ngjarjes
 tabernakuj të ndërgjegjes
 dhe të Mëshirës³- përmendore
 e brishtë të njerëzve të thjeshtë-
 vajtueset shqiptarë në një gjuhë të pastër
 - e mbyllur në një tjetër gjuhë -
 e çliruar nga shqisat, tregojnë me gjëmat
 - gjysmë vaj, gjysmë përsëritje -
 ... se pranvera me ngjyrat, erërat, ngrohtësinë e flladit,
 u jep gjak të vdekurve dhe i nxit të lënë varret
 ... anasjelltas dimri me borën që bie mbi gropat,
 ngrin e bëhet akull
 edhe ai është më shumë i tmerrshëm!
 Mëshira nuk u përshtatet skulptorëve të Perandorisë!
 Sipas mjeshtrit Lisipo, Leka nuk është një Bir,
 por një Dëshmor
 një Lugat i shkrirë në bronz i pandjeshëm ndaj stinëve
 Ai rri në qendër të sheshit, mbi Buçefalin, kali i tij,
 larg tokës - afër Perëndive,
 kokë në retë dhe krah i shtrirë tani
 në shenjën krejtësisht të padobishme të fitores.

Çfarë mbetet nga njohja absolute?

të historisë, filozofisë,
 ekonomisë politike, poetikës?
 të punës, gjuhës, familjes, fesë, Shtetit, etj?
 Çfarë mbetet, me hollësi, pas thërrimeve?⁴

Për gratë e pazarit të Shkupit përgjigja është Mëshira
 Por tani kush ia tregon Filipit II
 dhe Aleksandrit III të Maqedonisë,
 Julius Cezari-t dhe të gjithë perandorëve ilirë?
 Gratë thënë që vetëm një femër tjetër shqiptare
 mund të guxojë kaq shumë
 Anjezë Gonxhe Bojaxhiu,
 ajo me kurrizin të krrusur mes të gërbulurit.
 Ashtu qoft.
 Nuk kam fuqi të dal
 nga ujërat amniotike të këtyre vendlindjeve të reja
 që pluskojnë dhe rriten e rriten
 në vallen zgardhoce të rravimit së tokave dhe
 popujve.

¹Diodoros Sikeliotes, historian të I sh. para Krishtit; ²W. Shakespeare, "Hamlet", I, V, 188: "The time is out of joint", kokëposhtë. Për J. Derrida (në Spectres de Marx, 1993), Time është në të njëjtën kohë, përkohshmëria e kohës, ajo që mundëson përkohshmëria (koha si historia, kohërat që kalojnë, koha që jetojmë, dita e sotme, koha), sa, si pasojë, bota si shkon, bota jonë sot, e sotmja jonë, të njëjtin aktualitet [...]; ³në lat. Pietas; ⁴mendimi i plotë i J. Derrida in Prière d'insérer ka pyetje edhe për psikoanalizë, semiotikë, seksualitet; ⁴Nëna Tereza, lindi në Skup, nëna e saj, Dranafilë ish nga Gjakova dhe i ati, Nikolla nga Prizreni.

VËSHTRIME MIGRANTE

Kërkonj me sytë e mendimit
çë shpejt ecen shinat e kohës sime
shikimet e udhëtarëvet mbi trenat
çë u vendostin përgjatë shuratë e detit Jon
mbi ngjyrat çë panë ture shartuar
ture helmuar, ture shpresuar
me hundën e shtypur në qelqin e dritares.
U kërkoj ndër
lulet e verdha të spartavet, mbi agavet, ...
sytë e atyre udhëtarëve migrantë
çë si buzët mund ken dhënë miliarda puthje
kur treni rrozëbisnajt bregdetin,
shëllëza të ngrëhta,
ture u larguar drejt vetëm një veri
pas kaq shumë Jug.

GJEOGRAFIA E SHPIRTIT

Lë hijé prapa
në këtë gjeografi të mallkuar të shpirtit
shtigje kometash
çë kurrë ari i ikonavet
mund fsheh.
I ndëjtur mbi rahjn
përballë atyre pamjeve
koha dhe rrjedhat e kryengritjes
më shkundijnë trupin

RRUZULIMI NË FILAQÏ

Shpejtësia e ngjarjevet
 ndonjëherë bën të të humbet kryet
 hartat gjeografike, kufijtë e tokës dhe dejtit
 shkrazihen me baltë e gjak
atje kurmat, pika zero e botës, përpiqen
 pa ç'janë mosgjakùn
 por grumbujt e kufomave të migrantëve
 çë rrinë pezull o atò të shtrijtur
 në thellësitë e Mesdheut
 o të shtypur ndër kampet e përqendrimit të Lesbos
 ndër atà të shfarosjes libian dhe turk
 bëhen guri i qoshes
 për udhëkryqet pa një vend tjetër përveç Ferrit
[...] Dreq këtu ku dielli i Lidias zhduket
dhe hëna me gjishtat ngjyrë trëndafili fiton mbi të gjithë yjet
 thënaj Safoja
 nanì kanë burgosur Rruzulimin
 çë po stafidhjet në një eklips të dhunshëm.
 Rebelët dhe poetët shkelijnë atò sinore
 ture kapërxyer dherat kalec të kthyeshme
 çë shkasin, me pjazmen e rrjetës,
 sa të shohin horizontet me lule lotusi
 mbatanë brigjet të lumit i dhimbjes Akeron
 sa të buthëtojnë një udhë shpëtimi.

LAYLĀ, ZHULJETA DHE EURIDIKA

Orat shqyerrin gjeografinë e Frymës
duan të han pamje pse janë é sull
pa miqët e motit.

Gërvishënjn gardhet e parkut, udhët e gjata,
shtretat e lumenjvet, kupolat e qishavet
vitrinat e dyqanevet,
në fund ndënden me mungime.

Orat duhet të gëzohen
atyre shenja i lypset dashuria pse s'e kanë
dashuria për të dashurin ka mot e ç'nani u humb
për atò i dashur një herë e sot ng'duhet më
dashuria për atò ç'është i dashur por na mungon.

Orat ecijnë natën, të marrën shpirtin
dhe bin'e harron udhën e shpisë

Atà i lartësojnë mungesat
me gjeografinë e vendeve të rrahura
të mbarsura me hije, qëndrime, gjurmë, erërat e
manushaqes,

shenja të padukshme në shkretëtirë
të zotërojnë, bin'e del trush.

Rrëmben kurbanet e i sjell atjè
ku poetët arabë emërojnë *mağnūn*
të pushtuarit nga një xhind

dreq si të çmendurit e romanit dashurie
i përjetshëm *Mağnūn Laylā*.

Pas një mijë vjetë djevasinj e prir e djevasinj
historinë e Amr Ibn-l-Qais-it dhe të Shekspirit
ndër atà mijë faqe kumbon jehona e muezinit ...

*kush je ty që ture përparuar
në errësirën e natës ngec*

mbi mendimet e mia më të fshehta?

sëmundje e hënës rrotullon qiellin dhe zemrën time
Zanat e malevet bisedojnë me yshtarë
jatronjë arabë dhe persë, mistikë sufiste,
rreth mallëngjimit, stinëvet, magjivetë, Besës

Të zemëruar dhe të ëmbël

ecëmi me Romeon dhe Zhuljetën, Layla-n dhe Mağnūn-in

në urën رَسَجْر jisir me shtatë harqe

anamësa magjepsjeve e hajmalive

ndërsa të rinjtë që digjen ndër sheshet na shikojnë

sytë e të lidhurave luten

ndër kampet greke të refugjatëve,

në burgjet turke dhe libiane

Trupat të mbytur në thellësitë e Mesdheut

me letra dashurie të fshehura në qese plastike afër zemrës
rrotullohen si jasemine ndër vallet që dredhënjn dervishët

Zemra ime e dashur, të lutem mos vdis,

pothuajse unë e kam kaluar.

Pas muajsh dhe ditësh udhëtimi arrita në Libi.

*Nesër shkoj në Itali. Allahu më ruajttë.
 Atë çë bëra, e bëra për të mbijetuar.
 Nëse e shpëtoj veten, të taksënj se do të bëj
 gjithçka mundem për të gjetur një punë dhe për ty
 dhe të vish në Evropë tek unë.
 Nëse e lexon këtë letër
 do të thote se jam i gjall dhe kemi një të ardhme.
 Të dua, i joti përgjithmonë Samir*

Orat - *zbardh dritë, errët natë* – si thot Kuteli
 e kanë copëtuar gjeografinë e Frymës
 Orfeu-Samir i strushëlar ndër llagoret
 ndër qelitë e Hadit për një udhëtim pa prirje!
 Ki është moti
 kur historitë dhe kurmat e të vdekurvet
 përhapen të pasqyruara si ikona televizive
 bukë për sytë e atyre çë nesër do t'i startarosijnë
 Ë hera të dalin jasht ka romani
 Layla e Maj'nun, Orfeu dhe Euridicja,
 Romeu dhe Zhuljeta, Ana Karenina e Vronskij,
 Dante dhe Beatrice, Hektori e Andromakja,
 Lançelloti e Gjinevra, Pali dhe Françeska,
 Tristani e Isota,
 sa të bëhen mish e asht në jetën e përditshme

Na duhen mite për një tregim dashurie i egër çë merr
*pjesëm trupore të njëj mishërimi të dukshëm
 një nimfë shoqërore universale*

në kukulën *e gjithë punës njerëzore*
 që përplasen ballë me ballë fuqitë e vendosura
 Le të ecijnë këta të dashuruar anamesa
 refugjatëve, fushavet e çifligarëve me skllevër
 ku ng'është as bukë as liri
 le të hipen mbi varkat e migrantëve
 për të mbrojtur dashurinë
 e thjeshtë dhe tragjike të gjithë Samirvet
 le të bien në dashuri me Drejtësinë
 sa të priret ship kjo Jetë
 duhet të jemi pronë e jetës
Dashuromi, dashuromi çmendurisht,
dashuromi sa më shumë mundemi
kut të na thonë se është mëkat
dashuromi mëkatin tënë
do të jemi të pafajshëm tha Shekspiri.
 Ka të drejt poeti: mjeri ai brez që
 ng'zdrypet edhe ndë Pisët të kërkonjë Euridicjan
 e t'a sjellë përsëri e gjall dhe e lirë mbi Dhe.
 Do të kemi motë pra
 të rrëfiemi ditë të reja dhe përralla
 të pandehen zogj që fjeturojnë
 drejt dher'va të pastërta
 të nuhuritëmi zemrën e jasemines
 e fshehur ndër çadrat e shkretëtirës
 pranë Mesdheut, jo më çimëturë i madh,
 na duhet të jemi pronë e jetës

DISA SHËNIME

Reportazh poetik nga Kosova

Poezitë “kosovare” janë një lloj reportazhi i shkruar në Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, shkurt në vendet dhe situatat më të ndryshme: ura, sheshe, oborre xhamish, teqesh, hamamesh, në kaosin e makinave, pranë autobлиндave dhe tankeve, brigjeve, shatërvanëve të rrethuar me trëndafila, atje ku djemtë shisnin cigare kontrabandë, në male dhe në varre të Prekazit, në fushat ku digjeshin mbeturinat, në fushat e minuara, ku kullosnin lopët, në anija, në Adriatik. Dhe sot, viti 2022, po ecja përkrah Kosovës së lirë edhe Republikane në shoqërinë e grave të reja intelektuale militante dhe me një ndërgjegje të veçantë politike. Në ato vitet e kaluara kisha pranë meje shokun tim poetin Osman Gashin, kosovar, me të shkruaja këto ëndrra, këto vegime me diellin në sy, edhe natën kur ktheheshim nga jeta e humbur në gjeografit e varura. Gjendjet shpirtërore të këtyre poezive u morën nga takimet me intelektualë, artistë, poetë, piktorë, gazetarë, tryesa dasmash me nuse dhe dhëndër pa të njohura, muzikantë me klarinetë dhe goditje, vajza me dajre të lehta, pleq dervish, Akademia, Biblioteka-Urtësi Qelqi dhe Dritja, Universiteti i Prishtinës ... të gjithë miqtë e Seminarit Ndërkombëtar, të vitit

2000, para së gjithash akademiku Rexhep Ismajli, *që mbollën një kokërr gruri në një fushë të minuar* dhe pastaj njëmijë kufijtë ... Kosova mund të thuhet se është afër heterotopisë! Në gjoks ajo përpiket të mbajë Gjithësinë, por nuk është e mundur për të. Në Prizren, tha Isak Shema, mund të gjesh pak nga gjithçka që i përket gjithë botës. Është afër kufijve, shkruan Franco Cassano, që proletariati i Historisë dhe i Politikës rritet si bimësi e vetvetishme, rritet një njerëzim i poshtëruar edhe i fyer, viktimë e policisë dhe e pastrimit, i ndarë nga gjuha, feja, politika dhe i bashkuar, d.m.th i grumbulluar vetëm nga qenia e tij, mbeturinë dhe përjashtim i pushtetit, diçka që mbetet jashtë fjalimeve triumfuese dhe nuk ka gjetur fjalë të afta për të rikompozuar mijëra ëndrrat e tij kontradiktore. Dhe ky është rasti i Ballkanit, i Kosovës, le ta pranojmë, dhe pastaj Ballkani prodhon më shumë histori

Gjuha rizomë

Huazimetë gjuhësore në italike u morën nga E. Çabej “*Studime Gjuhësore*”, v. III, 1976 dhe nga G. Rohlfs “*Fjalori i ri dialektik i Kalabrisë*”, 1977. Ndërsa në arabisht, kanë hyrë fjalë të tjera arabe, të cilat janë: *hannaka*, *tafar*, *tabut*; ata greke *vasiliko*, *pirivol*, *kallogjer* përkthyer në shqip respektivisht *borzilok*, *kopsht* dhe *murg*;

nga gjuha franceze *sangier* ‘i bënë me gjak’, nga gjuha spanjolle *tacha* që është *bulletta*, nga gjuha gjermanike *tak* u formua *takarjel* ‘copë druri’. Në italisht termi ‘zappa’ rrjedh nga *cjapi* Illyric për dy dhëmbët që kujtojnë brirët e kafshës. Për zhargonet doganore të kaldatorëve shëtitës shqiptarë, shih Q. Haxhihasani “*Të folmet shoqnore*” në *Studime Filologjike* n. 1, 1964 “*Dogançja dhe folmja shoqnore dhe zejtarve shetitës rrethit të Përmetit dhe të Leskovikut*” në *Studime Filologjike* 2, 1964; në italisht çështja u ngrit dhe u studiua nga gjuhëtari J. Trumper *Vindex verborum: aspekte të rëndësishme të elementit në zhargonet shqiptare artizanale italiane në mbledhjen e tretë dialektologjike e eseve në një zonë Italo-Romance*, (redaktuar nga G. B. Pellegrini) 1996. Fjala ‘*dëshmitar*’ në arbrisht *martri-u* shfaqet në Bernal, M. “*Athena e Zezë*”, 1997 (faqe 58) si rrjedhojë e *martirit* grek nga *mtrw* egjipt. Nga *buza e bukës* latine e *panikut*, rrjedh buka = bukë. Për kontributin e Shqipërisë në alfabetin armen, ndër të tjera, shih F. Tajani *Shqiptarë në Itali*, 1886 dhe ditarin e udhëtimit të E. Borè *Correspondance et Mémoires d’un Voyageur en Orient*. Dorëshkrimi përmban alfabetin e hartuar nga gjuhëtari armen Nesrop Masdoty, me 26 shkronja Zodiac plus 12 shenjat e alfabetit armen, i cili u gjet nga Borè në manastirin të Etchemiatzen. Ekziston një legjendë që thotë se drita dhe uji u burgosën

në një kullë të vjetër (kulluar)-kështjellë në Armeni dhe pastaj dielli u çlirua nga shenjat e zodiakut. Linjat e fundit “një mbretëri ulëritës gurë”, siç u quajt Armenia, dhe “trëndafila fryrë gjakut venoz në vjeshtë” janë marrë nga poezitë e poetit rus Osip E. Mandelstam (1891-1938) përfshirë në “*Udhëtim në Armeni*”.

Mbijdhja më shpi

Lajtmotivi i kësaj dhe poezive të tjera është *gjitionia*, ‘neighborhood’ e papërshtatshme, një konstelacion kompleks antropologjik dhe urban i komuniteteve arbëreshë, të rrethuar nga hapësira rrethore, pa kënde të gjalla, dhe nga era e ushqimit dhe zërit të nënave. Duke filluar që nga vitet 1960, ai filloi të paraqiste tipare me ‘alphabet Morse’, segmentime shkatërruese të kuptimit të komunitetit primitiv.

Shtëpia është vatrë

Dhoma ku ndodhet vatra, është nyja rreth së cilës ndodhin ngjarjet dhe dinamika e familjes. Është *lokusi* i pleqve që drejtojnë zjarrin, si *Vestals* të lashtë. Rreth vatrës ekzistojnë prezenca mitologjike të Ballkanit, siç Nënëat e Vatrës, Fairies, etj. Në

disa net të veçanta, për shembull më 31 Dhjetor ose 1 Janar , mendohet se shkëndijat e prodhuara nga stoku përfaqësojnë kafshët që do të lindin, ushqimin, ushqimin dhe bollëkun.

Bastja (Ngushti)

Në mitologjinë greke *Nyx* ishte Nata, vajza e Chaosit, e cila krijoi Ditën, Mundësinë, Gjumën, Ëndrrat, Sarkazmëm, Varfërinë, Moire, Nemesis, Butësinë, Mashtrimin, Dashmirësinë, Pleqërinë, Mosmarrëveshjen, Vajzat e mbrëmjes.

Lethe (Lumi i harresës)

Ujërat mitologjike të atij lumi erdhën nga Liqeni i Mnemosynës, i cili lexohet në një laminetë Orphic, që daton në gjysmën e parë të shekullit të 4 pas C., gjetur në Kalabri, në Petelia, ku përmendet edhe Selvia e Bardhë.

Hija e lisit

Referenca për Jurentina (ose Garentina) dhe për nënën kanë të bëjnë me legjendën e baladës së vëllait dhe motrës, pikërisht Konstandini dhe Jurentina,

të përbashkët edhe në variacione të ndryshme në një zonë të gjerë gjeografike të Ballkanit. Ajo është përqendruar në *'fjalën e dhënë'*, në besën shqiptare, dhe në dashurinë vëllazërore. Në baladë besa do të mbahet nga Konstandini, i cili do të tejkalojë edhe vdekjen duke sjellë motrën e tij Jurentina përsëri në nënën e tij. Të dy do të vdesin për shkak të emocioneve të forta gjatë takimit.

Dragoi dhe Kuçedra

Ato janë kafshë teriomorfe të botës ëndërrore të Ballkanit, protagonistë të luftës së përjetshme të së mirës kundër së keqes; dragoi përfaqëson forcat pozitive të natyrës, mbron farën dhe prodhimin, është i armatosur me një shtizë me majën dhe me djepën, që i përdor si një mburojë, ndërsa kuçedra, Hidra me shtatë krerë, është forca negative, banon burimet, duke shkatërruar të lashtat, produktet e fushave dhe të kullotave, është e armatosur me të tjerat pajisje të plugut. Sa për pagëzimin dhe 'ngjitja e emnit' fëmijës ekziston një strategji e përpunimit për të shmangur forcat negative, të tilla si Orët, të cilat mund t'u bëjnë fëmijëve plagë dhe gjymtime. Në Shqipëri dhe Kosovë, Ora e Shtëpisë ose *Vitorja*, është një gjarpër i zi, me një tufë të flokëve në kokë, brirët arta, jeton nëpër vrimat e shtëpisë ose të dhomës së vatrës dhe është e ushqyer nga jo më shumë se dy gra, mbron shtëpinë

dhe garanton mirëqenie; absolutisht nuk mund të vritet. Tri Zanat, të *Mirat* apo *Ato të Natës*, bëjnë fatin e foshnjave të porsalindura, dhe shfaqen para djepës, ditën e tretë pas pagëzimit të tyre.

Gjuhë rebele (Gjuhë zganxirre)

Teksti i shkruar më së shumti me fjalë dhe shprehje të gjuhës arbëreshe, dëshmon për oralitetin e saj shtatzënë dhe vështirësitë endogjene dhe ekzogjene të shkrim-leximit, megjithatë, kryesisht të mohuara nga Shteti italian. Aktualisht, jeton paradoksi i mësimin të tij vullnetar në Shkollat Filllore dhe në shkollën e Lartë të Shkollës së Parë, por me aktivitete jashtëshkollore, dhe pastaj drejpërdrejt në universitet (Bari, Lecce, Kosenxë, Napoli, Romë, Palermo). Samari në qafë është *standardizimi* i pamundshëm që artificialisht laboratorët dhe Akademitë universitare shpresojnë t'i vëjnë mbi qafën e kësaj gjuhë të egër.

Dhimitri Reres dhe kali

Pas studimeve të gjera mbi burimet historike të së kaluarës, kohët e fundit u zbulua se udhëheqësi shqiptar Demetrio Reres 'duket' se nuk ka ekzistuar dhe për këtë arsye nuk mund të menaxhonte asnjë

grup refugjatësh në themelimin e kolonive në Italinë Jugore në shekullin e XV! Megjithatë, historia kthehet e verdhë, sepse mbiemri *I Rerë* do të thotë *I Rreme*, gënjeshtar dhe folje *reronj* për të mashtruar, për të gënjyer; prandaj ky “detaj”, jo me natyrë historike, mund të rihapte rastin e Reres në hetime të reja. Strategjia e ikjes së refugjatëve të nxitur nga turqit dhe e përpunuar nga heroit kombëtar, Gjergji Kastrioti Skënderbeu, me të vërtetë ka ekzistuar (sic!), është marrë nga *Skënderbeu keq 'i zbet pjesë e Rapsodive të një poeme shqiptare* (1886) përkthyer nga Jeronim De Rada. Vargu latin është nxjerr nga Virgjili (Eclogae, 9.51).

Barut

Baruti është situatë shpërthyes, nxitëse, era e kryengritjes, shiroku në shqip quhet *zagush*. Shprehja ‘*të jetosh sa buka dhe vera*’ është një formulë augurore. Fletë misri dhe një specie e zogut, në shqip, janë treguar me sinonim *gëzholl / e-ja*, në të njëjtën mënyrë vajza dhe pëllumbi me *guguç / s, -ja*. Shprehja *s'ia lë ngëmshtin* është tipike për arbrishtjen dhe do të thotë ‘*mos e lër pas këmbës*’, ndjekje, mos u dorëzoni. Me *Vitor / e, ja* përcaktohet në Ballkan një kafshë totemike, një gjarpër me brirë të artë që pjellë ari dhe solli fat të mirë dhe mirëqenie kudo që shkonte; një grua pjellore, veçanërisht e mirë në punët e shtëpisë; një

pulë, një bletë dhe një lopë shumë produktive. Në fund, *Vitorja* ishte emri shqiptar i një Zane, një nga të *Treta e Natës* (para se Moirat greke). Ata kryesonin mbi fatin e njerëzve dhe u shfaqën përpara djepit të të porsalindurit në natën e tretë të jetës.

Jugu dhe format e ngjarjeve

Nga *Bakantet* të Euripides citohet vargu e fundit i Korit. Në gjuhën shqipe, arritja e pamundësisë bëhet: ‘*kur deti të bëhet kos*’; dhe folje intransitive *rri* ka si nënkuptim: mbush hapësirën e jetës me një përmbajtje të vërtetë ontologjike, një meditim madhështor pa lëvizje, mërztije, depresion ose melankoli. Emri *nge-a*, tregon kohën e çliruar nga të jetuarit në shthurje, ndërsa *nxe-a* (nuk është raportuar në fjalorin shqip as arbëresh) do të thotë ‘*dëshirë, kënaqësi e papritur*’. *Zesku* është grykësi që Hera ose Selene dërguan të vrisnin demin e hipur nga Ampelo, një dashnor i Dionisit. Në tabelat e Harmonisë, ngjarjet e botës regjistrohen në rend.

Jug-kalypsis

Titulli luan me *apokalypsis* që vjen nga ἀποκάλυψις grek (apokálypsis), i përbërë nga ἀπό APO (“nga”, e përdorur si një derivativ) dhe καλύπτω kalýptō (“hide”), dmth të hedhur

velin që mbulon, ose zbulimi. Kuvendi publik i Thurit, *Sybari i ri* i Magna Grecia-s, në vitin 379 a. C., përmes një dekreti i dha shtetësinë nderit Hyjnisë *Borea*, një shtëpi dhe një ngastër të tokës, pse shpërtheu në mënyrë të vështirë për të bllokuar anijet e Krotoniateve që donin të pushtonin dhe plaçkitje. Kjo ishte hera e parë në historinë e qytetërimit njerëzor që i përkasin një kombësie, është konsideruar gjithashtu një privilegj për hyjnitë. Me *burrë katërqind dërhémë*: do të thotë një njeri-trim dhe i fortë që e mban fjalën e tij. *Dërhémë* ishte një njësi matëse e lashtë shqiptare (midis 1.25 kg dhe 1.50 kg). Erinyes, ministre e Dike, ndëshkuar diellin nëse “shkelni masa e saj shkon përtej detyrën e caktuar për të” (Heraclitus, DK, fr B94.); Ananke “udhëzon qiellin, duke e detyruar atë të mbajë kufijtë e yjeve” (Parmenidi, DK, fr.B, 10). Për grekët, álogoi dmth raportet e pafund, pa gjurmë të harmonisë dhe proporcionit, ishin një absurditet dhe një skandal. Koncepti i *limes-it* u përkthye në shqip si *cara/n, -ni* që mund të thotë: a) një nga dy gurë të vendosur në vatër dhe në të cilën mbështeten dru zjarri; b) vendi rreth vates; c) gurin e varrit; d) guri i kufirit agrar; e) një gur i madh. Ajo përmbledh një problem të psikologjisë historike mbi Hestia-Hermes, palë hyjni, e zgjidhur shkëlqyeshëm nga J. P. Vernant.

Pluhuri

Njëzet hapat në të djathtë i referohen njëzet viteve të diktaturës fashiste në Itali (1925-1945), kur të gjitha partitë (përveç Partisë Fashiste Kombëtare) u shpallën të paligjshme. Lufta “gjashtëditore” filloi më 6 Qershor 1967, dhe pa Izraelin kundër Egjiptit, Sirisë dhe Jordanisë. Në fund, Izraeli pushtoi territoret palestineze. Dy sheshrat e revoltave ishin: Tian’anmen (Pekin) ku pati një sërë demonstrimesh të studentëve, intelektualëve, punëtorëve (15 Prill dhe 4 Qershor 1989). Simboli i protestës ishte *Zoti Tank*, i cili në tërësinë solemne dhe të çarmatosur u përball me një kolonë të tankeve, duke u bërë për të gjithë botën një simbol i luftës kundër tiranisë. Sipas disa dëshmitarëve të huaj ka pasur 7,000-12,000 vdekje. *Amnesty International* ka shtuar edhe të tjerë të ekzekutuar për “rebelim”, “zjarri i automjeteve ushtarake”, plagosur ose vrarë, ushtarë dhe krime të ngjashme, duke vlerësuar një numër më të madh se 1000. Ndërsa *Sheshi Shën Wenceslas*, në Pragë, është i njohur në mbarë botën për shkak se, më 19 Janar 1969, Jan Palach, një student universiteti i filozofisë, u vra në zjarr në protestë kundër shtypjes së kryer nga Bashkimi Sovjetik.

Nga dritaret e hidhura të historisë

Greqia e Madhe e Lashtë është zona gjeografike e

gadishullit jugor italian, e cila u kolonizua më parë nga Grekët nga sh. VIII para Krishtit. Ippaso një filozof dhe matematikan i lashtë Grek që zbuloi sasi të e pafundme, numrat irracionalë, u vra për zbulimin e teoremës së përcaktuar sot të Pitagorës, raportit të artë. Arkita filozof, matematikan dhe politikan i lashtë grek. Ai u interesua për shkencën, muzikën dhe astronominë dhe studioi matematikë me Eudoxus të Cnidus; ai ishte i pari që propozoi grupimin e disiplinave kanonike (aritmetikë, gjeometri, astronomi dhe muzikë në kuadrat, renditja e Boethius në Mesjetë). Mbledhja publike i Thurit, Sybari i ri në *Greqinë e Madhe e Lashtë*, në vitin 379 p.e.s., përmes një dekreti i dha zotit Borea qytetarinë e nderit, një shtëpi dhe një ngastër toke, sepse ai shpërtheu aq shumë për të bllokuar anijet e kryqëzuara që donte të pushtonte dhe të plaçkiste. Ishte hera e parë në historinë e civilizimit njerëzor që të qenurit pjesë e një qytetarie, duke u pranuar nga një komunitet, u konsiderua një privilegj edhe për Hyjnitë. Një temë përsëritëse e tragjedisë dhe letërsisë greke, e pranishme edhe në Poetikën e Aristotelit flet për *hybris* kjo fjalë do të thotë “arrogancë”, “e tepërt”, “krenari” ose “prevarication”, një veprimi të padrejtë në të kaluarën, i cili prodhon pasoja negative tek njerëzit dhe ngjarjet e së tashmes. Arbëreshët erdhën nga Shqipëria dhe komunitetet e shumta shqiptare të Morea-s dhe Çamurisë; ata u vendosën në Itali midis shekujve të pesëmbëdhjetë

dhe tetëmbëdhjetë, pas vdekjes së heroit kombëtar shqiptar Gjergji Kastrioti Skanderbeg dhe pushtimit progresiv të Shqipërisë dhe, në përgjithësi, nga të gjitha territoret e Perandorisë Bizantine nga turqit-osmanët. Ata u vendosën në Italinë e Jugut dhe në Siçili, në valë të ndryshme, madje edhe sot flasin gjuhën e vjetër, të transmetuar gojarisht. Në Italinë Jugore, ndër luftat për tokën, protagonistët ishin çifçinjtë, burra dhe gra, që zbritën në fushën e tokave, në mënyrë paqësore, “të armatosur” vetëm nga varfëria dhe dëshpërimi i tyre, kundër pronarëve të mëdhenj të tokës. Zotërinjtë feudalë të eksploatuesve të “vijës” antike dhe historike, të cilët kishin zotëruar në shumë rajone të Italisë, u vendosën kryesisht në Jug. Ishte një “epikë” e gjatë, e trazuar dhe heroike që kërkoi të fshihet shërbimi mesjetar shekullor që ende karakterizonte shumë zona. Ka raporte për forma periodike të protestës dhe pretendimit nga fshatarët, nga 1700 dhe 1800 kur, sidomos pas bashkimit kombëtar, qindra familje fshatare shkuan në prona të tokës duke kërkuar shpërndarje. Në Kalabria kulmi i luftërave ndodhi në vitet 1943-1950. Dhjetra ishin fshatarë të vrarë nga ushtria e Shtetit Italian: masakra të vërteta të pafajshëm, të uritur.

Nema sto nema - S’ka gjë që s’ka

[Nëse doni të këshilloheni me *Burimet arkivore të Historisë së Ballkanit*]

Një herë, kur Bota ishte e keqe, Qeveritë, Ushtritë, Policia, etj. të Bllokave e Shtetëve Lindore dhe Perëndimore, e urrejnë njëri-tjetrin, Luftojnë, pushtojnë fusha të afërta dhe të largëta ... me arsyetimin se ata e donin Lirinë dhe Demokracinë (por në shtëpinë e të tjerëve ku njerëzit e mendojnë ndryshe). Një ditë Ata vendosën të bënin Paqe! Të gjithë u mblodhën pranë shtratit të një Kombi (i puthur gjithmonë nga Historia). Flasim për Maqedonin ku fatëkeqësisht Tërmeti kishte shkatërruar gjithçka pikërisht në Shkup. Kalonte viti 1963. <https://www.balcanicaucaso.org/aree/Macedonia-del-Nord/Skopje-1963-quando-la-citta-trattenne-il-respiro-140316>.

[Nëse doni të këshilloheni me *Burimet Arkivore të Arkitekturës*]

Këtu, në Shkup, shtrënguan duart nën mbikëqyrjen e OKB-së u betuan të bënin thelbin e “*Qytetit të Hapur të Shkupit*” për një shoqëri në zhvillim. Arkitektit japonez Kenzo Tange fitoi konkursin për *master plan*-in. Elementi kryesor shtrohej në një zonë e veçantë përgjatë brigjeve të Lumit Vardar këtej dhe andej Urës Guri *duhej të kishte një hapësirë të gjelbër në zonën ngjitur me Pazarin e pasuruar me funksione të shumta publike*. <https://milanmijalkovic.com/Crv-Pazar-Skopje>

[Këshilloheni me *Burimet i Përfytyrimës ballkanike*]

Milan Mijalkovic tregon me kureshti se zona e Planit kishte rrotull edhe:

- a) një zonë ushtrimesh për autoshkolla;
- b) ambasadën gjigande e SHBA-së;
- c) një varrezë ushtarake franceze;
- ç) një deponi e mbeturinave joformale;
- d) një klubë striptizi, ku ish një pishinë publike;
- dh) Muzeunin e Artit Bashkëkohor;
- e) skeletin të një ndërtese pa leje;
- ë) administratën doganore;
- f) muret të fortifikuara të kështjellës;
- g) ndërtesën të qeverisë përball tregut;
- gj) stadiumin e rinovuar rishtas;
- h) një kantier tjetër pa leje të braktisur;
- i) një luna park / një argëtim të shkatërruar.

Për Kshetëz, Zana, Kreshnikë, Viganë, Kuçedra, Thopërçi, Lugati. Shiko: Bonnefoy, I., *Dizionario delle mitologie e delle Religioni*, BUR Rizzoli, 1989.

[Nëse doni të këshilloheni me *Burimet e filozofisë*]

M. Foucault, *Folie et déraison. Histoire de la folie à l'âge classique*, Paris 1961; Lukreci, *De rerum natura*; J. Derrida, *Margini della filosofia*, Einaudi, 1997.

Shënime për autorin

Mario Bellizzi poet arbëresh u lind në Shën Vasil, në Kalabri (Italia jugore), i diplomuar për matematikë, kujdeset për historinë dhe etnologjinë e pakicës së tij etnike. Ndër botimet e tij veçojmë:

Shën Vasili i Madh, 1995;
Who are we now?, 1997;
Vallja e Zaravet, 2000;
Jan di lula monosaqa, 2004;
Last exit to Bukura Morea, 2005;
Anemoni i kuq dhe zogjtë e De Radas, 2006;
Me Dionisin drejt Konstandinopojës, 2006;
Good bye Shin Vasil, 2008;
Kisha e refugjatëve, 2014;
Gjeometrat e mbretit, 2018;
Lo specchio e l'ombra, 2018;
Nimfa dhe pjazma e heshtjevet, 2021;
E ardhmja qëndron diku tjetër, 2022.

Shumë antologji në Itali dhe gjetkë përmbajnë poezitë e tij të përkthyer në: kinezisht, arabisht, finlandisht, anglisht, rumanisht, flamane, shqip. Aktiviteti i tij kulturor mund të ndiqet në shumë revista në Ballkan si dhe në internet.

PËRMBAJTJA

<i>Hijet-lugat- pasqyrë</i> (M. Bellici)	7
<i>Me shuaj prej ere</i> (R. Ismajli)	12
Yshnja dhe ndijimi	35
Tek hapet trëndafili	38
Hije	40
A e sheh si punon gjithësia?	41
Buzë statujash	44
Këtu historia është trans	45
Shtigje kometash	47
Guri e lëvizja	48
Vallja e rrethanave	49
Hieroglif për antropologë	50
Lutje me porosi	52
Një letër për një shqiptar të mërguar	54
Të kuqtë e Onufrit	56
Red shift	58
Rapsodia n°28, ushtrim stili mësues J. De Rada	59
Nëse dallëndyshet vijnë ta ndërtojnë folenë	62
Me fytyrë kthyer kah Meka	67
Dita e Ballkanit	70
Molat në qiell	73
Dimri i mërgimit	75
Trance	76
Paqë në Ballkan	77
Fushë Kosovë	78
Fyelli e dasma	79
Fëmijët e Pejës	80
Gjakova	81
Shadërvan	82
Tre trëndafila	83

Skotisa natën	84
Të mbuluarat	85
Sirisëndi	86
Dragoi dhe kuçedra	87
Çamba ëngjëjve	89
Gjuha rizomë	90
Urat	93
Gjeologja e brendshme	94
Moi i majit	95
Lethe	96
Udhë	97
Liria nuk blihet në treg	98
Thirrje i heroit kombëtar Skenderbeg (dhe kalit të tij)	101
Ballkan i ëmbël dhe i zemëruar	103
Sy ikonash	105
Nata e dielli	106
Krahë voreje	107
Lëngë korrancezi	108
Pasqyra të sëndirtura	109
Drudhëzat dhe nata	110
Mbijdhur më shpi	111
Bukuria e vajzave	113
Vallja në shkurt	114
Shpia është vatra	115
Ngushti	117
Lumë qumështi	119
Rrënjë e hone	120
Re mbi arat	121
Shtrati	122
Kashta e kumtrit	123
Moti qëndis	124
Në prak	125
Pilikaçra	126

Buka është djersë	127
Dionizi	128
Fjalë të huaja	130
Në shesh	131
Gjuhë zganxirre	132
Kristla në prag	136
Hija e lisit	137
Me urth e pa grurë	138
Zëri në gjuhën shqipe	139
Hija	141
Pa lipisi	142
Dhimitri Rerës dhe kali	143
Mall	145
Voreja	146
Gjeli e kolla	148
Dashuruesit	150
Kush t'ë thotë	151
Ndri', ku vajte?	153
Me thikën e poezisë	155
Si rrinë shpitë e gjitonivet?	156
Barut	158
Jugu dhe fytyrat e ngjarjeve	160
Ngjashmëri të moçme	162
Jug-kalypsis	163
Buhoi	165
E Bukura More ose lëvdatë i pavendimit	167
Vilivili	169
Dorë zim i pahijshëm	170
Pika	171
Thonjëzat	172
Hyjnitë u lodhën	174
Shkronja H	176
Kushdò muar gjë nga katundi	178

Këngë orfike për Jugun	180
Xixëllonja e Vetmia	183
Argalit e Penlypses	186
Nga dritaret e hidhura të Historisë	189
Ëndrra e një gjëje	194
Nema sto nema - S'ka gjë që s'ka	197
Gratë e pazarit të Shkupit	200
Vështrime migrante	203
Gjeografia e shpirtit	204
Rruzullimi në filaqi	205
Layla, Zhuljeta dhe Euridika	206
Disa shënime	210
Shënime për autorin	226

